# FLETORJA ZYRTARE
## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 4

**Tiranë – E premte, 10 janar 2025**


## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 10, datë 23.12.2024 | Për zhvillimin e praktikave të mira bazuar në *Toolbox*-in e përbashkët të Bashkimit Evropian "Për reduktimin e kostove të aplikimit për rrjetet me kapacitet shumë të lartë dhe mjedisin miqësor të investimeve për rrjetet 5G..... | 367 |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1131, datë 27.12.2024 | Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në kafshët e gjalla të llojit derra të butë, në mjediset e hapura dhe në tregjet e kafshëve të gjalla... | 371 |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1132, datë 28.12.2024 | Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së influencës aviare në shpendë, në mjediset e hapura dhe në tregjet e kafshëve të gjalla..... | 371 |
| Urdhër i i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1136, datë 30.12.2024 | Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së influencës aviare në shpendë, në mjediset e hapura dhe në tregjet e kafshëve të gjalla..... | 372 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 265, datë 10.12.2024 | Mbi miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në rregullat e tregut të energjisë elektrike, të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 347, datë 27.12.2022, i ndryshuar..... | 373 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 266, datë 10.12.2024 | Mbi miratimin e datës së fillimit të tregtimit për tregun e ankandeve brenda së njëjtës ditë në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike..... | 406 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 267, datë 10.12.2024 | Mbi afatin e nominimit në tregun e balancimit..... | 407 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 268, datë 10.12.2024 | Mbi licencimin e shoqërisë "Volton" sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike ..... | 409 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 269, datë 10.12.2024 | Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "*Sunny Side Energy*" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike..... | 410 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 270, datë 10.12.2024 | Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "*Sunny Side Energy*" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike..... | 411 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 271, datë 10.12.2024 | Mbi kërkesën e shoqërisë "En.Ku" sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj..... | 412 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 272, datë 10.12.2024 | Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, "Mbi certifikimin e shoqërisë 'Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror' 'Albgaz' sh.a." , i ndryshuar..... | 413 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 273, datë 13.12.2024 | Mbi miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2025..... | 414 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 274, datë 13.12.2024 | Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin nëntor 2024, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV..... | 416 |
| Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 275, datë 13.12.2024 | Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 206, datë 7.10.2024..... | 417 |

**UDHËZIM**
**Nr. 10, datë 23.12.2024**

# PËR ZHVILLIMIN E PRAKTIKAVE TË MIRA BAZUAR NË *TOOLBOX*-IN E PËRBASHKËT TË BASHKIMIT EVROPIAN "PËR REDUKTIMIN E KOSTOVE TË APLIKIMIT PËR RRJETET ME KAPACITET SHUMË TË LARTË DHE MJEDISIN MIQËSOR TË INVESTIMEVE PËR RRJETET 5G"[1]

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; nenit 9, të ligjit nr. 54/2024, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë"; ligjit nr. 120/2016, "Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit", si dhe vendimit nr. 434, datë 3.6.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Planit Kombëtar për Zhvillimin e Infrastrukturës Digjitale, *Broadband,* 2020–2025",

UDHËZOJ:

Neni 1
**Qëllimi**

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i masave për zhvillimin e praktikave të mira, bazuar në *Toolbox*-in e Bashkimit Evropian, "Për nxitjen e ndërlidhjes në mbështetje të zhvillimit ekonomik dhe rimëkëmbjes ekonomike pas COVID-19", duke synuar në veçanti:

a) zvogëlimin e kostove dhe rritjen e shpejtësisë së vendosjes së rrjeteve të komunikimeve elektronike, në veçanti të rrjeteve me kapacitet shumë të lartë, duke përmirësuar procedurat e dhënies së lejeve për punimet civile, duke përmirësuar transparencën dhe duke përforcuar aftësitë e pikave të vetme të informacionit të përcaktuara në ligjin nr. 120/2016, "Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit", duke

b) mundësuar aksesin në infrastrukturën fizike ekzistuese të kontrolluar nga sektori publik;

c) identifikimin e masave që do të ndihmonin në reduktimin e ndikimit mjedisor të rrjeteve të komunikimeve elektronike;

d) të nxisë aty ku është e mundur dhënien në kohë në përdorim të spektrit të frekuencave dhe duke mundësuar investimet në rrjetet 5G përmes iniciativave proinvestimi;

e) të rrisë koordinimin ndërinstitucional për spektrin, si dhe koordinimet ndërkufitare për ofrimin e shërbimeve inovative 5G.

Neni 2
**Përkufizimet**

1. Për qëllime të këtij udhëzimi, zbatohen përkufizimet e përcaktuara në ligjin nr. 54/2024, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" dhe në ligjin nr. 120/2016, "Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit".

2. Në kuptim të këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) *"Toolbox*-i i BE-së" janë rregullat e miratuara sipas rekomandimit (BE) 2020/1307, të datës 18 shtator 2020, "Mbi një *Toolbox* të përbashkët të Bashkimit për reduktimin e kostos së vendosjes së rrjeteve me kapacitet shumë të lartë dhe sigurimin e aksesit në kohë dhe miqësore me investimet në spektrin radio 5G, për të nxitur lidhjen në mbështetje të rimëkëmbjes ekonomike nga kriza COVID-19 në Union";

b) "Zyra kompetente *Broadband*" është sektori i zhvillimit *Broadband* (BCO), në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Neni 3
**Procesi për zhvillimin e praktikave të mira sipas *Toolbox*-it të BE-së**

1. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë përmes njësisë "Zyra kompetente *Broadband"* (këtu e më poshtë "BCO"), në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e sektorit publik, do të angazhohet për të zhvilluar praktikat e mira sipas *Toolbox*-it të BE-së, në lidhje me fushat e mbuluara në këtë udhëzim.

[1] *Ky udhëzim është i harmonizuar pjesërisht me rekomandimin e Komisionit (BE) 2020/1307, të datës 18 shtator 2020, "Mbi një Toolbox të përbashkët të Bashkimit për reduktimin e kostos së vendosjes së rrjeteve me kapacitet shumë të lartë dhe sigurimin e aksesit në kohë dhe miqësore me investimet në spektrin radio 5G, për të nxitur lidhjen në mbështetje të rimëkëmbjes ekonomike nga Kriza COVID-19 në Union.*

2. Kur është e nevojshme BCO do të bashkëpunojë me:

a) Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), si dhe përmes AKEP-it me Organin e Rregullatorëve Evropianë për Komunikimet Elektronike (BEREC);

b) Me autoritetet rregullatore për rrjetet e infrastrukturave të përcaktuara në nenin 7, të ligjit nr. 120/2016, "Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit".

c) Rrjetin e zyrave kompetente *Broadband* të Bashkimit Evropian, si dhe autoritetet kompetente të ngarkuara me funksionet e pikës së vetme të informacionit, në lidhje me fushat e identifikuara në nenin 6, të këtij udhëzimi;

d) Grupin e Politikave të Spektrit të Radios (RSPG) dhe autoritetet rregullatore kombëtare kompetente respektivisht për fushat e identifikuara në lidhje me aspekte të koordinimit të frekuencave, sipas parashikimeve në ligjin nr. 54/2024, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë".

3. Deri më 30 qershor 2025, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) përmes BCO-së duhet të identifikojë dhe të ndajë me institucionet përkatëse praktikat më të mira në fushat e mbuluara nga ky udhëzim të prezantuara nga rrjeti i zyrave kompetente *Broadband* i Bashkimit Evropian.

4. Deri më 31 dhjetor 2025, BCO-ja, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e sektorit publik dhe autoritetet rregullatore të përcaktuara në pikën 2, të hartojë dhe propozojë një *Toolbox,* sipas praktikave më të mira të BE-së.

5. Për të garantuar transparencë dhe për të lehtësuar shkëmbimin e praktikave të mira ndërmjet institucioneve, BCO-ja do të përgatisë dhe do të bëjë publike në faqen e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe përmes pikave të vetme të informacionit informacionet e nevojshme për të gjitha palët e interesuara.

Neni 4
**Rritja e koordinimit ndërinstitucional**

Me qëllim rritjen e koordinimit ndërinstitucional dhe për të nxitur zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit, si dhe reduktimin e kostove në proceset e këtij zhvillimi, MIE, përmes BCO-së, do të ndërmarrë një proces analize dhe do të propozojë masat e nevojshme jo më vonë se tre muaj nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi.

Neni 5
**Përmirësimi i procedurave të dhënies së lejeve**

1. Në zbatim të ligjit nr. 120/2016, "Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit" dhe rregullave të miratuara me vendimit nr. 155, datë 11.3.2022, të Këshillit Ministrave, "Për miratimin e rregullave të përgjithshme për procedurat e dhënies të së drejtës së kalimit dhe ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë", MIE, përmes BCO-së, do të ndërmarrë një proces analize për shkallën e zbatimit të këtij vendimi nga institucionet përgjegjëse, duke përfshirë identifikimin e praktikave të mira si dhe, ku është e nevojshme, përmirësimi i procedurave në përputhje me përcaktimet e rekomandimit të Komisionit (BE) 2020/1307.

2. Në procesin e analizës sipas pikës 1 të këtij neni, BCO-ja duhet të eksplorojë mundësitë bazuar në praktikat e mira të BE-së se, si:

a) respektohet afati maksimal ligjor për dhënien ose refuzimin e lejeve;

b) të thjeshtohet procesi i dhënies së lejeve, duke përfshirë ngritjen e procedurave të shpejta të dhënies së lejeve dhe/ose përjashtime nga leja kur është e përshtatshme, dhe përcaktimin e llojit të rrjeteve që do të vendosen që mund të përfitojnë nga këto;

c) mund t'u jepet operatorëve e drejta për të paraqitur, me mjete elektronike, nëpërmjet pikës së vetme të informacionit, aplikime për të gjitha lejet e nevojshme që kërkohen për punimet civile për vendosjen e elementeve të rrjeteve me kapacitet shumë të lartë;

d) të rritet koordinimi me pikën e vetme informacionit dhe institucionet përgjegjëse dhe si mund të lehtësohet shkëmbimi i informacion mbi ecurinë e këtyre procedurave ndërmjet aplikantëve dhe autoriteteve kompetente.

Neni 6
**Përmirësimi i transparencës përmes pikës së vetme të informacionit**

1. Bazuar në praktikat më të mira dhe të përshtatshme për të përmirësuar transparencën në

lidhje me infrastrukturën fizike, në mënyrë që operatorët të mund të aksesojnë më lehtë të gjithë informacionin përkatës mbi infrastrukturën e disponueshme në një zonë të caktuar të bashkëpunohet për forcimin e rolit të pikës së vetme të informacionit dhe zgjerimin funksioneve të tij që përfshijnë, për shembull, informacionin gjeoreferues dhe informacionin e integruar nga burime të ndryshme (në veçanti, informacioni i dhënë nga autoritetet kombëtare kompetente në çdo nivel, organet e sektorit publik dhe operatorët e rrjetit).

2. Ministria, përmes BCO-së, do t'u ofrojë institucioneve përgjegjëse praktikat më të mira të BE-së dhe bashkëpunojë me to për zhvillimin e praktikave më të mira për të siguruar që informacioni i përmendur në nenin 8 të ligjit nr. 120/2016, "Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit", kur mbahet nga organet e sektorit publik, vihet në dispozicion nëpërmjet pikës së vetme të informacionit në format elektronik.

3. Përveç kësaj, duhet të konsiderohet vënia në dispozicion nëpërmjet pikës së vetme të informacionit në lidhje me infrastrukturën fizike përtej minimumit të përcaktuar në ligjin 120/2016, siç është vendndodhja gjeografike e infrastrukturës, modelit të saj digjital, llojit dhe përdorimit aktual të saj, ose kapacitetit të saj total dhe rezervë.

4. Për të përmirësuar më tej sasinë dhe llojin e informacionit të disponueshëm nëpërmjet pikës së vetme të informacionit, autoritetet përkatëse t'u kërkojnë operatorëve të rrjetit të vënë në dispozicion nëpërmjet pikës së vetme të informacionit dhe në formë elektronike formatin, informacionin në lidhje me infrastrukturën e tyre fizike ekzistuese, të cilën ata ia kanë vënë në dispozicion operatorëve të tjerë me kërkesë specifike.

5. Të vlerësohet se si mund të lehtësohen rregullimet në dispozicion të operatorëve për vendosjen e elementeve të rrjeteve me kapacitet shumë të lartë, duke zhvilluar praktikat më të mira për t'u mundësuar operatorëve të kenë akses në infrastruktura fizike (duke përfshirë ndërtesat dhe objektet e rrugës) e kontrolluar nga organet publike, e cila është në gjendje të hostojë/mbajë shumë elemente të rrjetit me kapacitet të lartë, në kushte të ngjashme me ato të përcaktuara në ligjin nr. 120/2016, "Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit".

Neni 7
**Mekanizmat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve**

Përveç sa parashikohet në nenin 7, të ligjit nr. 120/2016, "Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit", BCO-ja të ndajë me institucionet përgjegjëse informacion mbi praktikat e mira të BE-së për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve duke inkurajuar zhvillimin e praktikave më të mira që përmirësojnë efektivitetin dhe efikasitetin e mekanizmit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në lidhje me aksesin në infrastrukturën fizike dhe funksionimin e organeve përgjegjëse për zgjidhjen e tyre, me synim për zgjidhjen e çështjeve të ndërlidhura brenda një afati sa më të shkurtër kohor dhe ofrimin e udhëzimeve palëve për kushtet dhe tarifat e duhura, duke përfshirë publikimin në kohë të vendimeve të tyre.

Neni 8
**Reduktimi i efekteve mjedisore të rrjeteve**

1. Zhvillimi i rrjeteve të shpejtësisë së lartë duhet të mbështetet dhe inkurajojë zhvillimin e praktikave më të mira për të nxitur vendosjen e rrjeteve të komunikimeve elektronike me një ndikim të reduktuar në mjedis, veçanërisht në lidhje me përdorimin e energjisë dhe të lidhur me emetimet dhe gazrat, duke përfshirë:

a) kriteret për vlerësimin e qëndrueshmërisë mjedisore të rrjeteve të ardhshme;

b) stimujt e ofruar për operatorët për të vendosur rrjete të qëndrueshme për mjedisin.

Neni 9
**Vlerësimi i ndikimit në mjedis**

Në përputhje me legjislacionin në fuqi për vlerësimin strategjik mjedisor, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe për habitatet, kur kërkohet një vlerësim i ndikimit në mjedis, dhe në veçanti kur autoritetet përgatisin kuadrin për miratimin e projekteve të ardhshme për zhvillim, udhëzohet që të shkëmbehen praktikat më të mira se si të performojnë dhe të marrin parasysh rezultatet të

vlerësimit mjedisor, në fazën kur mund të identifikohen dhe vlerësohen efektet mjedisore, si p.sh. kur operatorët paraqesin planet e përgjithshme për projektet që përfshijnë instalimin konkret ose vendosjen e rrjeteve.

Neni 10
**Sigurimi i aksesit në kohë për spektrin dhe mjedisi miqësor për investimet**

1. Në zbatim të parashikimeve në nenin 7 të ligjit nr. 54/2024, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", do të bashkëpunohet për përditësimin e politikës spektrale dhe planifikimin strategjik për frekuencat duke u mbështetur në praktikat e mira të BE-së.

2. MIE do të bashkëpunojë me AKEP-in për të mundësuar sigurimin e aksesit në kohë të spektrit të frekuencave në brezat pionierë për zhvillimin e rrjeteve 5G që mundësojnë sigurimin e mbulimit dhe cilësinë e shërbimit sipas parashikimeve në ligjin nr. 54/2024, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë".

3. Në përputhje me parashikime e ligjit për komunikimeve elektronike udhëzohet të bashkëpunohet me AKEP-in dhe autoritetet e tjera të BE-së për të shkëmbyer praktikat më të mira në dhënien në përdorim të spektrit, si dhe në lidhje me stimujt për përdoruesit e spektrit të radios në shtrirjen e rrjeteve 5G, që janë zhvilluar ose zbatuar në vendet e Bashkimit Evropian. Në veçanti, do të analizohen dhe shikohen masat që vendet e BE-së kanë ndjekur sipas parashikimeve të seksionit IV, të Rekomandimit të Komisionit (BE) 2020/1307, në lidhje me:

a) promovimin e çmimeve të rezervës që pasqyrojnë nivelet optimale të tarifave për të drejtat e përdorimit të spektrit të radios;

b) praktikat për shmangien e mungesës së spektrit dhe ato të harmonizimit në nivel Bashkimi Evropian;

c) duke siguruar në mënyrë jodiskriminuese mundësinë që tarifat për të drejtat e përdorimit të spektrit radio të paguhen në këste brenda periudhës së këtyre të drejtave;

d) duke përdorur një regjim autorizimi individual për brezin e frekuencës 24,25–27,5 GHz që promovon përdorimin e tij në kohë duke përfshirë, në veçanti, atë që bazohet në procedura të shpejta administrative kur zbatohet në të drejtat e kufizuara të përdorimit gjeografikisht;

e) kombinimi i stimujve financiarë me detyrimet ose angazhimet formale për të përshpejtuar ose për të zgjeruar cilësinë e lartë të mbulimit pa tel;

f) sigurimin, në varësi të ligjit të konkurrencës, të mundësisë për ndarjen e infrastrukturës pasive dhe aktive, si dhe për shtrirjen e përbashkët të infrastrukturës që mbështetet në përdorimin e spektrit të radios.

Neni 11
**Rritja e koordinimit ndërkufitar të harmonizuar me praktikat e BE-së**

1. Në përputhje me praktikat e BE-së për të promovuar praktikat koherente për dhënien e të drejtave të përdorimit të spektrit radio tek operatorët për të vendosur infrastrukturën pa tel të gjeneratës së ardhshme (përfshirë 5G) për përdorim industrial ndërkufitar, sipas së cilës Shtetet Anëtare të BE-së duhet të zhvillojnë dhe bien dakord për praktikat më të mira si pjesë e *Toolbox*-it, si dhe bazuar në parashikimin e pikës 3, të nenit 85 të ligjit 54/2024, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", do të punohet, për:

a) identifikimin e rasteve të përdorimit në dimension ndërkufitar, veçanërisht për transportin rrugor, hekurudhor dhe prodhimin industrial, në përputhje me prioritetet e zhvillimit në harmoni me praktikat e Bashkimit Evropian[2] në vendosjen e 5G që i shërbejnë plotësimit të reformës së agjendave dhe planit të ri të rritjes;

b) për çdo rast përdorimi të mundshëm të identifikuar, ose në identifikimin e një diapazoni të përbashkët të dedikuar frekuencash, në lidhje me regjimin përkatës të përbashkët të autorizimit, si dhe kushtet që i bashkëlidhen autorizimeve të tilla, të cilat janë të nevojshme për të siguruar vazhdimësinë e shërbimit përtej kufijve, duke përfshirë por pa u kufizuar në cilësinë e shërbimit dhe sigurisë së rrjetit.

2. Për zhvillimet e mësipërme udhëzohet të përdoren praktikat më të mira të zhvilluara përmes *Toolbox*-it të BE-së, duke koordinuar me autoritetet përkatëse, si dhe RSPG-në, duke parë mundësitë e

[2] Shih në veçanti komunikimet e Komisionit COM(2016) 587 dhe COM(2020) 67.

realizimit të ofrimit të pandërprerë të shërbimeve të konektivitetit që lidhet me fushat e transportit rrugor, hekurudhor apo prodhimin industrial.

Neni 12
**Raportimi**

Njësia "Zyra kompetente *Broadband*" raporton çdo gjashtë muaj pranë ministrit përgjegjës për zbatimin e masave të përcaktuara në këtë udhëzim.

Neni 13
**Hyrja në fuqi**

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR DHE
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
**Belinda Balluku**

**URDHËR**
**Nr. 1131, datë 27.12.2024**

**PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE TË DERRAVE NË KAFSHËT E GJALLA TË LLOJIT DERRA TË BUTË, NË MJEDISET E HAPURA DHE NË TREGJET E KAFSHËVE TË GJALLA**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës; në shkronjën "b" të nenit 15 dhe në nenin 21 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; në urdhrin nr. 241, datë 30.7.2012, "Për miratimin e rregullores mbi kontrollin e sëmundjes së murtajës afrikane të derrave"; në planin e kontigjencës nr. 10390/1 prot., datë 24.11.2020, "Për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e tregtimit të derrave të gjallë në mjediset e hapura dhe tregjet e kafshëve të gjalla, në territorin e Bashkisë Lezhë.

2. Ndalimin në territorin e Bashkisë Lezhë të lëvizjes së derrave të gjallë nga ferma në fermë, dhe nga ferma në tregje, panaire dhe ekspozitat e kafshëve të gjalla.

3. Veterineri zyrtar mund të autorizojë me miratim të titullarit të Drejtorisë Rajonale të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, lëvizjen e derrave për mbarështim, vetëm nga fermat pa prezencë të sëmundjes që ndodhen në zonën e mbrojtjes, për në thertoren më të afërt brenda zonës së mbrojtur ose në zonën e mbikëqyrur kur nuk është e mundur që kafshët të theren në zonën e mbrojtur.

4. Të kryhet inventarizimi dhe gjurmimi me teste laboratorike konfirmatore për sëmundjen e Murtajës Afrikane të Derrave në zonat e mbrojtjes dhe mbikëqyrjes, në njësitë administrative: Shëngjin, Kolsh, Zejmen, Lezhë, Balldre, Kallmet dhe Shënkoll të Bashkisë Lezhë.

5. Të forcohet marrja e masave për kontrollin e lëvizjes së kafshëve, zbatimin e masave të biosigurisë dhe masave sanitaro-veterinare në zonën e mbrojtjes dhe mbikëqyrjes në Njësitë Administrative Shëngjin, Kolsh, Zejmen, Lezhë, Balldre, Kallmet dhe Shënkoll.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
**Anila Denaj**

**URDHËR**
**Nr. 1132, datë 28.12.2024**

**PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE NË SHPENDË, NË MJEDISET E HAPURA DHE NË TREGJET E KAFSHËVE TË GJALLA**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës; në shkronjën "b" të nenit 15 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën

e Shqipërisë", të ndryshuar; në urdhrit nr. 117, datë 19.3.2022, "Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së influencës aviare në shpendë", në urdhrin nr. 411, datë 20.9.2022, "Për miratimin e planit të kontigjencës për sëmundjen e influencës aviare"; dhe në urdhrin nr. 177, datë 28.3.2023, "Për miratimin e programit kombëtar të mbikëqyrjes së influencës aviare",

URDHËROJ:

1. Ndalimin e shitjes dhe tregtimit të shpendëve të gjallë në mjediset e hapura dhe tregjet e kafshëve të gjalla në territorin e njësive administrative Zall-Herr, Zall Bastar, Kashar, Shëngjergj, Bërxullë dhe Prezë.

2. Ndalimin e lëvizjes së shpendëve të gjallë nga ferma në fermë dhe nga ferma në tregjet e kafshëve të gjalla në territorin e njësive administrative Zall-Herr, Zall Bastar, Kashar, Shëngjergj, Bërxullë dhe Prezë.

3. Lejimin e lëvizjes së shpendëve të gjallë sipas tabelës 4, të shtojcës 5, të urdhrit nr. 177, datë 28.3.2023, "Për miratimin e programit kombëtar të mbikëqyrjes së Influencës aviare", vetëm me autorizim të veterinerit zyrtar për në thertore, pasi është kryer testi i PCR-së dhe shpendët kanë rezultuar negativ ndaj sëmundjes së influencës aviare dhe të jenë shoqëruar me certifikatën shëndetësore të lëvizjes së shpendëve, në territorin e njësive administrative Zall-Herr, Zall Bastar, Kashar, Shëngjergj, Bërxullë dhe Prezë.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
**Anila Denaj**

**URDHËR**
**Nr. 1136, datë 30.12.2024**

**PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE NË SHPENDË, NË MJEDISET E HAPURA DHE NË TREGJET E KAFSHËVE TË GJALLA**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës; në shkronjën "b" të nenit 15 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; në urdhrin nr. 117, datë 19.3.2022, "Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së influencës aviare në shpendë"; në urdhrin nr. 411, datë 20.9.2022, "Për miratimin e planit të kontigjencës për sëmundjen e influencës aviare"; dhe në urdhrin nr. 177, datë 28.3.2023, "Për miratimin e programit kombëtar të mbikëqyrjes së influencës aviare",

URDHËROJ:

1. Ndalimin e shitjes dhe të tregtimit të shpendëve të gjallë në mjediset e hapura dhe në tregjet e kafshëve të gjalla në territorin e:
- Njësive administrative Zall-Herr, Zall-Bastar, Shëngjergj dhe Kashar të Bashkisë Tiranë;
- Njësive administrative Kamzë dhe Paskuqan të Bashkisë Kamzë;
- Njësive administrative Bërxull dhe Prezë të Bashkisë Vorë;
- Njësive administrative Fushë-Krujë dhe Nikël të Bashkisë Krujë.

2. Ndalimin e lëvizjes së shpendëve të gjallë nga ferma në fermë dhe nga ferma në tregjet e kafshëve të gjalla në territorin e:
- Njësive administrative Zall-Herr, Zall-Bastar, Shëngjergj dhe Kashar të Bashkisë Tiranë;
- Njësive administrative Kamzë dhe Paskuqan të Bashkisë Kamzë;
- Njësive administrative Bërxull dhe Prezë të Bashkisë Vorë;
- Njësive administrative Fushë-Krujë dhe Nikël të Bashkisë Krujë.

3. Lejimin e lëvizjes së shpendëve të gjallë sipas tabelës 4, të shtojcës 5, të urdhrit nr. 177, datë 28.3.2023, "Për miratimin e programit kombëtar të

mbikëqyrjes së influencës aviare", vetëm me autorizim të veterinerit zyrtar për në thertore, pasi është kryer testi i PCR-së dhe shpendët kanë rezultuar negativ ndaj Sëmundjes së Influencës Aviare dhe të jenë shoqëruar me certifikatën shëndetësore të lëvizjes së shpendëve, në territorin e:

- Njësive administrative Zall-Herr, Zall-Bastar, Shëngjergj dhe Kashar të Bashkisë Tiranë;
- Njësive administrative Kamzë dhe Paskuqan të Bashkisë Kamzë;
- Njësive administrative Bërxull dhe Prezë të Bashkisë Vorë;
- Njësive administrative Fushë-Krujë dhe Nikël të Bashkisë Krujë.

4. Urdhri nr. 1132, datë 28.12.2024, "Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e Sëmundjes së Influencës Aviare në shpendë, në mjediset e hapura dhe në tregjet e kafshëve të gjalla", shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
**Anila Denaj**

## VENDIM
## Nr. 265, datë 10.12.2024

## MBI MIRATIMIN E DISA SHTESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË RREGULLAT E TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË MIRATUARA ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 347, DATË 27.12.2022, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 16,18, pika 1, germat "a" dhe "dh" si dhe neneve 57 dhe 98, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 26 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.12.2024, pasi shqyrtoi relacionin nr. 1762/7 prot., datë 6.12.2024, të përgatitur nga drejtoritë teknike "Mbi miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 347, datë 27.12.2022, i ndryshuar",

konstatoi se:

- Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (ALPEX), me shkresën protokolluar në ERE nr. 1762, datë 14.8.2024, ka përcjellë kërkesën për miratimin e disa ndryshimeve në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike (Kushtet e përgjithshme, përkufizimet, procedura e tregtimit, si dhe procedura e klerimit dhe shlyerjes) të miratuara me vendimin e bordit të ERE nr. 347, datë 27.12.2022, i ndryshuar. Bordi i ERE-s me vendimin nr. 224, datë 23.10.2024, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së ALPEX sh.a.

- Me shkresën nr. 2339 prot., datë 4.11.2024, në zbatim të "Rregullores mbi procedurat e njoftimit dhe konsultimit publik të akteve të miratuara nga Enti Rregullator i Energjisë", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 162, datë 20.10.2020, u morën masa për njoftimin e të gjitha palëve të interesit si më poshtë: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE); Ministria e Financës dhe Ekonomisë (MFE); Zyra e Rregullatorit të Energjisë; Autoriteti i Konkurrencës (AK); Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike (ALPEX) sh.a.; Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH) sh.a.; Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a.; Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a.; Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a.; Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES); Shoqata Shqiptare e Energjisë së Rinovueshme (AREA); Kurum International sh.a.; Devoll Hydropower sh.a.; Ayen Energji AS; si dhe Sekretariati i Energjisë Elektrike.

- Vendimi nr. 224, datë 23.10.2024, u botua në faqen zyrtare të internetit të ERE-s: www.ere.gov.al, në seksionin "Vendime". Në zbatim të pikës 2 të dispozitivit, seksionet e propozuara nga ALPEX-i për t'u ndryshuar u paraqitën në formë tabelare, bashkëlidhur këtij vendimi, dhe u publikuan në seksionin "Konsultime" në faqen e internetit të ERE-s.

- Shoqëria "SPV BLUE 1" sh.p.k., me shkresën protokolluar në ERE nr. 2384, datë 12.11.2024,

paraqiti komente mbi ndryshimet e propozuara në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, të cilat u publikuan në seksionin "Konsultime". Me urdhrin e kryetarit, ERE njoftoi shoqëritë "SPV BLUE 1" sh.p.k., ALPEX sh.a., OST sh.a., FSHU sh.a., KESH sh.a., AREA dhe AAES për zhvillimin e një seance dëgjimore, më datë 18.11.2024, në ambientet e ERE-s.

- Propozimet e shoqërisë "SPV BLUE 1" sh.p.k. mbi ndryshimet në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike sa më poshtë vijojnë:

- Ndërhyrje në **seksionin** A.2.4.4 "*Çdo urdhërporosi e thjeshtë mund të përfshijë deri në (50) çifte çmim-sasi për çdo njësi kohore tregu*". Ky propozim u pranua nga ALPEX-i dhe palët e tjera si i drejtë. Vlerësojmë pranimin e këtij propozimi pasi ky ndryshim rrit fleksibilitetin dhe lejon pjesëmarrësit në treg të japin oferta më të detajuara, duke përmirësuar konkurrencën dhe efikasitetin operacional.

- Ndërhyrja në **seksionin** B.1.2.2 përfshin një shtesë të propozuar nga ALPEX-i, duke shtuar në fund të fjalisë togfjalëshin "*si dhe parashikimeve të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike*". Për të bërë formulimin më të saktë dhe gjithëpërfshirës shoqëria "SPV BLUE 1", propozon që të specifikohet më tej përkufizimi duke përfshirë referencën konkrete në "*Kushtet e përgjithshme*," duke siguruar një interpretim të qartë dhe të harmonizuar me dispozitat ekzistuese. Ky propozim i shoqërisë u pranua nga palët e përfshira në seancë, vlerësojmë se ky ndryshim siguron qartësi dhe harmonizim me dispozitat ekzistuese, duke reduktuar hapësirën për interpretime subjektive.

- Ndërhyrja në **seksionin** B.2.3.6 synon të qartësojë formulimin e fjalisë, pasi në dokumentin e publikuar me propozimet e ALPEX-it mungonin referencat e sakta të seksioneve. Konkretisht, fjalia që duhet të qartësohet është: "*ALPEX-i duhet të bëjë një njoftim siç kërkohet në paragrafin B.2.3.2, me anë të një njoftimi për tregun të dërguar me mjete elektronike në përputhje me pikën C.3.2 të kushteve të përgjithshme të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike.*". Këto referenca mbeten të pandryshuara nga ato të përfshira në tekstin aktual të rregullave të tregut.

- Ndërhyrja në **seksionin** C.1.6.1 të rregullave të tregut, ku në materialin e publikuar të propozimeve të ALPEX-it referohet si pika C.1.6.4 për shkak të shtimeve të paragrafëve të tjerë C.1.6.1; C.1.6.2 dhe C.1.6.3. ALPEX-i ka propozuar që përveçse C.1.6.1 të bëhet C.1.6.4, por dhe teksti i këtij paragrafi të jetë: "*Operatori i Bashkimit të Tregut* ***të Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë*** *është përgjegjës për kryerjen e Funksionit të Operimit të Bashkimit të Tregjeve. Funksioni i Bashkimit të Tregjeve është një shërbim i ofruar ALPEX-it nga Ofruesi i tij i Shërbimit të Bashkimit të Tregjeve.*". Shoqëria "SPV BLUE 1" shprehet se Operatori i Bashkimit të Tregut do të jetë i njëjtë si për tregun brenda së njëjtës ditë ashtu edhe për tregun e dietës në avancë, ndaj specifikimi i propozuar nga ALPEX-i ose duhet të përfshijë edhe togfjalëshin "ankandet e ditës në avancë" ose duhet të lihet i pandryshuar. Palët u dakordësuan me propozimin e shoqërisë "SPV BLUE 1" sh.p.k., ndaj vlerësojmë që të shtohet edhe referenca për **ankandet e Ditës në Avancë** në përkufizim, konkretisht **seksioni** C.1.6.1 të bëhet **seksioni** C.1.6.4 me këtë përmbajtje: "*Operatori i Bashkimit të Tregut* ***të Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë dhe Ankandeve të Ditës në Avancë*** *është përgjegjës për kryerjen e Funksionit të Operimit të Bashkimit të Tregjeve. Funksioni i Bashkimit të Tregjeve është një shërbim i ofruar ALPEX-it nga Ofruesi i tij i Shërbimit të Bashkimit të Tregjeve.*".

- Ndërhyrja në shtojcën A, tabelën A.1 (Specifikimet e produkteve të Segmentit të Tregut të Ditës në Avancë), për urdhërporositë në Bllok, aktualisht përcaktohet, si: "*Numri minimal dhe maksimal i çifteve çmim-sasi: ndërmjet 2 dhe 50, për urdhërporosi për çdo njësi kohore e tregut.*" Në lidhje me këtë përkufizim, ALPEX-i ka propozuar vetëm një saktësim ortografik, ndërsa shoqëria "SPV BLUE 1" ka sugjeruar një ndryshim më gjithëpërfshirës. Propozimi i "SPV BLUE 1" formulon: "*Numri minimal dhe maksimal i MTU-ve dhe çifteve çmim-sasi: 1. Numri minimal i MTU-ve në bllok për një portofol është 1 (një) dhe maksimal është 24 (njëzet e katër). 2. Një çift çmim-sasi.*". Ky ndryshim bazohet në argumentin se procedura e tregtimit të urdhërporosive në bllok përfshin vetëm një çmim dhe një sasi, duke reflektuar qartë realitetin operacional dhe duke shmangur paqartësitë. Ky propozim u pranua nga ALPEX-i dhe palët e tjera të pranishme në seancë, pasi u vlerësua si më i saktë dhe i përshtatshëm për realitetin operacional të tregut. Vlerësojmë se ndryshimi i propozuar është në përputhje me logjikën e funksionimit të urdhërporosive në bllok, të cilat kanë një **MTU unik** dhe një çmim për njësi kohore të tregut, si dhe pranimi i tij do të

përmirësojë fleksibilitetin dhe efikasitetin në përgatitjen dhe ekzekutimin e urdhërporosive.

- Ndërhyrja në shtojcën A, tabelën A.1 (Specifikimet e produkteve të Segmentit të Tregut të Ditës në Avancë), për urdhërporositë të lidhura në Bllok, aktualisht përcaktohet si: "***Urdhërporositë-*** *Përbëhen nga të paktën dy urdhërporosi individuale në Bllok*", ALPEX-i ka propozuar ndryshimin e këtij përkufizimi në "***Numri maksimal i urdhërporositë në Bllok-*** *Përbëhen nga të paktën dy urdhërporosi individuale në Bllok*" ndërsa shoqëria "SPV BLUE 1" sh.p.k. propozon "***Kufizimet lidhur me urdhërporositë të lidhura në Bllok****- 1. Numri maksimal i urdhërporosive të lidhura në Bllok për portofol është 5 (pesë). 2. Numri maksimal i urdhërporosive vartëse të lidhura me një urdhërporosi udhëheqëse është 4 (katër). 3. Numri maksimal i urdhërporosive udhëheqëse të lidhura me një urdhërporosi vartëse është 1 (një).*". Shoqëria argumenton se ky informacion duhet të jetë i detajuar për të pasur më të qartë si funksionojnë urdhërporositë të lidhura në Bllok dhe cilat janë kufizimet. Propozimi i SPV BLUE 1 për ndërhyrjen në qartësimin dhe detajimin e kufizimeve që lidhen me urdhërporositë të lidhura në Bllok u pranua nga ALPEX-i dhe palët e tjera të interesit. Vlerësojmë se propozimet e SPV BLUE 1 për shtimin e kufizimeve të qarta ofrojnë një kornizë më të qartë dhe më të saktë për rregullimin e urdhërporosive të lidhura në Bllok.

- Gjatë procesit të konsultimit publik, ZRRE ka kërkuar që seksioni H.4.3.4, i cili parashikon publikimin e raporteve mujore me informacion të përmbledhur mbi aktivitetin e tregut, të mbetet i pandryshuar, duke mos pranuar propozimin e ALPEX-it për fshirjen e tij. Ky seksion plotëson detyrimet e seksionit H.4.3.3, që përcakton publikimin e informacionit kyç të tregut për çdo njësi kohore tregu, duke ofruar transparencë dhe analizë të thelluar mbi funksionimin e tregut në bazë mujore. Raportet mujore ndihmojnë në monitorimin e trendeve dhe mbikëqyrjen e tregut, një element i rëndësishëm për autoritetet rregullatore dhe palët e interesuara. Duke qenë se Bursa ALPEX është një platformë e re dhe këto detyrime janë kyçe për transparencën dhe kontrollin e tregut, vlerësohet që fshirja e seksioneve H.4.3.3 dhe H.4.3.4 nuk duhet të pranohet.

- Ndërhyrja në përkufizimin "Çmim klerues i tregut" i cili aktualisht është "*Nënkupton çmimin e vendosur nga përputhja e urdhërporosisë shitjeje të pranuar me çmimin më të lartë me urdhërporosinë blerjeje të pranuar me çmimin më të ulët në tregun e energjisë elektrike*" ALPEX-i ka propozuar të fshihet si përkufizim, ndërsa shoqëria "SPV BLUE 1" propozon të mos fshihet ky përkufizim me argumentin që përdoret shpesh gjatë rregullave të tregut. Ky propozim u pranua nga palët në seancë dhe ne vlerësojmë se përkufizimi aktual për "Çmim klerues i tregut" është një përshkrim i qartë i mekanizmit të përcaktimit të çmimit të klerimit në treg. Vlerësojmë se ruajtja e këtij çmimi është thelbësore për të siguruar transparencë në treg dhe për t'i lejuar pjesëmarrësit të kuptojnë dinamikën e tregut në mënyrë të drejtë dhe të hapur.

- Gjithashtu, gjatë fazës së shqyrtimit të kërkesës së ALPEX sh.a. për disa shtesa dhe ndryshime në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, në kuadër të procedurës së filluar nga ERE, është dorëzuar edhe disa shkresa të tjera, që lidhen drejtpërdrejt me vendimmarrjen për miratimin e ndryshimeve lidhur me implementimin e tregut brenda së njëjtës ditë të Bursës Shqiptare të Energjisë.

- Konkretisht, **shoqëria ALPEX sh.a.**, me shkresën nr. 354 prot., datë 27.9.2024, me lëndë: *"Propozim për miratimin e çmimit maksimal klerues të ankandit të tregut brenda së njëjtës ditë, çmimit minimal klerues të ankandit të tregut brenda së njëjtës ditë, çmimit maksimal të urdhërporosive të tregut të ankandeve brenda së njëjtës ditë dhe çmimit minimal të urdhërporosive të tregut të ankandeve brenda së njëjtës ditë"* ka paraqitur për shqyrtim propozimet për miratimin e kufijve të çmimeve për Tregun e Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë, si dhe me shkresën nr. 2002 prot., datë 27.9.2024, me lëndë "*Propozim për miratimin e çmimit maksimal klerues të ankandit të tregut të ditës në avancë, çmimit minimal klerues të ankandit të tregut të ditës në avancë, çmimi maksimal i urdhërporosive i tregut të ditës në avancë dhe çmimit minimal i urdhërporosive i tregut të ditës në avancë"* ka paraqitur për shqyrtim propozimet për disa ndryshime në terminologjinë e përdorur për çmimet maksimale dhe minimale të urdhërporosive për tregun e ditës në avancë, të cilat gjenden në aneksin nr. 2 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, aneks i miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 23.3.2023 si disa shtesa në rregullat e tregut të energjisë elektrike, të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 347, datë 27.12.2022, i ndryshuar.

- Në këtë kuadër, vlerësohet i nevojshëm rishikimi i aneksit nr. 2 të Rregullave të Tregut të

Energjisë Elektrike, të miratuara nga ERE dhe miratimi i disa shtesave dhe ndryshimeve në këtë praktikë.

- Propozimi i ALPEX sh.a. për miratimin e çmimeve maksimale dhe minimale kleruese dhe të urdhërporosive për Tregun e Ankandeve të Ditës në Avancë dhe atij Brenda së Njëjtës Ditë bazohet në përkufizimet e Rregullave të ALPEX-it dhe praktikat e ndjekura nga bursat energjetike evropiane.

- Në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për të nxitur konkurrencën, trajtimin e drejtë të operatorëve dhe një formim të drejtë të çmimeve, me propozimin e ALPEX-it, vlerësojmë që aneksi nr. 2 i Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, të ndryshohet si më poshtë:

***Është:***

ANEKS NR. 2

ÇMIMET MAKSIMALE DHE MINIMALE TË URDHËRPOROSIVE PËR TREGUN E ANKANDEVE TË DITËS NË AVANCË

1. Çmimi i lejuar minimal për ankandin e tregut të ditës në avancë të jetë: -500€/MWh;

2. Çmimi i lejuar maksimal për ankandin e tregut të ditës në avancë të jetë: 4,000€/MWh.

***Propozohet të bëhet:***

ANEKS NR. 2

ÇMIMET MAKSIMALE DHE MINIMALE TË KLERIMIT PËR TREGUN E ANKANDE-VE TË DITËS NË AVANCË DHE TREGUN BRENDA SË NJËJTËS DITË

**1. Tregu i Ditës në Avancë (DAM):**

- Çmimi maksimal klerues: +4,000 €/MWh;
- Çmimi minimal klerues: -500 €/MWh;
- Çmimi maksimal i urdhërporosive: +4,000 €/MWh;
- Çmimi minimal i urdhërporosive: -500 €/MWh.

**2. Tregu Brenda së Njëjtës Ditë (IDM):**

- Çmimi maksimal klerues: +9,999 €/MWh;
- Çmimi minimal klerues: -9,999 €/MWh;
- Çmimi maksimal i urdhërporosive: +9,999 €/MWh;
- Çmimi minimal i urdhërporosive: -9,999 €/MWh.

- Propozimi i ALPEX sh.a. për miratimin e kufijve minimalë dhe maksimalë të çmimeve lidhet me mundësinë e realizimit të një ankandi të dytë, duke siguruar një zbatim të drejtë dhe efikas të procedurës së tregtimit. Ky proces rregullativ garanton funksionimin efikas dhe të drejtë të tregut në përputhje me kuadrin ligjor të miratuar nga ERE. Kufijtë e propozuar për tregun brenda së njëjtës ditë (+9999 EUR/MWh dhe -9999 EUR/MWh) ofrojnë fleksibilitet për të menaxhuar variacione ekstreme dhe për të ruajtur integritetin e tregut. Për tregun e ditës në avancë, kufijtë e çmimeve mbeten të pandryshuar krahasuar me ato të miratuara më parë (vendimi nr. 106, datë 23.3.2023), por është harmonizuar terminologjia me atë të tregut brenda së njëjtës ditë për të siguruar koherencë.

- Diferenca në kufijtë e çmimeve midis DAM-it dhe IDM-së pasqyron funksionet e tyre të ndryshme: DAM ofron stabilitet dhe parashikueshmëri për planifikim një ditë përpara, ndërsa IDM-i siguron fleksibilitet për të reaguar ndaj ndryshimeve të papritura. Kufijtë më të ngushtë në DAM balancojnë çmimet dhe likuiditetin, ndërsa kufijtë më të gjerë në IDM garantojnë funksionimin e tregut në situata ekstreme. Kufijtë e IDM-së prej +9,999 EUR/MWh dhe -9,999 EUR/MWh janë në përputhje me rregulloret dhe praktikat evropiane, duke harmonizuar tregun shqiptar me Tregun e Brendshëm Evropian të Energjisë Elektrike.

- Gjithashtu, referuar Marrëveshjes Kornizë mbi bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës, të datës 21.10.2021, nënshkruar nga Enti Rregullator i Energjisë i Shqipërisë (ERE), Zyra e Rregullatorit për Energji e Kosovës (ZRRE), Operatori i Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë (OST) sh.a. dhe Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT) sh.a., ku është parashikuar se Rregullatorët do të koordinohen në të njëjtën kohë për miratimin e termave, kushteve ose metodologjive, ALPEX-i bën me dije se ky propozim për ndryshim të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike është paraqitur edhe pranë ZRRE-së, në mënyrë që këto ndryshime të aprovohen në përmbajtje të njëjtë.

1.Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Në "Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike (rregullat e ALPEX-it, përkufizimet, procedura e tregtimit, si dhe procedura e klerimit dhe shlyerjes)", të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 347, datë 27.12.2022, i ndryshuar, bëhen disa shtesa dhe ndryshime sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Aneksi nr. 2 i Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 347, datë 27.12.2022, i ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:

*ÇMIMET MAKSIMALE DHE MINIMALE TË KLERIMIT PËR TREGUN E ANKANDEVE TË DITËS NË AVANCË DHE TREGUN BRENDA SË NJËJTËS DITË*

***Tregu i Ditës në Avancë (DAM):***

- *Çmimi maksimal klerues: +4,000 €/MWh;*
- *Çmimi minimal klerues: -500 €/MWh;*
- *Çmimi maksimal i urdhërporosive: +4,000 €/MWh;*
- *Çmimi minimal i urdhërporosive: -500 €/MWh.*

***Tregu Brenda së Njëjtës Ditë (IDM):***

- Çmimi maksimal klerues: +9,999 €/MWh;
- Çmimi minimal klerues: -9,999 €/MWh;
- Çmimi maksimal i urdhërporosive: +9,999 €/MWh;
- Çmimi minimal i urdhërporosive: -9,999 €/MWh.

3. Ndryshimet e miratuara në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi janë pjesë integrale e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 347, datë 27.12.2022, i ndryshuar.

4. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqërinë ALPEX sh.a. dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Petrit Ahmeti**

| **RREGULLAT E TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE – KUSHTET E PËRGJITHSHME** | | |
|---|---|---|
| **Seksionet, paragrafët, nënparagrafët** | | **Përshkrimi** |
| *është* | **C.2.2.1** | Anëtari i Bursës do të jetë në kushtet e mospërmbushjes së detyrimeve kur është në shkelje të ndonjërës nga dispozitat e këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, procedurave ose Marrëveshjes për Anëtarësim në Bursë dhe përfshin pa kufizim dështimin për të paguar ose shkakun e mospagimit të një shume parash ose shkeljen e një ose më shumë dispozitave të sjelljes në kapitullin D. |
| *bëhet* | | Anëtari i Bursës do të jetë në kushtet e mospërmbushjes së detyrimeve kur është në shkelje të ndonjërës nga dispozitat e këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, procedurave ose Marrëveshjes për Anëtarësim në Bursë dhe përfshin pa kufizim dështimin për të paguar ose mospagimit e një shume parash te personat për t'u dëmshpërblyer sipas parashikimeve të seksionit G.3.2 ose shkeljen e një ose më shumë dispozitave të sjelljes në kapitullin D. |
| *është* | **E.2.3.2** | Urdhërporositë e dërguara në ALPEX nga anëtarët e Bursës duhet të jenë në përputhje me të gjitha kërkesat në fuqi të përcaktuara në procedurat dhe të përfshijnë të paktën informacionin e mëposhtëm:<br>(a)Identifikimin e anëtarit të Bursës;<br>(b)Segmentin e tregut të cilit i referohet urdhërporosia;<br>(c)Portofoli me të cilën lidhet urdhërporosia;<br>(d)Njësia kohore e tregut për të cilën aplikohet urdhërporosia;<br>(e)Sasia ose sasitë e urdhërporosisë;<br>(f)Kufizimet e ekzekutimit nëse ka; dhe<br>(g)nëse urdhërporosia është një urdhërporosi blerjeje ose shitjeje. |

| | | |
|---|---|---|
| *bëhet* | | Urdhërporositë e dërguara në ALPEX nga anëtarët e Bursës duhet të jenë në përputhje me të gjitha kërkesat në fuqi të përcaktuara në procedurat dhe të përfshijnë të paktën informacionin e mëposhtëm:<br>(a)Identifikimin e anëtarit të Bursës;<br>(b)Segmentin e tregut të cilit i referohet urdhërporosia;<br>(c)Portofoli me të cilën lidhet urdhërporosia;<br>(d)Njësia kohore e tregut për të cilën aplikohet urdhërporosia;<br>(e)Sasia ose sasitë e urdhërporosisë;<br>(f)Çmimin për të shitur ose për të blerë energji;<br>(g)Kufizimet e ekzekutimit nëse ka; dhe<br>(h)nëse urdhërporosia është një urdhërporosi blerjeje ose shitjeje. |
| *është* | **E.2.3.6 (a)** | nuk ka përgjegjësi për të ndjekur zbatimin e paraqitjes së një urdhërporosie nga një anëtar i Bursës apo çështje të tjera të informacionit që lidhen me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike: |
| *bëhet* | | nuk ka përgjegjësi për të ndjekur dorëzimin e një urdhërporosie nga një anëtar i Bursës apo çështje të tjera të informacionit që lidhen me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike: |
| *është* | **E.2.3.7 (a)** | Kapacitetin e disponueshëm ndërkufitar; dhe |
| *bëhet* | | Kapacitetin e vlefshëm ndërkufitar; dhe |
| *është* | **E.2.6.2 (a)** | Gjatë ankandit, të gjitha urdhërporositë e dorëzuara nga koha e hapjes së portës deri në kohën e mbylljes së portës pranohen për ekzekutim nga ETSS-ja. Të gjitha urdhërporositë e pranuara sipas rregullave të aplikueshme të vlefshmërisë, sipas rastit, futen në librin e urdhërporosive pasi marrin gjurmën e kohës përkatëse. |

| | | |
|---|---|---|
| *bëhet* | | Gjatë ankandit, të gjitha urdhërporositë e dorëzuara sipas Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike nga koha e hapjes së portës deri në kohën e mbylljes së portës pranohen për ekzekutim nga ETSS-ja. Të gjitha urdhërporositë e pranuara sipas rregullave të aplikueshme të vlefshmërisë, sipas rastit, futen në librin e urdhërporosive pasi marrin gjurmën kohore përkatëse. |
| *është* | **E.2.6.2 (b)** | me përfundimin e kohës së mbylljes së portës së ankandit, të gjitha urdhërporositë e pranuara të blerjes dhe shitjes mblidhen nga libri i urdhërporosive dhe më pas algoritmi llogarit balancimin e energjise elektrike të tregtuar, sasitë e pranuara të urdhërporosive të blerjes dhe shitjes dhe çmimin e balancuar në çdo ankand. |
| *bëhet* | | me përfundimin e kohës së mbylljes së portës së ankandit, të gjitha urdhërporositë e pranuara të blerjes dhe shitjes mblidhen nga libri i urdhërporosive dhe më pas algoritmi llogarit balancimin e energjisë elektrike të tregtuar, sasitë e pranuara të urdhërporosive të blerjes dhe shitjes dhe çmimin klerues në çdo ankand. |
| *është* | **E.2.6.3 (a)** | Gjatë tregtimit të vazhdueshëm, të gjitha urdhërporositë që janë dorëzuar nga koha e hapjes së portës deri në kohën e mbylljes së portës pranohen për ekzekutim nga ETSS-ja. Me dorëzimin e tyre në ETSS, urdhërporositë e pranuara sipas metodës së tregtimit të vazhdueshëm, regjistrohen në librin e urdhërporosive pasi marrin gjurmën e kohës përkatëse. |
| *bëhet* | | Gjatë tregtimit të vazhdueshëm, të gjitha urdhërporositë që janë dorëzuar sipas Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike nga koha e hapjes së portës deri në kohën e mbylljes së portës pranohen për ekzekutim nga ETSS-ja. Me dorëzimin e tyre në ETSS, urdhërporositë e pranuara sipas metodës së tregtimit të vazhdueshëm, regjistrohen në librin e urdhërporosive pasi marrin gjurmën kohore përkatëse. |
| *është* | **F.2.2.2** | Alokimi i portofolit (p.sh. Rregulli i Pranimit të Urdhërporosive) duhet të përfshihet në procedurën e tregtimit. |
| *bëhet* | | ***Shfuqizohet*** |

| | | |
|---|---|---|
| *është* | **F.2.2.6** | Orët e tregtimit në tregjet e ALPEX-it shpallen në kalendarin e tregtimit nga ALPEX-i në faqen e tij zyrtare të internetit. Kalendari i tregtimit shpallet 2 (dy) muaj para përfundimit të çdo viti për vitin pasardhës dhe përditësohet, nëse kërkohet, me vendim teknik të ALPEX-it të lëshuar në të njëjtën ditë kur ALPEX-i vihet në dijeni të arsyes për përditësimin e kalendarit të tregtimit. |
| *bëhet* | | ***Shfuqizohet*** |
| *është* | **F.2.5.1** | Libri i urdhërporosisë është një listë elektronike e urdhërporosive të blerjeve dhe shitjeve. Librat e urdhërporosive mbahen nga ALPEX-i për çdo segment tregu, njësi kohore tregu dhe ditë livrimi. |
| *bëhet* | | Libri i urdhërporosisë është një listë elektronike e urdhërporosive të blerjeve dhe shitjeve. Librat e urdhërporosive mbahen nga ALPEX-i për çdo segment tregu të ditës përkatëse të livrimit. |
| *është* | **F.2.7.4** | Kur është e nevojshme, ALPEX-i mund të zbatojë rregullat e trajtimit të barabartë në lidhje me rezultatet e segmenteve të tregut të ankandit të ditës në avancë dhe ankandit brenda së njëjtës ditë, në përputhje me procedurat. |
| *bëhet* | | ***Shfuqizohet*** |
| *është* | **F.2.8.1** | ALPEX-i duhet t'i publikojë të dhënat e tregut në përputhje me procedurat për publikimin e tyre. |
| *Bëhet* | | ALPEX-i duhet t'i publikojë të dhënat e tregut në përputhje me parashikimet për publikimin e tyre. |
| *është* | **F.3.1.1 (h)** | pengojnë zhvillimin e një ankandi në rrethana normale dhe dërgimin e rezultateve të ankandit brenda kufijve minimal ose maksimal të lejuar të çmimit të ankandit. |

| | | |
|---|---|---|
| *bëhet* | | pengojnë zhvillimin e një ankandi në rrethana normale dhe dërgimin e rezultateve të ankandit brenda çmimeve kleruese minimal ose maksimal i tregut. |
| *është* | **F.4.3.1** | Çdo anëtar i Bursës duhet që të caktojë 1 (një) agjent tregtar të certifikuar për tregtim në emër të anëtarit të Bursës në secilin prej tregjeve të ALPEX-it ku anëtari merr pjesë, miratimi i të cilit nuk do të ndalohet pa arsye nga ALPEX-i. Anëtari i Bursës mund të caktojë të njëjtin person si agjent tregtar të certifikuar në disa tregje të ALPEX-it. |
| *bëhet* | | Çdo anëtar i Bursës duhet që të caktojë të paktën një (1) agjent tregtar të certifikuar për tregtim në emër të anëtarit të Bursës në secilin prej tregjeve të ALPEX-it ku anëtari merr pjesë, miratimi i të cilit nuk do të ndalohet pa arsye nga ALPEX-i. Anëtari i Bursës mund të caktojë të njëjtin person si agjent tregtar të certifikuar në disa tregje të ALPEX-it. |
| *është* | **F.4.3.2** | Përveçse kur është rënë dakord ndryshe me ALPEX-in, agjenti tregtar i certifikuar do të ketë qasje të plotë në ETSS në lidhje me të gjithë portofolat e tregtimit të anëtarit respektive të Bursës për secilin nga tregjet e ALPEX-it për të cilët ai është caktuar. Çdo anëtar i Bursës duhet të sigurojë që agjenti i tij tregtar i certifikuar të jetë plotësisht i autorizuar të përfaqësojë anëtarin e Bursës në ALPEX në të gjitha çështjet që lidhen me tregtimin e anëtarit të Bursës në secilin treg të ALPEX-it për të cilën ai është emëruar. Agjenti tregtar i certifikuar do të jetë në gjendje të ndërmarrë një veprim në mënyrën e duhur në lidhje me afatet kohore ditore dhe kërkesat e tjera në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike në tërësinë e tyre. |
| *bëhet* | | Agjenti tregtar i certifikuar do të ketë qasje të plotë në ETSS në lidhje me të gjithë portofolat e tregtimit të anëtarit respektiv të Bursës për secilin nga tregjet e ALPEX-it. Çdo anëtar i Bursës duhet të sigurojë që agjenti i tij tregtar i certifikuar të jetë plotësisht i autorizuar të përfaqësojë anëtarin e Bursës në ALPEX në të gjitha çështjet që lidhen me tregtimin e anëtarit të Bursës në secilin treg të ALPEX-it. Agjenti tregtar i certifikuar do të jetë në gjendje të ndërmarrë një veprim në mënyrën e duhur në lidhje me afatet kohore ditore dhe kërkesat e tjera në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike në tërësinë e tyre. |

| | | |
|---|---|---|
| *është* | **F.4.3.4** | Në rast se agjenti tregtar i certifikuar është revokuar, ALPEX-i do t'i dorëzojë anëtarit të Bursës një llogari përdoruesi të re për hyrjen në ETSS për një treg të caktuar të ALPEX-it, vetëm pasi anëtari i Bursës të ketë emëruar një agjent të ri tregtar që duhet Certifikuar nga ALPEX-i. |
| *bëhet* | | Në rast se agjenti tregtar i certifikuar është revokuar si përfaqësues i anëtarit të Bursës, ALPEX-i do të çaktivizojë llogarinë e tij në ETSS. ALPEX-i do t'i dorëzojë anëtarit të Bursës një llogari përdoruesi të re për hyrjen në ETSS për një treg të caktuar të ALPEX-it, vetëm pasi anëtari i Bursës të ketë emëruar një agjent tjetër tregtar të certifikuar dhe të informoj ALPEX-in. |
| *është* | **G.2.1.4** | "Kalendari i procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes" në lidhje me secilën kategori mosmarrëveshjesh do të jetë procesi dhe orari i përcaktuar nga ALPEX-i, i cili do të specifikojë afatet dhe programin kohor për marrjen e veprimeve sipas këtij seksioni G.2, në lidhje me një mosmarrëveshje në secilën kategori. ALPEX-i do të hartojë kalendarin e procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, duke u bazuar në parimin "I pari në radhë, i pari në shërbime" dhe do të publikojë kalendarin në faqen e tij të internetit. |

| | | |
|---|---|---|
| *bëhet* | | "Kalendari i procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes" në lidhje me secilën kategori mosmarrëveshjesh do të jetë procesi dhe orari i përcaktuar nga ALPEX-i, i cili do të specifikojë afatet dhe programin kohor për marrjen e veprimeve sipas këtij seksioni G.2, në lidhje me një mosmarrëveshje në secilën kategori. ALPEX-i do të hartojë kalendarin e procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, duke u bazuar në parimin "I pari në radhë, i pari në shërbime". |
| *është* | **G.2.3.2** | Kur një njoftim për mosmarrëveshje është dërguar, një përfaqësues i secilës nga Palët në mosmarrëveshje, i ngarkuar me autoritetin për të zgjidhur mosmarrëveshjen, do të takohet në përputhje me afatin kohor të përcaktuar në kalendarin e procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes për të kërkuar një zgjidhje në mirëbesim të mosmarrëveshjes. |
| *Bëhet* | **G.2.2.5** | Kur një njoftim për mosmarrëveshje është dërguar, një përfaqësues i secilës nga Palët në mosmarrëveshje, i ngarkuar me autoritetin për të zgjidhur mosmarrëveshjen, do të takohet në përputhje me afatin kohor të përcaktuar në kalendarin e procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes për të kërkuar një zgjidhje në mirëbesim të mosmarrëveshjes. |
| *është* | **G.2.3.3** | |
| *bëhet* | **G.2.3.2** | |
| *është* | **G.3.1.4 (c)** | humbjen e kontratave, humbjen e biznesit ose humbjen e mundësive; |
| *bëhet* | | humbjen e kontratave, humbjen e biznesit ose humbjen e fitimit të munguar; |
| *është* | **G.3.1.8** | Mos përmbushja e detyrimeve të anëtarit të Bursës në lidhje me tregtimet e tij në ALPEX, si rezultat i zbatimit të masave nga autoritetet gjyqësore ose administrative ndaj anëtarit të Bursës ose kryerja e parregullt të operacioneve në tregjet e ALPEX-it për shkak të zbatimit të këtyre masave, do të përbëjnë përgjegjësi të rreptë mbi baza objektive për një anëtar burse. Në mënyrë që të trajtohen kushtet e mësipërme, masat përkatëse merren ndaj anëtarit, në zbatim të dispozitave të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike. |
| *bëhet* | | Mos përmbushja e detyrimeve të anëtarit të Bursës në lidhje me tregtimet e tij në ALPEX, si rezultat i zbatimit të masave nga autoritetet gjyqësore ose administrative ndaj anëtarit të Bursës ose kryerja e parregullt e operacioneve në tregjet e ALPEX-it për shkak të zbatimit të këtyre masave do të sjellin përgjegjësi të prerë mbi baza objektive për një anëtar burse. Në mënyrë që të adresohen rrethanat e mësipërme, masat përkatëse merren ndaj anëtarit, në zbatim të dispozitave të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike. |
| *është* | **G.3.2.1** | Çdo anëtar i Bursës pranon të dëmshpërblejë dhe të mbajë të padëmtuar ALPEX-in nga ndonjë humbje, pretendim, kërkesë, dëm apo detyrim të ndonjë lloji, duke përfshirë shpenzimet e shkaktuara në mënyrë të arsyeshme për ALPEX-in në lidhje me hetimin, përgatitjen ose mbrojtjen e ndonjë veprimi hetimor, administrativ, gjyqësor ose rregullator ose procedimi në ndonjë juridiksion (të përmbledhura, "Detyrimet"), që kanë të bëjnë me ose lindin nga ndonjë shkelje nga anëtari i Bursës për detyrimet e tij nën këto Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrike dhe çdo Kontratë në të cilën ai është palë. Një anëtar i Bursës nuk do të jetë përgjegjës për zhdëmtimin në këtë paragraf G.3.2.1 përveç rasteve kur ndonjë detyrim vjen si pasojë e ndonjë neglizhence ose ndonjë shkelje nga ALPEX-i për detyrimet e tij sipas këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike. |

| | | |
|---|---|---|
| *bëhet* | | Çdo anëtar i Bursës pranon të dëmshpërblejë dhe të mbajë të padëmtuar ALPEX-in, filialet, drejtuesit, punonjësit, përfaqësuesit, kontraktorët dhe ofruesit e shërbimit të tij, anëtarët e Bursës dhe palët e treta të përfshira në operimin e bursës, në Bashkimin e Tregjeve në nivel rajonal ose evropian ose veprimtarinë e klerimit dhe shlyerjes (të përmbledhur, "Personat për t'u dëmshpërblyer") nga ndonjë humbje, pretendim, kërkesë, dëm apo detyrim të ndonjë lloji, duke përfshirë shpenzimet e shkaktuara në mënyrë të arsyeshme për personat për t'u dëmshpërblyer në lidhje me hetimin, përgatitjen ose mbrojtjen e ndonjë veprimi hetimor, administrativ, gjyqësor ose rregullator ose procedimi në ndonjë juridiksion (të përmbledhura, "Detyrimet"), që kanë të bëjnë me ose lindin nga ndonjë shkelje nga Anëtari i Bursës për detyrimet e tij nën këto Rregulla të Tregut të Energjisë Elektrike, Marrëveshja e Anëtarësimit në Bursë dhe çdo kontratë në të cilën ai është palë. Një anëtar burse nuk do të jetë përgjegjës për dëmshpërblimin në këtë paragraf G.3.2.1 në rastet kur detyrimet vijnë si pasojë e ndonjë neglizhence nga personat për t'u dëmshpërblyer ose ndonjë shkelje e detyrimeve të tyre sipas këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike. |
| *është* | **G.3.2.2** | Çdo anëtar i Bursës është i detyruar të dëmshpërblejë plotësisht të gjitha kostot që mund të lindin për ALPEX-in lidhur me TVSH-në, detyrimet doganore, kapacitetet ndërkufitare apo detyrime të tjera të ngjashme lidhur me energjinë elektrike, e cila tregtohej në tregjet e ALPEX-it, pasi këto kosto janë përgjegjësi e vetme e anëtarit në fjalë. |
| *bëhet* | | Çdo anëtar i Bursës është i detyruar të dëmshpërblejë plotësisht të gjitha kostot që mund të lindin për personat për t'u dëmshpërblyer lidhur me TVSH-në, detyrimet doganore, kapacitetet ndërkufitare apo detyrime të tjera të ngjashme lidhur me energjinë elektrike, e cila tregtohej në tregjet e ALPEX-it, pasi këto kosto janë përgjegjësi e vetme e anëtarit në fjalë. |
| *është* | | |
| *bëhet* | **H.4.1.1 (b) (vii)** | çdo të dhënë që ALPEX-i mund të përpunojë në të ardhmen. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | | |
| *bëhet* | **H.4.1.1 (c)** | Të dhënat e tjera që lidhen me paragrafët H.4.1.1 (a) ose H.4.1.1 (b) siç mund të jenë të parashikuara në procedurat. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | **H.4.2.4 (a)** | ALPEX-i zotëron të dhënat e paragrafit H.4.2.1, me përjashtim të të dhënave të pjesëmarrjes (paragrafi H.4.2.1 (a)) dhe të urdhërporosive të dërguara në ETSS (paragrafi H.4.2.1 (b),i)), pronësia e të cilëve u përket anëtarëve të Bursës. |
| *bëhet* | | ALPEX-i zotëron të dhënat e paragrafit H.4.1.1, me përjashtim të të dhënave të pjesëmarrjes (paragrafi H.4.1.1 (a)) dhe të urdhërporosive të dërguara në ETSS (nën paragrafi (H.4.1.1 (b) (i)), pronësia e të cilëve u përket anëtarëve të Bursës. |
| *është* | **H.4.2.4 (b)** | ALPEX-i rezervon të drejtën për të përdorur: a) të dhënat e pjesëmarrjes; dhe b) urdhërporositë e dërguara në ETSS, në mënyrë anonime, për qëllime të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi. ALPEX-i duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme organizative dhe procedurale dhe të zhvillojë mekanizmat e duhur të kontrollit për të siguruar përdorimin e saktë të të dhënave të mësipërme. |

| | | |
|---|---|---|
| *bëhet* | | ALPEX-i rezervon të drejtën për të përdorur H.4.1.1 (a), të dhënat e pjesëmarrjes dhe H.4.1.1 (b), urdhërporositë e dërguara në ETSS, në mënyrë anonime, për qëllime të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi. ALPEX-i duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme organizative dhe procedurale dhe të zhvillojë mekanizmat e duhur të kontrollit për të siguruar përdorimin e saktë të të dhënave të mësipërme. |
| *është* | **H.4.2.6 (a)** | ALPEX-i duhet të raportojë të dhënat e paragrafit H.4.2.1, autoriteteve kompetente, siç specifikohet në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike; ose |
| *bëhet* | | ALPEX-i duhet të raportojë të dhënat e paragrafit H.4.1.1, autoriteteve kompetente, siç specifikohet në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike; ose |

| | | |
|---|---|---|
| *është* | **H.4.3.2** | ALPEX-i do të publikojë të paktën informacionin e mëposhtëm të tregut për njësinë kohore të tregut për çdo ditë livrimi përpara kohës së hapjes së portës të tregut të ditës në avancë, duke qenë subjekt i ruajtjes së konfidencialitetit, dhe do të mbajë një arkiv të këtij informacioni për 5 (pesë) vjet, të arritshëm për të gjithë anëtarët e Bursës dhe palët e tjera të interesuara.<br>(a)lista e anëtarëve të pezulluar të Bursës; dhe<br>(b)çdo informacion tjetër që mund të caktohet me një vendim rregullator mbi rekomandimin e ALPEX-it. |
| *bëhet* | | ***Shfuqizohet*** |
| *është* | **H.4.3.3** | ALPEX-i do të publikojë të paktën informacionin e mëposhtëm të tregut për njësinë kohore të tregut për çdo ditë livrimi 60 (gjashtëdhjetë) minuta pas publikimit të rezultateve të tregut të ditës në avancë, duke ruajtur konfidencialitetin, dhe do të mbajë një arkiv të këtij informacioni për 5 (pesë) vjet, të arritshëm për të gjithë anëtarët e Bursës dhe palët e tjera të interesuara. |
| *Bëhet* | **H.4.3.2** | ALPEX-i do të publikojë të paktën informacionin e mëposhtëm të tregut për njësinë kohore të tregut për çdo ditë livrimi 60 (gjashtëdhjetë) minuta pas nxjerrjes së rezultateve të tregut të ditës në avancë, duke ruajtur konfidencialitetin, dhe do të mbajë një arkiv të këtij informacioni për 5 (pesë) vjet, të arritshëm për të gjithë anëtarët e bursës dhe palët e tjera të interesuara sipas termave dhe kushteve të përcaktuara nga ALPEX-i. |
| *është* | **H.4.3.3 (d)** | Skedulimi i grupuar i tregut për çdo energji të injektuar dhe të tërhequr për zonë ofertimi për çdo njësi kohore tregu; dhe |
| *bëhet* | | ***Nuk ndryshon*** |
| *është* | **H.4.3.4** | ALPEX-i do të përgatisë dhe botojë në faqen e tij të internetit raporte mujore me të paktën shifrat e mësipërme të grupuara në bazë mujore. |
| *Bëhet* | | ***Nuk ndryshon*** |
| *është* | **K.2.3.2** | Për një periudhë 2-vjeçare nga hyrja në fuqi e këtyre rregullave, asnjë prej anëtarëve të Bursës nuk do të pranohen të regjistrohen si anëtar personal klerimi. |
| *bëhet* | | Deri më datën 30 qershor 2026, asnjë prej anëtarëve të Bursës nuk do të pranohen të regjistrohen si anëtar personal klerimi. |
| *arsyeja* | ***Shtohet*** | |

| **RREGULLAT E TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE – PROCEDURA E TREGTIMIT** | | |
|---|---|---|
| **Seksionet, paragrafët, nënparagrafët** | | **Përshkrimi** |
| *është* | **A.2.2.1** | Njësia kohore e tregut (MTU) është periudha kohore në të cilën urdhërporositë përputhen në një segment të caktuar tregu. Njësia kohore e tregut ndryshon për secilin segment tregu, siç përcaktohet në paragrafin A.2.4.5.6, dhe shtojcën A. |
| *bëhet* | | Njësia kohore e tregut (MTU) është periudha kohore në të cilën urdhërporositë përputhen në një segment të caktuar tregu. Njësia kohore e tregut për secilin segment tregu, përcaktohet në paragrafin A.2.4.6, dhe shtojcën A. |
| *është* | **A.2.4.1** | Ndërkohë që libri i urdhërporosive është i hapur, një anëtar i Bursës mund të dorëzojë, ndryshojë dhe anulojë urdhërporositë e tij. |
| *bëhet* | | Ndërkohë që libri i urdhërporosive është i hapur, një anëtar i Bursës mund të dorëzojë, ndryshojë dhe anulojë urdhërporositë e tij në përputhje me parashikimet e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike-Kushtet e përgjithshme dhe kësaj procedure. |
| *është* | | |
| *bëhet* | **A.2.4.1 (a)** | Librat e urdhërporosive për çdo treg të ALPEX-it që i përkasin një zone të caktuar ofertimi bëhen teknikisht të disponueshme për çdo anëtar burse, edhe nëse ai nuk është i regjistruar në ndonjërin prej këtyre tregjeve. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | | |
| *Bëhet* | **A.2.4.1 (b)** | Pavarësisht parashikimit të paragrafit (a), anëtarit të Bursës i ndalohet të dorëzojë urdhërporosi në tregun në të cilin nuk është i regjistruar, edhe pse libri i urdhërporosive i këtij tregu, kur është i hapur, është teknikisht i disponueshëm për këtë anëtar. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | | |

| | | |
|---|---|---|
| *bëhet* | **A.2.4.1 (c) A.2.4.1 (c)(i)** | c.Për të shmangur ndonjë dyshim:<br>i.Gjatë ankandit të dytë, kur libri i urdhërporosive për tregun e ditës në avancë është i hapur, anëtarit të Bursës i lejohet të dorëzojë, të ndryshojë dhe të anulojë urdhërporositë e tij në përputhje me parashikimet e paragrafit B.2.3.3 të kësaj procedure. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | **A.2.4.4** | Çdo urdhërporosi e thjeshtë mund të përfshijë deri në (50) segmente për çdo njësi kohore tregu. |
| *bëhet* | | Çdo urdhërporosi e thjeshtë mund të përfshijë deri në (50) çifte çmim-sasi për çdo njësi kohore tregu. |
| *është* | **A.2.4.5** | Në rastin e ankandit të ditës në avancë ose ankandit brenda së njëjtës ditë, jo subjekt i seksionit F.3 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike dhe këtyre procedurave: |
| *bëhet* | | Në rastin e ankandit të ditës në avancë ose ankandit brenda së njëjtës ditë, nëse nuk është në kushtet e parashikimeve të seksionit F.3 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike-Kushtet e përgjithshme dhe këtyre procedurave: |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | **A.2.4.6** | Nëse nuk është subjekt i seksionit F.3 të rregullave të ALPEX-it, oraret (CET) e hapjes dhe mbylljes së librit të urdhërporosive të ankandeve të ditës në avancë dhe atyre brenda së njëjtës ditë, dhe njësinë kohore të tregut që mbulon secilin ankand, dhe natyra e planeve të Bashkimit të Tregut për Segmentin përkatës të tregut, janë si vijon: |

| | | |
|---|---|---|
| *bëhet* | | Nëse nuk është në kushtet e parashikimeve të seksionit F.3 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike-Kushtet e përgjithshme, kohët (CET) e hapjes dhe mbylljes së librit të urdhërporosive të ankandeve të ditës në avancë dhe atyre brenda së njëjtës ditë, që mbulojnë periudhën e tregtimit, dhe sipas natyrës së marrëveshjeve të Bashkimit të Tregut për segmentin përkatës të tregut, janë si vijon: |
| *është* | **A.2.4.7** | Në rastin e tregtimit të vazhdueshëm brenda së njëjtës ditë, jo subjekt i seksionit F.3 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike dhe këtyre procedurave. |
| *bëhet* | | Në rastin e tregtimit të vazhdueshëm brenda së njëjtës ditë, nëse nuk është në kushtet e parashikimeve të seksionit F.3 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike-Kushtet e përgjithshme dhe këtyre procedurave. |
| *është* | **A.2.7.2** | Pas përfundimit të kohës së mbylljes së portës së ankandit, të gjitha urdhërporositë blerjeje dhe shitjeje të pranuara, mblidhen nga libri i urdhërporosisë dhe më pas algoritmi llogarit balancimin e energjisë elektrike të tregtuar, sasitë e pranuara të urdhërporosive blerjeje dhe shitjeje, si dhe llogariten çmimin e balancuar të energjisë elektrike të tregtuar në çdo ankand. |
| *bëhet* | | Pas përfundimit të kohës së mbylljes së portës së ankandit, të gjitha urdhërporositë blerjeje dhe shitjeje të pranuara, mblidhen nga libri i urdhërporosisë dhe më pas algoritmi llogarit balancimin e energjisë elektrike të tregtuar, sasitë e pranuara të urdhërporosive blerjeje dhe shitjeje, si dhe llogarit çmimin klerues të energjisë elektrike të tregtuar në çdo ankand. |
| *është* | **A.3.1.2** | Një kufi tregtimi i kombinuar për ankandet e tregut të ditës në avancë dhe atij brenda së njëjtës ditë do të shprehet në euro. |
| *bëhet* | | Një kufi tregtimi i përbashkët për ankandet e tregut të ditës në avancë dhe atij brenda së njëjtës ditë dhe tregut të vazhdueshëm brenda së njëjtës ditë do të shprehet në euro. |
| *është* | **A.3.1.3** | Një kufi tregtimi për tregun e vazhdueshëm brenda së njëjtës ditë do të shprehet në euro. |
| *bëhet* | | |
| | ***Shfuqizohet*** | |
| *është* | **A.4.1.4** | ETSS-ja do të refuzojë urdhërporositë që nuk janë në përputhje me kërkesat e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike. |
| *bëhet* | | |
| | ***Shfuqizohet*** | |
| *është* | **A.4.1.6** | Anëtarët e bursës do t'i dorëzojnë urdhërporositë e tyre dhe mund t'i anulojnë ose ndryshojnë këto urdhërporosi nga koha e hapjes së portës dhe deri në kohën e mbylljes së portës për tregjet e DAM-it, LIDA-t, CRIDA-t dhe tregtimit të vazhdueshëm brenda së njëjtës ditë. |
| *Bëhet* | **A.4.1.5** | Anëtarët e Bursës do t'i dorëzojnë Urdhërporositë e tyre dhe mund t'i anulojnë ose ndryshojnë këto urdhërporosi nga koha e hapjes së portës dhe deri në kohën e mbylljes së portës për tregjet e DAM-it, CRIDA-t dhe Tregtimit të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë. |

| | | |
|---|---|---|
| *është* | **A.4.3.1** | ETSS-ja nuk do të lejojë një urdhërporosi të dorëzuar nga një anëtar i Bursës, bazuar në kohën e marrjes nga ALPEX-i, kur është marrë përpara kohës së hapjes së portës për tregjet e DAM-it, LIDA-t, CRIDA-t dhe tregtimit të vazhdueshëm brenda së njëjtës ditë ose pas kohës së mbylljes së portës për tregjet e DAM-it, LIDA-t, CRIDA-t dhe tregtimit të vazhdueshëm brenda së njëjtës ditë. |

| | | |
|---|---|---|
| *bëhet* | | ETSS-ja nuk do të lejojë një urdhërporosi të dorëzuar nga një anëtar i Bursës, bazuar në kohën e marrjes nga ALPEX-i, kur është marrë përpara kohës së hapjes së portës për tregjet e DAM-it, CRIDA-t dhe tregtimit të vazhdueshëm brenda së njëjtës ditë ose pas kohës së mbylljes së portës për tregjet e DAM-it, CRIDA-t dhe tregtimit të vazhdueshëm brenda së njëjtës ditë. |
| *është* | **A.4.3.2** | ETSS-ja do të refuzojë automatikisht një urdhërporosi të dorëzuar nga një anëtar i Bursës bazuar në çmimin e urdhërporosisë, kur çmimi i urdhërporosisë është jashtë diapazonit të përcaktuar si çmimi minimal dhe çmimi maksimal për tregjet DAM-it, LIDA-t, CRIDA-t dhe tregtimit të vazhdueshëm brenda së njëjtës ditë. Në rast të refuzimit automatik të një urdhërporosie, ETSS-ja duhet t'i dërgojë automatikisht anëtarit përkatës të Bursës një njoftim refuzimi, duke përfshirë edhe arsyen për këtë refuzim. |
| *bëhet* | | ETSS-ja do të refuzojë automatikisht një urdhërporosi të dorëzuar nga një anëtar i Bursës bazuar në çmimin e urdhërporosisë, kur çmimi i urdhërporosisë është jashtë diapazonit të përcaktuar si çmimi minimal i urdhërporosisë dhe çmimi maksimal i urdhërporosisë për tregjet DAM-it, CRIDA-t dhe tregtimit të vazhdueshëm brenda së njëjtës ditë. Në rast të refuzimit automatik të një urdhërporosie, ETSS-ja mund t'i dërgojë automatikisht anëtarit përkatës të Bursës një njoftim refuzimi, duke përfshirë edhe arsyen për këtë refuzim. |
| *është* | | |
| | | |
| *bëhet* | **A.4.4**<br>**A.4.4.1**<br>**A.4.4.1 (a)**<br>**A.4.4.1 (b)** | A.4.4 Qartësim<br>A.4.4.1 Për të shmangur çdo dyshim rreth parashikimeve të seksionit A.4:<br>(a)Përgjegjësia për të siguruar përputhshmërinë me parashikimet e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e përgjithshme, paragrafi E.2.3.6, është e anëtarit të Bursës dhe nuk është përgjegjësi e ETSS që nënkupton ALPEX-in.<br>(b)Gjatë ankandit të dytë të tregut të ditës në avancë, përgjegjësia për të siguruar përputhshmërinë me parashikimet e kësaj procedure, paragrafi B.2.3.3, është e anëtarit të Bursës dhe nuk është përgjegjësi e ETSS që nënkupton ALPEX-in. |
| *është* | **B.1.2.1** | Tregu i ditës në avancë funksionon në përputhje me kohën e përcaktuar në vendimet teknike të ALPEX-it. |
| *bëhet* | | Në tregun e ditës në avancë, anëtari i Bursës mund të tregtojë çdo ditë kalendarike për ditën përkatëse të livrimi nga koha e hapjes deri në kohën e mbylljes së portës siç përcaktohet në tabelën e paragrafit A.2.4.6. |
| *është* | **B.1.2.2** | ALPEX-i mund të zgjasë kohën e mbylljes së portës së tregut të ditës në avancë për të mbajtur kushte të rregullta tregtimi. Koha e mbylljes së portës së tregut të ditës në avancë mund të zgjatet për arsye që lidhen me disponueshmërinë e ETSS-ës, librin e urdhërporosisë lokale, si dhe për arsye që lidhen me ndarjen e plotë të tregjeve. |
| *bëhet* | | ALPEX-i mund të zgjasë kohën e mbylljes së portës së tregut të ditës në avancë për të mbajtur kushte të rregullta tregtimi. Koha e mbylljes së portës së tregut të ditës në avancë mund të zgjatet për arsye që lidhen me disponueshmërinë e ETSS-ës, librin e urdhërporosisë lokale, si dhe për arsye që lidhen me ndarjen e plotë të tregjeve, si dhe parashikimeve të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | **B.1.2.3** | ALPEX-i do të informojë anëtarët e Bursës për arsyet e zgjatjes, si dhe veprimet që kanë lidhje me të, që kërkohen të merren prej tij dhe prej anëtarëve të Bursës. |
| *bëhet* | | ALPEX-i do të informojë anëtarët e Bursës për arsyet e zgjatjes së kohës së mbylljes së portë, si dhe veprimet që kanë lidhje me të, që kërkohen të merren prej tij dhe prej anëtarëve të Bursës. |

| | | |
|---|---|---|
| *është* | **B.1.5.3** | Çmimi i pikës së parë të segmentit të parë të kurbës së urdhërporosi shitjeje është i barabartë me çmimin minimal të tregut të ditës në avancë për urdhërporositë, ndërsa çmimi i pikës së dytë të segmentit të fundit të kurbës së urdhërporosi shitjeje është i barabartë me çmimin maksimal të tregut të ditës në avancë për urdhërporositë. |

| | | |
|---|---|---|
| *bëhet* | | Çmimi i pikës së parë të segmentit të parë të kurbës së urdhërporosi shitjeje është i barabartë me çmimin minimal të urdhërporosisë së tregut të ditës në avancë, ndërsa çmimi i pikës së dytë të segmentit të fundit të kurbës së urdhërporosi shitjeje është i barabartë me çmimin maksimal të urdhërporosisë së tregut të ditës në avancë. |
| *është* | **B.1.5.4** | Çmimi i pikës së parë të segmentit të parë të kurbës së urdhërporosi blerjeje është i barabartë me çmimin minimal të tregut të ditës në avancë për urdhërporositë, ndërsa çmimi i pikës së dytë të segmentit të fundit të kurbës së urdhërporosi blerjeje është i barabartë me çmimin maksimal të tregut të ditës në avancë për urdhërporositë. |
| *bëhet* | | Çmimi i pikës së parë të segmentit të parë të kurbës së urdhërporosi blerjeje është i barabartë me çmimin maksimal të urdhërporosisë së tregut të ditës në avancë, ndërsa çmimi i pikës së dytë të segmentit të fundit të kurbës së urdhërporosi blerjeje është i barabartë me çmimin minimal të urdhërporosisë të Tregut të Ditës në Avancë. |
| *është* | | |
| *bëhet* | **B.1.5.6** | Çdo urdhërporosi e thjeshtë duhet të specifikojë një çift ÇS me një çmim sa çmimi minimal i urdhërporosisë së Tregut të Ditës në Avancë dhe një çift ÇS me një çmim sa çmimi maksimal i urdhërporosisë së Tregut të Ditës në Avancë. Urdhërporosia nuk duhet të përmbajë çifte ÇS me çmime më të ulëta se çmimi minimal i urdhërporosisë ose më të larta se çmimi maksimal i urdhërporosisë të Tregut të Ditës në Avancë. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | **B.1.5.6** | Çiftet ÇS në urdhërporosinë e thjeshtë paraqiten nga një funksion i thyer-me hapa *(step-wise)* i çmimit dhe sasisë se energjisë elektrike për blerje dhe/ose shitje në njësinë kohore të tregut përkatës, ose me rritjen graduale të sasisë se energjisë elektrike ose me zbritjen graduale të sasisë së energjisë elektrike për çdo hap çmimi sipas paragrafit B.1.5.7. |
| *Bëhet* | **B.1.5.7** | Çiftet ÇS në urdhërporosinë e thjeshtë paraqiten nga një funksion i thyer-me hapa (step-wise) i çmimit dhe sasisë se energjisë elektrike për blerje dhe/ose shitje në njësinë kohore të tregut përkatës, ose me rritjen graduale të sasisë se energjisë elektrike ose me zbritjen graduale të sasisë së energjisë elektrike për çdo hap çmimi sipas paragrafit B.1.5.8. |
| *është* | **B.1.5.7** | |
| *Bëhet* | **B.1.5.8** | |
| *është* | **B.1.6.1** | Urdhërporosi shitjeje marrëse e çmimit me përparësi janë urdhërporosi të thjeshta që u vendoset çmimi sa çmimi minimal i pranuar në Tregun e Ditës në Avancë, që i korrespondon çmimit minimal në tregun e ditës në avancë. |
| *bëhet* | | Urdhërporosi shitjeje marrëse e çmimit me përparësi janë urdhërporosi të thjeshta që iu vendoset një çmim, që i korrespondon çmimit minimal i urdhërporosisë në Tregun e Ditës në Avancë. |
| *është* | **B.1.6.2** | Urdhërporosi blerjeje marrëse e çmimit me përparësi janë urdhërporosi të thjeshta që u vendoset çmimi sa çmimi maksimal i pranuar në Tregun e Ditës në Avancë, që i korrespondon çmimit maksimal në tregun e ditës në avancë. |
| *bëhet* | | Urdhërporosi blerjeje marrëse e çmimit me përparësi janë urdhërporosi të thjeshta që iu vendoset një çmim, që i korrespondon çmimit maksimal i urdhërporosisë në Tregun e Ditës në Avancë. |

| | | |
|---|---|---|
| *është* | **B.1.6.3** | Në rast se çmimi klerues i tregut në një zonë ofertimi për një njësi kohore tregu të caktuar të ditës së livrimit D është i barabartë me kufirin minimal të lejuar të çmimit për tregun e ditës në avancë dhe në të njëjtën kohë asnjë urdhërporosi e thjeshtë nuk është pranuar nga zgjidhja e algoritmit për një çmim të barabartë me kufirin minimal të lejuar të çmimit për tregun e ditës në avancë dhe përjashtuar rastet e përparësisë, atëherë do të aplikohet procesi i kufizimit të urdhërporosisë shitjeje marrëse e çmimit me përparësi. |
| *bëhet* | | Në rast se çmimi klerues i tregut në një zonë ofertimi për një njësi kohore tregu të caktuar të ditës së livrimit D është i barabartë me çmimin minimal të urdhërporosisë për tregun e ditës në avancë dhe në të njëjtën kohë asnjë urdhërporosi e thjeshtë shitjeje nuk është pranuar nga zgjidhja e algoritmit për një çmim të barabartë me çmimin minimal të urdhërporosisë për tregun e ditës në avancë dhe përjashtuar rastet e urdhërporosive marrëse e çmimit me përparësi, atëherë do të aplikohet procesi i kufizimit të urdhërporosisë shitjeje marrëse e çmimit me përparësi. |
| *është* | **B.1.6.4** | Në rast se çmimi klerues i tregut në një zonë ofertimi për një njësi kohore tregu të caktuar të ditës së livrimit D është i barabartë me kufirin maksimal të lejuar të çmimit për tregun e ditës në avancë dhe në të njëjtën kohë asnjë urdhërporosi e thjeshtë nuk është pranuar nga zgjidhja e algoritmit për një çmim të barabartë me kufirin maksimal të lejuar të çmimit për tregun e ditës në avancë dhe përjashtuar rastet e përparësisë, atëherë do të aplikohet procesi i kufizimit të urdhërporosisë blerjeje marrëse e çmimit me përparësi. |

| | | |
|---|---|---|
| *bëhet* | | Në rast se çmimi klerues i tregut në një zonë ofertimi për një njësi kohore tregu të caktuar të ditës së livrimit D është i barabartë me çmimin maksimal të urdhërporosisë për tregun e ditës në avancë dhe në të njëjtën kohë asnjë urdhërporosi e thjeshtë blerje nuk është pranuar nga zgjidhja e algoritmit për një çmim të barabartë me çmimin maksimal të urdhërporosisë për tregun e ditës në avancë dhe përjashtuar rastet e urdhërporosive marrëse e çmimit me përparësi, atëherë do të aplikohet procesi i kufizimit të urdhërporosisë blerjeje marrëse e çmimit me përparësi. |
| *është* | **B.1.6.5** | Procedura për kufizimin e urdhërporosive blerjeje dhe/ose shitjeje në rastet e paragrafëve B.1.6.3 dhe B.1.6.4 kryhet sipas një metodologjie të përcaktuar me vendim të Autoritetit Rregullator me rekomandim të ALPEX-it. |
| *bëhet* | | Procedura për kufizimin e urdhërporosive blerjeje dhe/ose shitjeje në rastet e paragrafëve B.1.6.3 dhe B.1.6.4 kryhet sipas një vendimi të Autoritetit Rregullator me rekomandim të ALPEX-it. |
| *është* | **B.1.6.6** | Autoriteti Rregullator, nëpërmjet një vendimi, do të përcaktojë detyrimin për anëtarët përkatës të Bursës që do të dorëzojnë urdhërporosi si marrëse të çmimit me përparësi. |
| *Bëhet* | | Me propozim të ALPEX-it, Autoriteti Rregullator, nëpërmjet një vendimi, do të miratojë anëtarët përkatës të Bursës që do të dorëzojnë urdhërporosi marrëse të çmimit me përparësi. |
| *është* | | |
| *bëhet* | **B.1.10.1** | Pas kohës së mbylljes së portës për Tregun e Ditës në Avancë, ALPEX-i proceson dhe bën anonime urdhërporositë në librin lokal të urdhërporosive përpara se t'i dorëzojë ato te libri i përbashkët i urdhërporosive të operatorit të bashkimit të tregjeve. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | **B.1.10.2** | Objektivi i mekanizmit të Bashkimit të Tregjeve të Ditës në Avancë është maksimizimi i mirëqenies sociale i zonave të ofertimit të bashkuara, përkatësisht maksimizimi i shumës totale së tepricave të urdhërporosive shitjeje dhe blerjeje të përfshira në librin e urdhërporosive të grupuara plus të ardhurat nga kongjestioni. |

| | | |
|---|---|---|
| *bëhet* | **B.1.10.3** | Objektivi i mekanizmit të Bashkimit të Tregjeve të Ditës në Avancë është maksimizimi i përfitimeve social-ekonomike (*Social Welfare*) i zonave të ofertimit të bashkuara, përkatësisht maksimizimi i shumës totale së tepricave të urdhërporosive shitjeje dhe blerjeje të përfshira në librin e urdhërporosive të grupuara plus të ardhurat nga kongjestioni. |
| *është* | **B.1.10.3** | Teprica e urdhërporosive shitjeje të pranuara është e barabartë me prodhimin (shumëzimin) e diferencës së çmimit klerues margjinal minus çmimin e urdhërporosisë së tyre me sasinë e energjisë elektrike të pranuar. Teprica e urdhërporosive blerjeje të pranuara është e barabartë me prodhimin (shumëzimin) e diferencës së çmimit të urdhërporosisë minus çmimin klerues margjinal me sasinë e energjisë elektrike të pranuar. |
| *bëhet* | **B.1.10.4** | Teprica e urdhërporosive shitjeje të pranuara është e barabartë me diferencën e çmimit klerues me çmimin e urdhërporosisë, shumëzuar me sasinë e energjisë elektrike të pranuar. teprica e urdhërporosive blerjeje të pranuara është e barabartë me diferencën e çmimit të urdhërporosisë me çmimin klerues, shumëzuar me sasinë e energjisë elektrike të pranuar. |
| *është* | | |
| *bëhet* | **B.2.1.2** | Rregullat e pranimit të urdhërporosive referuar paragrafëve B.2.1.3 deri B.2.1.12, nga algoritmi për bashkimin e çmimit në tregun e ditës në avancë përfshijnë situatat si gjatë operimit të tregjeve të bashkuara dhe jo të bashkuara, dhe operimit në ndarjen e plotë të tregjeve. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | **B.2.1.2** | Rregullat e pranimit të një urdhërporosi blerjeje e thjeshtë të dorëzuar në një zonë ofertimi janë si më poshtë: |
| *bëhet* | **B.2.1.3** | Rregullat e pranimit të një urdhërporosie shitjeje e thjeshtë të paraqitur në një zonë ofertimi janë si më poshtë: |
| *është* | **B.2.1.2 (a)** | Një segment i urdhërporosi shitjeje do të pranohet plotësisht nëse çmimi i tij është më i ulët se çmimi klerues i tregut të zonës së ofertimit për njësi kohore e tregut përkatës të ditës së livrimit D. |
| *bëhet* | **B.2.1.3 (a)** | Një segment i urdhërporosie shitjeje do të pranohet plotësisht nëse çmimi i tij është më i ulët se çmimi klerues i tregut të zonës së ofertimit për njësi kohore e tregut përkatës të ditës së livrimit D. |
| *është* | **B.2.1.2 (b)** | Një segment i urdhërporosi shitjeje do të pranohet pjesërisht nëse çmimi i tij është i barabartë me çmimin klerues të tregut të zonës së ofertimit për njësi kohore e tregut përkatës të ditës së livrimit D. |

| | | |
|---|---|---|
| *Bëhet* | **B.2.1.3 (b)** | Një segment i urdhërporosie shitjeje do të pranohet pjesërisht nëse çmimi i tij është i barabartë me çmimin klerues të tregut të zonës së ofertimit për njësi kohore e tregut përkatës të ditës së livrimit D. |
| *është* | **B.2.1.2 (c)** | Një segment i urdhërporosi shitjeje nuk do të pranohet nëse çmimi i tij është më i lartë se çmimi klerues i tregut të zonës së ofertimit për njësi kohore e tregut përkatës të ditës së livrimit D. |
| *bëhet* | **B.2.1.3 (c)** | Një segment i urdhërporosie shitjeje nuk do të pranohet nëse çmimi i tij është më i lartë se çmimi klerues i tregut të zonës së ofertimit për njësi kohore e tregut përkatës të ditës së livrimit D. |
| *është* | **B.2.1.3 (a)** | Një segment i urdhërporosi blerjeje do të pranohet plotësisht nëse çmimi i tij është më i lartë se çmimi klerues i tregut të zonës së ofertimit për njësi kohore e tregut përkatës të ditës së livrimit D. |
| *bëhet* | **B.2.1.4 (a)** | Një segment i urdhërporosie blerjeje do të pranohet plotësisht nëse çmimi i tij është më i lartë se çmimi klerues i tregut të zonës së ofertimit për njësi kohore e tregut përkatës të ditës së livrimit D. |

| | | |
|---|---|---|
| *është* | **B.2.1.3 (b)** | Një segment i urdhërporosi blerjeje do të pranohet pjesërisht nëse çmimi i tij është i barabartë me çmimin klerues të tregut të zonës së ofertimit për njësi kohore e tregut përkatës të ditës së livrimit D. |
| *bëhet* | **B.2.1.4 (b)** | Një segment i urdhërporosie blerjeje do të pranohet pjesërisht nëse çmimi i tij është i barabartë me çmimin klerues të tregut të zonës së ofertimit për njësi kohore e tregut përkatës të ditës së livrimit D. |
| *është* | **B.2.1.3 (c)** | Një segment i urdhërporosi blerjeje nuk do të pranohet nëse çmimi i tij është më i ulët se çmimi klerues i tregut të zonës së ofertimit për njësi kohore e tregut përkatës të ditës së livrimit D. |
| *bëhet* | **B.2.1.4 (c)** | Një segment i urdhërporosie blerjeje nuk do të pranohet nëse çmimi i tij është më i ulët se çmimi klerues i tregut të zonës së ofertimit për njësi kohore e tregut përkatës të ditës së livrimit D. |
| *është* | **B.2.1.6 (d)** | Një urdhërporosi në Bllokun Vartës, e cila nuk është e pranueshme sipas rregullave të pranimit të urdhërporosive në Bllok të përshkruar më sipër (përtej vlerës monetare "out-of-the-money"), mund të pranohet nëse urdhërporositë e lidhura në Bllokun Udhëheqës të pranuara prodhojnë tepricë të mjaftueshme për të kompensuar humbjet e urdhërporosive në Bllok Vartëse. Në rastin kur urdhërporosia në Bllok Vartës është një urdhërporosi e lidhur në Bllok Udhëheqës për një tjetër urdhërporosi në Bllok, zbatohet rregulli i vlefshmërisë i përshkruar në rregullin e pranimit në paragrafin B.2.1.6 (c). |
| *bëhet* | **B.2.1.7 (d)** | Një urdhërporosi në Bllokun Vartës, e cila nuk është e pranueshme sipas rregullave të pranimit të urdhërporosive në Bllok të përshkruar më sipër (përtej vlerës monetare *"out-of-the-money"*), mund të pranohet nëse urdhërporositë e lidhura në Bllokun Udhëheqës të pranuara prodhojnë tepricë të mjaftueshme për të kompensuar humbjet e urdhërporosive në Bllok Vartëse. Në rastin kur urdhërporosia në Bllok Vartës është një urdhërporosi e lidhur në Bllok Udhëheqës për një tjetër urdhërporosi në Bllok, zbatohet rregulli i vlefshmërisë i përshkruar në rregullin e pranimit në paragrafin B.2.1.7 (c). |
| *është* | **B.2.1.7** | Rregulli i pranimit të urdhërporosive në Bllok që i përket Grupit Ekskluziv të Urdhërporosive në Bllok janë të njëjtat si rregullat e pranimit të urdhërporosive në Bllok të përshkruara në paragrafin B.2.1.3 dhe B.2.1.4 dhe me kufizime shtesë që totali i normës së pranimit të urdhërporosive në Bllok që i përkasin të njëjtit Grup Ekskluziv Urdhërporosi në Bllok nuk mund të kaloj shifrën 1 (një). Përzgjedhja e urdhërporosisë në Bllok nga Grupi Ekskluziv bëhet nga zgjidhja e algoritmit për të maksimizuar tepricën e përfitueshmërisë (*welfare surplus*). |
| *bëhet* | **B.2.1.8** | Rregulli i pranimit të urdhërporosive në Bllok që i përket Grupit Ekskluziv të Urdhërporosive në Bllok janë të njëjtat si rregullat e pranimit të urdhërporosive në Bllok të përshkruara në paragrafin B.2.1.4 dhe B.2.1.5 dhe me kufizime shtesë që totali i normës së pranimit të urdhërporosive në Bllok që i përkasin të njëjtit Grup Ekskluziv Urdhërporosi në Bllok nuk mund të kaloj shifrën 1 (një). Përzgjedhja e urdhërporosisë në Bllok nga Grupi Ekskluziv bëhet nga zgjidhja e algoritmit për të maksimizuar tepricën e përfitueshmërisë (*welfare surplus*). |
| *është* | **B.2.1.9** | Në rastin kur për një njësi kohore tregu më shumë se një segment i një urdhërporosive shitjeje e thjeshtë ka çmim të barabartë me çmimin klerues të tregut, për pranimin e urdhërporosive aplikohet një metodologji e përcaktuar me vendim nga Autoriteti Rregullator përkatës me propozimin e ALPEX-it. |
| *bëhet* | **B.2.1.10** | Në rastin kur për një njësi kohore tregu më shumë se një segment i një urdhërporosi shitjeje e thjeshtë ka çmim të barabartë me çmimin klerues të tregut, për pranimin e urdhërporosive aplikohet sipas vendimit nga Autoriteti Rregullator përkatës me propozimin e ALPEX-it. |

| | | |
|---|---|---|
| *është* | **B.2.1.10** | Në rastin kur për një njësi kohore tregu më shumë se një segment i një urdhërporosi blerjeje e thjeshtë ka çmim të barabartë me çmimin klerues të tregut, për pranimin e urdhërporosive aplikohet një metodologji e përcaktuar me vendim nga Autoriteti Rregullator përkatës me propozimin e ALPEX-it. |
| *bëhet* | **B.2.1.11** | Në rastin kur për një njësi kohore tregu më shumë se një segment i një urdhërporosi blerjeje e thjeshtë ka çmim të barabartë me çmimin klerues të tregut, për pranimin e urdhërporosive aplikohet sipas vendimit nga Autoriteti Rregullator përkatës me propozimin e ALPEX-it. |
| *është* | **B.2.2.1** | Algoritmi përcakton çmimin e ankandit, sasitë e përputhura të grupuara dhe pozicionet neto për çdo zonë ofertimi në bashkimin e tregjeve. |
| *bëhet* | | Algoritmi përcakton çmimin e ankandit, sasitë e përputhura të grupuara dhe pozicionet neto për çdo njësi kohore tregu dhe zonë ofertimi në Bashkimin e Tregjeve. |
| *është* | **B.2.2.2** | Në përcaktimin e rezultateve të përshkruara në paragrafin B.2.2.1 duhet të përmbushen parimet e mëposhtme për një rajon të Bashkimin e Tregjeve: |
| *bëhet* | | Në përcaktimin e rezultateve të përshkruara në paragrafin B.2.2.1 duhet të përmbushen parimet e mëposhtme për Bashkimin e Tregjeve në nivel rajonal ose evropian: |
| *është* | **B.2.2.2 (a)** | Çmimi i Bashkimit të Tregjeve në anën e importit të një interkonektori do të jetë më i lartë ose i barabartë më çmimin e Bashkimit të Tregjeve në anën e eksportit të interkonektorit; dhe |
| *bëhet* | | Çmimi klerues i Bashkimit të Tregjeve në anën e zonës së ofertimit të importit të një interkonektori do të jetë më i lartë ose i barabartë më çmimin klerues të Bashkimit të Tregjeve në anën e zonës së ofertimit të eksportit të interkonektorit; dhe |
| *është* | **B.2.2.2 (b)** | kur eksporti ose importi është më i vogël se kapaciteti ndërkufitar i caktuar nga ose në emër të OST-ve përkatëse, çmimi i Bashkimit të Tregjeve në anën e importit të një interkonektori do të jetë i barabartë më çmimin e Bashkimit të Tregjeve në anën e eksportit të interkonektorit pa humbjet. |
| *bëhet* | | kur sasia e energjisë për eksport ose import është më e vogël se kapaciteti ndërkufitar i dorëzuar nga ose në emër të OST-ve përkatëse, çmimi klerues i Bashkimit të Tregjeve në anën e zonës së ofertimit të importit të një interkonektori do të jetë i barabartë më çmimin e Bashkimit të Tregjeve në anën e zonës ofertimit të eksportit të interkonektorit, pa humbjet. |
| *është* | | |
| *bëhet* | **B.2.2.2 (c)** | Në rast se sasia e energjisë për eksport ose import do të ishte më e madhe se sa kapaciteti ndërkufitar i vlefshëm i dorëzuar nga ose në emër të OST-ve përkatëse, çmimi klerues i Bashkimit të Tregjeve në anën e zonës së ofertimit të eksportit të interkonektorit do të jetë më i ulët se çmimi klerues në Bashkimin e Tregjeve në anën e zonës së ofertimit të importit të interkonektorit, pa humbjet. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | | |
| *bëhet* | **B.2.2.2 (d)** | Në rastin e B.2.2.2 (c), gjenerohen të ardhura nga kongjestioni. Këto të ardhura do të mblidhen nga agjenti i transferimit dhe do të shpërndahen tek OST-të nga shpërndarësi i kongjestioneve. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | **B.2.2.3 (c)** | më pas, në rast se këtyre rregullave të rrumbullakosjes ka në një diferencë midis sasive të blera dhe sasive të shitura, sasitë e mbetura rishpërndahen tek ata anëtarë të Bursës, sasitë e shitjes ose blerjes së të cilëve janë rrumbullakosur kështu, me alokime të njëpasnjëshme prej 0,01 MW. |

| | | |
|---|---|---|
| *bëhet* | | më pas, në rast se gjatë aplikimit të këtyre rregullave të rrumbullakosjes ka në një diferencë midis sasive të blera dhe sasive të shitura, sasitë e mbetura rishpërndahen tek ata anëtarë të Bursës, sasitë e shitjes ose blerjes së të cilëve janë rrumbullakosur kështu, me alokime të njëpasnjëshme prej 0,01 MW. |
| *është* | **B.2.3.1** | Procedura për një ankand të dytë mundësohet nga ALPEX-i në rastet kur çmimi klerues i tregut që vjen si pasojë e zgjidhjes nëpërmjet algoritmit të Bashkimit të Tregjeve të Ditës në Avancë, është e barabartë me ose kalon kufirin minimal dhe maksimal të lejuar të çmimit për tregun e ditës në avancë të përcaktuar për ankandin e dytë për një ose më shumë njësi kohore tregu për një ose më shumë zona ofertimi. |
| *bëhet* | | ALPEX-i verifikon çmimet kleruese nga rezultatet paraprake të Bashkimit të Tregjeve të cilat vijnë si pasojë e zgjidhjes nëpërmjet algoritmit të Bashkimit të Tregjeve të Ditës në Avancë. Në rastin kur ky çmim klerues i tregut është e barabartë ose kalon kufirin minimal dhe maksimal të lejuar të çmimit për tregun e ditës në avancë të përcaktuar për ankandin e dytë, për një ose më shumë njësi kohore tregu, për një ose më shumë zona ofertimi, ALPEX-i do të anulojë ankandin përkatës dhe do të zhvillojë një ankand të dytë. |
| *është* | **B.2.3.3** | Rihapja e librit të urdhërporosive lokale i jep mundësi anëtarëve të Bursës të kenë mundësi të ndryshojnë ofertat e tyre për të përmirësuar rezultatin e zgjidhjes së algoritmit të Bashkimit të Tregjeve të Ditës në Avancë duke ndërmarrë veprimet e mëposhtme: |

| | | |
|---|---|---|
| *bëhet* | | Rihapja e librit të urdhërporosive lokale i jep të drejtën të veprojnë në ankandin e dytë vetëm atyre anëtarëve të Bursës, të cilët kishin dorëzuar urdhërporosi te njësia kohore e tregut e prekur sipas paragrafit B.2.3.1. Këta anëtarë kanë mundësi të ndryshojnë ofertat e tyre për të përmirësuar rezultatin e zgjidhjes së algoritmit të përputhjes së Tregut të Ditës në Avancë duke ndërmarrë veprimet e mëposhtme: |
| *është* | **B.2.3.3 (a) (ii)** | Ankandi mund të rezultojë në një çmim ankandi që është i barabartë ose më i ulët se kufiri minimal i lejuar i çmimit: anëtarët e Bursës mund t'i ndryshojnë urdhërporositë në mënyrë që të shtojnë volumin e shitjeve, të pakësojnë volumin e blerjeve ose të rrisin çmimet; ose |
| *bëhet* | | Ankandi mund të rezultojë në një çmim ankandi që është i barabartë ose më i ulët se kufiri minimal i lejuar i çmimit: anëtarët e Bursës mund t'i ndryshojnë urdhërporositë në mënyrë që të shtojnë volumin e blerjeve, të pakësojnë volumin e shitjeve ose të rrisin çmimet; |
| *është* | **B.2.3.3 (b)** | për njësi kohore të tregut: një anëtar i Bursës mund t'i ndryshojë urdhërporositë vetëm nëse në të njëjtën kohë ndryshon urdhërporositë për njësitë kohore të tregut të përmendura në paragrafin (a) |
| *bëhet* | | për njësitë e tjera kohore të tregut: këta anëtarë burse mund t'i ndryshojnë urdhërporositë vetëm nëse njëkohësisht ndryshojnë urdhërporositë për njësitë kohore të tregut të përmendura në paragrafin (a) dhe në përputhje me parashikimet e mëposhtme:<br>i. anëtari i Bursës, i cili është në pozicion shitës në këto njësi të tjera kohore të tregut nuk i lejohet të ulë volumin në shitje apo të rrisë çmimin.<br>ii. anëtari i Bursës, i cili është në pozicion blerës në këto njësi të tjera kohore të tregut nuk i lejohet të rrisë çmimin.<br>i. në rastet e urdhërporosive në Bllok nuk zbatohen parashikimet e nënparagrafëve i dhe i.<br>Në çdo kohë, kur do t'i kërkohet nga ALPEX-i, anëtari i Bursës do të duhet të justifikojë me fakte lidhjen ndërmjet këtyre njësive të tjera kohore me njësinë kohore të prekur, që ndryshimi i njësisë kohore të prekur do të kërkojë domosdoshmërisht ndryshimin e këtyre njësive të tjera kohore. |

| | | |
|---|---|---|
| *është* | **B.2.3.4** | Një referencë për ndryshimin e urdhërporosive në paragrafin B.2.3.3 përfshin anulimin e urdhërporosive ekzistuese dhe dorëzimin e urdhërporosive të reja. |
| *bëhet* | | Referenca për ndryshimin e urdhërporosive në paragrafin B.2.3.3 përfshin anulimin e urdhërporosive ekzistuese dhe dorëzimin e urdhërporosive të reja. Për të shmangur çdo dyshim, numri i çifteve ÇS në urdhërporosinë e dorëzuar në ankandin e parë duhet të mbetet i njëjtë kur një anëtar i Bursës modifikon ose dorëzon urdhërporosi të reja në ankandin e dytë, në përputhje me dispozitat e paragrafit B.2.3.3 |
| *është* | **B.2.3.6** | ALPEX-i duhet të bëjë një njoftim siç kërkohet në paragrafin B.2.3.2, me anë të një njoftimi për tregu të dërguar me mjete elektronike në përputhje me pikën C.3.2 të kushteve të përgjithshme të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike. |
| *bëhet* | | ALPEX-i duhet të bëjë një njoftim siç kërkohet në paragrafin B.2.3.2, me anë të një njoftimi për tregun të dërguar me mjete elektronike në përputhje me pikën C.3.2 të kushteve të përgjithshme të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike. Forma standarde e këtij njoftimi do të përcaktohet në vendimin teknik të ALPEX-it. |
| *është* | | |
| *bëhet* | **B.2.4**<br>**B.2.4.1**<br>**B.2.4.2**<br>**B.2.4.3**<br>**B.2.4.4**<br>**B.2.4.5** | B.2.4 Operimi i Bashkimit të Tregut të Ditës në Avancë<br>B.2.4.1 Zonat e ofertimit të Shqipërisë dhe Kosovës operojnë Tregun e tyre të Ditës në Avancë si Bashkim Tregjesh.<br>B.2.4.2 NEMO-t dhe OST-të operojnë Bashkimin e Tregut siç parashikohet në B.2.4.1 përmes Marrëveshjes Operacionale të Bashkimit të Tregut të Ditës në Avancë, në përputhje me modelin dhe metodologjinë e SDAC. Si pjesë e kësaj marrëveshje janë edhe procedurat që duhen zbatuar për këtë Bashkim Tregu nga NEMO-t, OST-të dhe anëtarët e Bursës. Këto procedura janë të publikuara në faqen zyrtare të internetit të ALPEX-it.<br>B.2.4.3 ALPEX-i përdor zgjidhjen e algoritmit evropian të Bashkimit të Tregut të Ditës në Avancë për përcaktimin e çmimeve kleruese të Bashkimit të Tregut, flukseve ndërkufitare dhe llogaritjen e pozicionit neto, në përputhje me kapacitetet dhe kufizimet e alokimit ndërkufitar të verifikuara nga OST-të.<br>B.2.4.4 Operatori i Bashkimit të Tregut është përgjegjës për performancën Funksionimit të Operimit të Bashkimit të Tregut. Funksionimi i Bashkimit të Tregut është një shërbim që i ofrohet ALPEX-it përmes ofruesit të shërbimit të Bashkimit të Tregut.<br>B.2.4.5 Objektivi i mekanizmit të Bashkimit të Tregut të Ditës në Avancë është të maksimizojë përfitimin social-ekonomik (*social welfare*) të zonave të ofertimit në Bashkimin e Tregut, në mënyrë specifike duke maksimizuar shumën e tepricës së urdhërporosive të shitjes dhe blerjes të përfshira në librin e përbashkët të urdhërporosive shtuar të ardhurat nga kongjestioni. |

| | | |
|---|---|---|
| *është*<br>*bëhet* | **B.3.1.3 (c)** | statusi dhe raporti i pranimit të urdhërporosive në Bllok. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | | |
| *bëhet* | **B.3.1.4** | Rezultatet e Bashkimit të Tregut të Ditës në Avancë përbëhen nga çmimet e klerimit të tregut për çdo njësi kohore tregu për ditën e livrimit D për secilën zonë ofertimi, pozicioni neto i livrimit për secilën zonë ofertimi, si dhe statusi dhe raporti i pranimit të urdhërporosive në Bllok. |
| *është* | | |

| | | |
|---|---|---|
| *bëhet* | **B.3.1.5** | Pas përfundimit të ekzekutimit të algoritmit të Bashkimit të Çmimeve, Operatori i Bashkimit të Tregjeve do t'i dorëzojë ALPEX-it rezultatet paraprake të Bashkimit të Tregut të Ditës në Avancë. |
| *është* | | |
| *bëhet* | **B.3.1.6** | ALPEX-i do të konfirmojë që rezultatet paraprake të Bashkimit të Tregut të Ditës në Avancë janë llogaritur sipas urdhërporosive të dorëzuara dhe do të dërgojë konfirmimin pozitiv të rezultateve paraprake të Operatori i Bashkimit të Tregjeve. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | | |
| *bëhet* | **B.3.1.7** | Nëse asnjë NEMO i Tregjeve të Bashkuara ose Operator i Sistemit të Transmetimit nuk refuzon rezultatet paraprake të Bashkimit të Tregut të Ditës në Avancë ose nuk aktivizohet një ankand i dytë, Operatori i Bashkimit të Tregjeve do të dërgojë konfirmimin e rezultateve përfundimtare globale tek ALPEX-i. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | **C.1.1.2** | C.1.1.2 LIDA-1, LIDA-2 dhe LIDA-3 zhvillohen si ankande lokale brenda së njëjtës ditë. |
| *bëhet* | | ***Shfuqizohet*** |
| *është* | **C.1.2.1** | Ankandi brenda së njëjtës ditë funksionon në përputhje me kohën e përcaktuar në vendimet teknike të ALPEX-it. |
| *bëhet* | | Në Tregun e Ankandit Brenda së Njëjtës Ditë, anëtari i Bursës mund të tregtojë çdo ditë kalendarike për ditën përkatëse të livrimi nga koha e hapjes deri në kohën e mbylljes së portës siç përcaktohet në tabelën e paragrafit A.2.4.6. |
| *është* | **C.1.2.2** | ALPEX-i mund të zgjasë kohën e mbylljes së portës së tregut të ankandeve brenda së njëjtës ditë për të mbajtur kushtet e rregullta të tregtimit. Në ankandet brenda së njëjtës ditë, koha e mbylljes së portës mund të zgjatet për arsye që lidhen me disponueshmërinë e ETSS-ës, librin e urdhërporosisë lokale, si dhe për arsye që lidhen me ndarjen e plotë të tregjeve (*Full Decoupling*). |
| *bëhet* | | ALPEX-i mund të zgjasë kohën e mbylljes së portës së tregut të ankandeve brenda së njëjtës ditë për të mbajtur kushtet e rregullta të tregtimit. Në ankandet brenda së njëjtës ditë, koha e mbylljes së portës mund të zgjatet për arsye që lidhen me disponueshmërinë e ETSS-ës, librin e urdhërporosisë lokale, për arsye që lidhen me ndarjen e plotë të Tregjeve (*Full Decoupling*), si dhe parashikimeve të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike-Kushtet e përgjithshme. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | **C.1.3.1 (d)** | Kodi i kontratës së zbatueshme i cili vendos kontratën e tregtueshme specifike brenda ditës së livrimit D: produkte orare, produkte 30 minuta, produkte 15 minuta ose në Bllok; |
| *bëhet* | | Kodi i kontratës së zbatueshme i cili vendos kontratën e tregtueshme specifike brenda ditës së livrimit D: produkte orare, produkte 30 minuta, produkte 15 minuta; |
| *është* | **C.1.5.3** | Çmimi i pikës së parë të segmentit të parë të kurbës së urdhërporosi shitjeje është i barabartë me çmimin minimal të ankandit të tregut brenda së njëjtës ditë për urdhërporositë, ndërsa çmimi i pikës së dytë të segmentit të fundit të kurbës së urdhërporosi shitjeje është i barabartë çmimin maksimal të ankandit të tregut brenda së njëjtës ditë për urdhërporositë. |
| *bëhet* | | Çmimi i pikës së parë i segmentit të parë të kurbës së urdhërporosisë shitjeje është i barabartë me çmimin minimal të urdhërporosisë të ankandit të tregut brenda së njëjtës ditë, ndërsa çmimi i pikës së dytë i segmentit të fundit të kurbës së urdhërporosisë shitjeje është i barabartë çmimin maksimal të urdhërporosisë të ankandit të tregut brenda së njëjtës ditë. |

| | | |
|---|---|---|
| *është* | **C.1.5.4** | Çmimi i pikës së parë të segmentit të parë të kurbës së urdhërporosi blerjeje është i barabartë me çmimin maksimal të ankandit të tregut brenda së njëjtës ditë për urdhërporositë, ndërsa çmimi i pikës së dytë të segmentit të fundit të kurbës së urdhërporosi blerjeje është i barabartë me çmimin minimal të ankandit të tregut brenda së njëjtës ditë për urdhërporositë. |

| | | |
|---|---|---|
| *bëhet* | | Çmimi i pikës së parë i segmentit të parë të kurbës së urdhërporosisë blerjeje është i barabartë me çmimin maksimal të urdhërporosisë të ankandit të tregut brenda së njëjtës ditë, ndërsa çmimi i pikës së dytë i segmentit të fundit të kurbës së urdhërporosisë blerjeje është i barabartë me çmimin minimal të urdhërporosisë të ankandit të tregut brenda së njëjtës ditë. |
| *është* | | |
| *Bëhet* | **C.1.5.6** | Çdo urdhërporosi e thjeshtë duhet të specifikojë një çift ÇS me një çmim sa çmimi minimal i urdhërporosisë të ankandit të tregut brenda së njëjtës ditë dhe një çift ÇS me një çmim sa çmimi maksimal i urdhërporosisë të ankandit të tregut brenda së njëjtës ditë. Urdhërporosia nuk duhet të përmbajë çifte ÇS me çmime më të ulëta se çmimi minimal i urdhërporosisë ose më të larta se çmimi maksimal i urdhërporosisë të ankandit të tregut brenda së njëjtës ditë. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | **C.1.5.6** | Çiftet ÇS në urdhërporosinë e thjeshtë paraqiten nga një funksion i thyer-me hapa (step-wise) i çmimit dhe sasisë së energjisë elektrike për blerje dhe/ose shitje në njësi kohore të tregut përkatës, ose me rritjen graduale të sasisë së energjisë elektrike ose me zbritjen graduale të sasisë së energjisë elektrike për çdo hap çmimi sipas paragrafit C.1.5.7, |
| *bëhet* | **C.1.5.7** | Çiftet ÇS në urdhërporosinë e thjeshtë paraqiten nga një funksion i thyer-me hapa (step-wise) i çmimit dhe sasisë së energjisë elektrike për blerje dhe/ose shitje në njësi kohore të tregut përkatës, ose me rritjen graduale të sasisë së energjisë elektrike ose me zbritjen graduale të sasisë së energjisë elektrike për çdo hap çmimi sipas paragrafit C.1.5.8. |
| *është* | **C.1.5.7** | Çmimet e përcaktuara për urdhërporosi e thjeshtë shitjeje do të rriten në mënyrë monotonike, dhe për urdhërporosi e thjeshtë blerjeje do të zbriten në mënyrë monotonike. Në këtë mënyrë |
| *bëhet* | **C.1.5.8** | Çmimet e përcaktuara për urdhërporosinë e thjeshtë shitjeje do të rriten në mënyrë monotonike, dhe për urdhërporosi e thjeshtë blerjeje do të zbriten në mënyrë monotonike. Në këtë mënyrë |
| *është* | **C.1.5.7 (a)** | Në rastin e një urdhërporosi e thjeshtë shitjeje për një njësi kohore tregu, lidhur me sasinë dhe çmimin do të zbatohet ky rregull |
| *bëhet* | **C.1.5.8 (a)** | Në rastin e një urdhërporosie të thjeshtë shitjeje për një njësi kohore tregu, lidhur me sasinë dhe çmimin do të zbatohet ky rregull |
| *është* | **C.1.6** | Operimi i Bashkimit të Tregjeve |
| *bëhet* | | Operimi i Bashkimit të Tregjeve Brenda së Njëjtës Ditë |
| *është* | | |
| *bëhet* | **C.1.6.1** | Zonat e ofertimit të Shqipërisë dhe Kosovës operojnë tregun e tyre të ankandeve brenda së njëjtës ditë si Bashkim Tregjesh. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | | |

| | | |
|---|---|---|
| *bëhet* | **C.1.6.2** | NEMO-t dhe OST-të operojnë Bashkimin e Tregut siç parashikohet në C.1.6.1, përmes Marrëveshjes Operacionale të Bashkimit të Tregut të Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë, në përputhje me modelin dhe metodologjinë e SIDC. Si pjesë të kësaj marrëveshje janë edhe procedurat e nevojshme që duhen zbatuar për këtë Bashkim Tregu nga NEMO-t, OST-të dhe anëtarët e Bursës. Këto procedura janë të publikuara në faqen zyrtare të internetit të ALPEX-it. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | | |
| *Bëhet* | **C.1.6.3** | ALPEX-i përdor zgjidhjen e algoritmit evropian të Bashkimit të Tregut të Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë për përcaktimin e çmimeve kleruese të Bashkimit të Tregut, flukseve ndërkufitare dhe llogaritjen e pozicionit neto, në përputhje me kapacitetet dhe kufizimet e alokimit ndërkufitar të verifikuara nga OST-të. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | **C.1.6.1** | Operatori i Bashkimit të Tregjeve është përgjegjës për kryerjen e funksionit të operimit të Bashkimit të Tregjeve. Funksioni i Bashkimit të Tregjeve është një shërbim i ofruar ALPEX-it nga ofruesi i tij i shërbimit të Bashkimit të Tregjeve. |
| *bëhet* | **C.1.6.4** | Operatori i Bashkimit të Tregut të Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë është përgjegjës për kryerjen e funksionit të operimit të Bashkimit të Tregjeve. Funksioni i Bashkimit të Tregjeve është një shërbim i ofruar ALPEX-it nga ofruesi i tij i shërbimit të Bashkimit të Tregjeve. |
| *është* | **C.1.6.2** | Objektivi i mekanizmit të Bashkimit të Tregjeve të Ditës në Avancë është maksimizimi i mirëqenies sociale i zonave të ofertimit të bashkuara, përkatësisht maksimizimi i shumës totale së tepricave të urdhërporosive shitjeje dhe blerjeje të përfshira në librin e urdhërporosive të grupuara plus të ardhurat nga kongjestioni. |

| | | |
|---|---|---|
| *bëhet* | **C.1.6.5** | Objektivi i mekanizmit të Bashkimit të Tregjeve Brenda së Njëjtës Ditë është maksimizimi i përfitimeve social-ekonomike (*Social Welfare*) i zonave të ofertimit të bashkuara, përkatësisht maksimizimi i shumës totale së tepricave të urdhërporosive shitjeje dhe blerjeje të përfshira në librin e urdhërporosive të grupuara shtuar të ardhurat nga kongjestioni. |
| *është* | **C.1.6.3** | Teprica e urdhërporosive shitjeje të pranuara është e barabartë me prodhimin (shumëzimin) e diferencës së çmimit klerues margjinal minus çmimin e urdhërporosisë së tyre me sasinë e energjisë elektrike të pranuar. Teprica e urdhërporosive blerjeje të pranuara është e barabartë me prodhimin (shumëzimin) e diferencës së çmimit të urdhërporosisë minus çmimin klerues margjinal me sasinë e energjisë elektrike të pranuar. |
| *bëhet* | **C.1.6.6** | Teprica e urdhërporosive shitjeje të pranuara është e barabartë me diferencën e çmimit klerues me çmimin e urdhërporosisë shumëzuar me sasinë e energjisë elektrike të pranuar. Teprica e urdhërporosive blerjeje të pranuara është e barabartë me diferencën e çmimit të urdhërporosisë minus çmimin klerues shumëzuar me sasinë e energjisë elektrike të pranuar. |
| *është* | | |
| *bëhet* | **C.2.1.2** | Rregullat e pranimit të urdhërporosive referuar paragrafëve C.2.1.3 deri C.2.1.7 nga algoritmi për bashkimin e çmimit në tregut të ankandeve brenda së njëjtës ditë përfshijnë situatat si gjatë operimit të tregjeve të bashkuara dhe jo të bashkuara, dhe operimit në ndarjen e plotë të tregjeve. |
| | ***Shtohet*** | |

| | | |
|---|---|---|
| *është* | **C.2.2.1** | Algoritmi përcakton çmimin e ankandit, volumet e përputhura të grupuara dhe pozicionet/gjendjet neto për çdo zonë ofertimi në Bashkimin e Tregjeve. |
| *bëhet* | | Algoritmi përcakton çmimin e ankandit, volumet e përputhura të grupuara dhe pozicionet neto për çdo njësi kohore tregu dhe zonë ofertimi në Bashkimin e Tregjeve. |
| *është* | **C.2.2.2** | Në përcaktimin e rezultateve sipas paragrafit C.2.2.1 për një rajon të bashkuar, duhet të përmbushen parimet e mëposhtme: |
| *bëhet* | | Në përcaktimin e rezultateve sipas paragrafit C.2.2.1 duhet të përmbushen parimet e mëposhtme për Bashkimin e Tregjeve në nivel rajonal ose evropian: |
| *është* | **C.2.2.2 (a)** | Çmimi i Bashkimit të Tregjeve në anën e importit të një interkonektori do të jetë më i lartë ose i barabartë më çmimin e Bashkimit të Tregjeve në anën e eksportit të interkonektorit; dhe |
| *bëhet* | | Çmimi klerues i Bashkimit të Tregjeve në anën e zonës së ofertimit të importit të një interkonektori do të jetë më i lartë ose i barabartë më çmimin e Bashkimit të Tregjeve në anën e zonës së ofertimit të eksportit të interkonektorit pa humbjet; dhe |
| *është* | **C.2.2.2 (b)** | kur eksporti ose importi është më i vogël se kapaciteti ndërkufitar i caktuar nga ose në emër të OST-ve përkatëse, çmimi i Bashkimit të Tregjeve në anën e importit të një interkonektori do të jetë i barabartë më çmimin e Bashkimit të Tregjeve. |
| *bëhet* | | kur sasia e energjisë për eksport ose import është më i vogël se kapaciteti ndërkufitar i caktuar nga ose në emër të OST-ve përkatëse, çmimi klerues i Bashkimit të Tregjeve në anën e zonës së ofertimit të importit të një interkonektori do të jetë i barabartë më çmimin klerues të Bashkimit të Tregjeve në anën e zonës së ofertimit të eksportit të interkonektorit, pa humbjet. |
| *është* | | |
| *bëhet* | **C.2.2.2 (c)** | Në rast se sasia e energjisë për eksport ose import do të ishte më e madhe se sa kapaciteti ndërkufitar i vlefshëm i dorëzuar nga ose në emër të OST-ve përkatëse, çmimi klerues i Bashkimit të Tregjeve në anën e zonës së ofertimit të eksportit të interkonektorit do të jetë më i ulët se çmimi klerues në Bashkimin e Tregjeve në anën e zonës së ofertimit të importit të interkonektorit, pa humbjet. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | | |
| *bëhet* | **C.2.2.2 (d)** | Në rastin e (c), gjenerohen të ardhura nga kongjestioni. Këto të ardhura do të mblidhen nga agjenti i transferimit dhe do të shpërndahen tek OST-të nga shpërndarësi i kongjestioneve. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | | |
| *bëhet* | **C.3.1.4** | Rezultatet e Bashkimit të Tregut të Ankandit Brenda së Njëjtës Ditë përbëhen nga çe të tregut për çdo njësi kohore të tregut për ditën e livrimit D për secilën zonë ofertimi, pozicioni neto i livrimit për secilën zonë ofertimi. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | | |

| | | |
|---|---|---|
| *bëhet* | **C.3.1.5** | Pas përfundimit të ekzekutimit të algoritmit të Bashkimit të Çmimeve, operatori i Bashkimit të Tregjeve do t'i dorëzojë ALPEX-it rezultatet paraprake të bashkimit të tregut të ankandit brenda së njëjtës ditë. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | | |

| | | |
|---|---|---|
| *bëhet* | **C.3.1.6** | ALPEX-i do të konfirmojë që rezultatet paraprake të Bashkimit të Tregut të Ankandit Brenda së Njëjtës Ditë janë llogaritur sipas urdhërporosive të dorëzuara dhe në përputhje me kapacitetin ndërkufitar dhe kufizimet në alokim të vlerësuara dhe do të dërgojë konfirmimin pozitiv të rezultateve paraprake të operatori i bashkimit të tregjeve. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | | |
| *bëhet* | **C.3.1.7** | Nëse asnjë NEMO i Tregjeve të Bashkuara ose Operator i Sistemit të Transmetimit nuk refuzon rezultatet paraprake të Bashkimit të Tregut të ankandit brenda së njëjtës ditë, Operatori i Bashkimit të Tregjeve do të dërgojë konfirmimin e rezultateve përfundimtare globale tek ALPEX-i. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | **C.3.2.2 (b)** | Statistikat për numrin total të urdhërporosive në Bllok të paraqitura dhe pranuara së bashku me totalin e sasisë së energjisë elektrike të urdhërporosive në Bllok të ofruar dhe pranuar për njësi kohore tregu; |
| *bëhet* | | ***Shfuqizohet*** |
| *është* | | |
| *Bëhet* | **D.1.1.1** | Në tregtimin e vazhdueshëm brenda së njëjtës ditë, anëtarët e Bursës mund të dorëzojnë urdhërporosi blerjeje dhe shitjeje për njësitë kohore të ditës së livrimit D në ETSS. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | | |
| *Bëhet* | **D.1.1.2** | Anëtarët e Bursës mund të dorëzojnë urdhërporosi blerjeje dhe shitjeje nga koha e hapjes së portës së dorëzimit dhe deri në kohën përkatëse të mbylljes së portës së dorëzimit për tregtimin e vazhdueshëm brenda së njëjtës ditë për një kontratë të veçantë. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | | |
| *bëhet* | **E.1.1.3** | ALPEX-i shpall aktivizimin e procedurës alternative të Tregut të Ditës në Avancë dhe/ose segmentin e Tregut të Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë përmes çdo mjeti të disponueshëm, duke përfshirë komunikimin elektronik me anëtarët e Bursës ose publikimin në faqen e saj të internetit. Njoftimi specifikon arsyen e aktivizimit dhe kohën e parashikuar të zgjidhjes. ALPEX-i informon Autoritetet Rregullatore, OST-në dhe/ose entitetet të tjera ligjore nëse është rasti. |
| *arsyeja* | ***Shtohet*** | |
| *është* | | |
| *bëhet* | **E.1.1.4** | Anëtarët e Bursës duhet të ndjekin udhëzimet dhe veprimet përkatëse të ALPEX-it, pavarësisht çdo kundërshtimi specifik që ata mund të ngrenë gjatë aktivizimit në procedurën alternative të Tregut të Ditës në Avancë dhe/ose segmentin e Tregut të Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | | |
| *bëhet* | **E.1.1.5** | Menjëherë pas trajtimit të ngjarjes që shkaktoi aktivizimin e procedurës alternative, ALPEX-i do të publikojë një njoftim për rikthimin e operimit të Tregut të Ditës në Avancë dhe/ose segmentin e Tregut të Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | **E.2.1.1** | Në këtë seksion E.2.1.1 Zonat e ofertimit AL-KS konsiderohen si "ndarje e plotë e Bashkimit të Tregjeve" kur ALPEX-i deklaron ndarjen e Bashkimit të Tregjeve në rrethana që identifikohen në paragrafin E.2.1.2 sipas procedurës së qeverisjes së Bashkimit të Tregjeve të Zonave të Ofertimit AL-KS. |

| | | |
|---|---|---|
| *bëhet* | | Në këtë seksion E.2.1.1 zonat e ofertimit AL-KS konsiderohen si "Ndarje e plotë e Bashkimit të Tregjeve" kur Komiteti i Incidencës deklaron ndarjen e Bashkimit të Tregjeve në rrethana që identifikohen në paragrafin E.2.1.2, sipas procedurës së qeverisjes së Bashkimit të Tregjeve të Zonave të Ofertimit AL-KS. |

| | | |
|---|---|---|
| *është* | **E.2.2.1** | Sipas procedurës qeverisëse të Bashkimit të Tregjeve AL-KS, nëse ofruesi i shërbimit të Bashkimit të Tregjeve nuk është i aftë të përcaktojë rezultatet e një procesi të Bashkimit të Tregjeve AL-KS në lidhje me ankandin e ditës në Avancë deri në orën 13:00 (CET) në ditën përpara ditës përkatëse të livrimit D, ALPEX-i do të deklarojë ndarjen e plotë të Bashkimit të Tregjeve AL-KS për ditën përkatëse të livrimit D. |
| *bëhet* | | Sipas procedurës qeverisëse të Bashkimit të Tregjeve AL-KS, nëse ofruesi i shërbimit të Bashkimit të Tregjeve nuk është i aftë të përcaktojë rezultatet e një procesi të Bashkimit të Tregjeve AL-KS në lidhje me ankandin e ditës në avancë deri në orën 13:00 (CET) në ditën përpara ditës përkatëse të livrimit D, Komiteti i Incidencës do të deklarojë ndarjen e plotë të Bashkimit të Tregjeve AL-KS për ditën përkatëse të livrimit D sipas afateve të përcaktuar në procedurat qeverisëse të Bashkimit të Tregjeve AL-KS. |
| *është* | **E.2.2.3** | ALPEX-i do të mundësojë rezultatet e ankandit të ditës në avancë të zhvilluara si ankand lokal sipas paragrafit E.2.2.2 (b), anëtarëve të Bursës sapo ato të bëhen të disponueshme nga ora 13:25 (CET) në ditën para ditës përkatëse të livrimit (D) dhe jo në përputhje me afatet e përcaktuara në tabelën A.1 të shtojcës A. |
| *bëhet* | | ALPEX-i do të mundësojë rezultatet e ankandit të ditës në avancë të zhvilluara si ankand lokal sipas paragrafit E.2.2.2 (b) anëtarëve të Bursës sapo ato të bëhen të disponueshme prej orës 14:25 (CET) në ditën para ditës përkatëse të livrimit (D) dhe jo në përputhje me afatet e përcaktuara në tabelën A.1 të shtojcës A. |
| *është* | **E.2.3.1** | Sipas procedurës qeverisëse të Bashkimit të Tregjeve AL-KS, nëse kapaciteti ndërkufitar në lidhje me ankandin e ditës në avancë, në përputhje me kohët e synuara të aplikueshme të vendosura në tabelën në paragrafin E.2.1.2 nuk janë dorëzuar tek ALPEX-i, ALPEX-i mund të deklarojë ndarjen e plotë të Bashkimit të Tregjeve AL-KS për ditën përkatëse të livrimit (D). |
| *bëhet* | | Sipas procedurës qeverisëse të Bashkimit të Tregjeve AL-KS, nëse kapaciteti ndërkufitar në lidhje me ankandin e ditës në avancë, në përputhje me kohët e synuara të aplikueshme të vendosura në tabelën në paragrafin E.2.1.2, nuk janë dorëzuar tek ALPEX-i, Komiteti i Incidencës mund të deklarojë ndarjen e plotë të Bashkimit të Tregjeve AL-KS për ditën përkatëse të livrimit (D) sipas afateve të përcaktuar në procedurat qeverisëse të Bashkimit të Tregjeve AL-KS. |
| *është* | **E.2.4.1** | Sipas procedurës qeverisëse të Bashkimit të Tregjeve AL-KS, nëse Bursa është prekur nga një ndarje e plotë e Bashkimit të Tregjeve në lidhje me ditën e livrimit (D), dhe prej orës 09:30 (CET) në ditën përpara ditës përkatëse të livrimit (D) ALPEX-i është i bindur që çështjet teknike që shkaktuan ndarjen e plotë të Bashkimit të Tregjeve nuk mund të zgjidhen, ALPEX-i mund të deklarojë ndarjen e plotë të Bashkimin të Tregjeve AL-KS për ditën përkatëse të livrimit (D). |
| *bëhet* | | Sipas procedurës qeverisëse të Bashkimit të Tregjeve AL-KS, nëse Bursa është prekur nga një ndarje e plotë e Bashkimit të Tregjeve në lidhje me ditën e livrimit (D), dhe prej orës 09:30 (CET) në ditën përpara ditës përkatëse të livrimit (D) Komiteti i Incidencës është i bindur që çështjet teknike që shkaktuan ndarjen e plotë të Bashkimit të Tregjeve nuk mund të zgjidhen, mund të deklarojë ndarjen e plotë të Bashkimit të Tregjeve AL-KS për ditën përkatëse të livrimit (D) sipas afateve të përcaktuar në procedurat qeverisëse të Bashkimit të Tregjeve AL-KS. |

| | | |
|---|---|---|
| *është* | **E.2.5.1** | Kur një ankand i ditës në avancë zhvillohet si një ankand lokal në përputhje me paragrafin E.2.2.2, do të zbatohet procedura në seksionin B.2, dhe kapaciteti ndërkufitar përkatës nuk merret parasysh nga ofruesi i shërbimit të Bashkimit të Tregjeve. |
| *bëhet* | | Kur një ankand i ditës në avancë zhvillohet si një ankand lokal në përputhje me paragrafin E.2.2.2 dheE.2.3.2, do të zbatohet procedura në seksionin B.2, dhe kapaciteti ndërkufitar përkatës nuk merret parasysh nga ofruesi i shërbimit të Bashkimit të Tregjeve. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | **E.2.5.2** | Nëse rezultati i Ankandit të Ditës në Avancë i zhvilluar si Ankand Lokal nuk është në dispozicion deri në orën 13:45 në ditën përpara Ditës përkatëse të Livrimit (D), atëherë ALPEX-i do të anulojë Ankandin dhe do të njoftojë Anëtarët e Bursës. |
| *bëhet* | | Nëse rezultati i ankandit të ditës në avancë i zhvilluar si ankand lokal nuk është në dispozicion deri në orën 15:20 në ditën përpara ditës përkatëse të livrimit (D), atëherë ALPEX-i do të anulojë ankandin dhe do të njoftojë anëtarët e Bursës. |
| *është* | **E.3.1.1** | Në këtë seksion E.3.1.2, zonat e ofertimit AL-KS konsiderohen si "ndarje e plotë të Bashkimit të Tregjeve" kur ALPEX-i deklaron ndarjen e Bashkimit të Tregjeve në rrethanat që identifikohen në paragrafin E.3.1.2, sipas procedurës së qeverisjes së Bashkimit të Tregjeve të Zonave të Ofertimit AL-KS. |

| | | |
|---|---|---|
| *bëhet* | | Në këtë seksion E.3.1.2, zonat e ofertimit AL-KS konsiderohen si "Ndarje e plotë të Bashkimit të Tregjeve" kur Komiteti i Incidencës deklaron ndarjen e Bashkimit të Tregjeve në rrethanat që identifikohen në paragrafin E.3.1.2, sipas procedurës së qeverisjes së Bashkimit të Tregjeve të zonave të ofertimit AL-KS. |
| *është* | **E.3.2.1 (a)** | Për CRIDA-1, deri në orën 16:15 (CET) në ditën përpara ditës përkatëse të livrimit (D), ALPEX-i do të deklarojë ndarjen e plotë të Bashkimit të Tregjeve AL-KS për ditën përkatëse të livrimit (D). |
| *bëhet* | | Për segmentin e tregut CRIDA-1, deri në orën 16:15 (CET) në ditën përpara ditës përkatëse të livrimit (D), Komiteti i Incidencës do të deklarojë ndarjen e plotë të Bashkimit të Tregjeve AL-KS për ditën përkatëse të livrimit (D). |
| *është* | **E.3.2.1 (b)** | Për CRIDA-2, deri në orën 23:30 (CET) në ditën përpara ditës përkatëse të livrimit (D), ALPEX-i do të deklarojë ndarjen e plotë të Bashkimin të Tregjeve AL-KS për ditën përkatëse të livrimit (D). |
| *bëhet* | | Për segmentin e tregut CRIDA-2, deri në orën 23:30 (CET) në ditën përpara ditës përkatëse të livrimit (D), Komiteti i Incidencës do të deklarojë Ndarjen e Plotë të Bashkimin të Tregjeve AL-KS për ditën përkatëse të livrimit (D). |
| *është* | **E.3.2.1 (c)** | Për CRIDA-3, deri në orën 10:45 (CET) në ditën përkatëse të livrimit (D), ALPEX-i do të deklarojë ndarjen e plotë të Bashkimin të Tregjeve AL-KS për ditën përkatëse të livrimit (D). |
| *bëhet* | | Për segmentin e tregut CRIDA-3, deri në orën 10:45 (CET) në ditën përkatëse të livrimit (D), Komiteti i Incidencës do të deklarojë ndarjen e plotë të Bashkimin të Tregjeve AL-KS për ditën përkatëse të livrimit (D). |
| *është* | **E.3.2.3 (a)** | 15:30 (CET) në ditën para ditës përkatëse të livrimit (D) dhe jo në përputhje me afatet e përcaktuara në tabelën A.2 të shtojcës A. |
| *bëhet* | | Për segmentin e tregut CRIDA-1 nga ora 17:00 (CET) në ditën para ditës përkatëse të livrimit (D) dhe jo në përputhje me afatet e përcaktuara në tabelën A.2 të shtojcës A. |
| *është* | | |
| *bëhet* | **E.3.2.3 (b)** | Për segmentin e tregut CRIDA-2 nga ora 23:40 (CET) në ditën para ditës përkatëse të livrimit (D) dhe jo në përputhje me afatet e përcaktuara në tabelën A.2 të shtojcës A. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | | |

| | | |
|---|---|---|
| *bëhet* | **E.3.2.3 (c)** | Për segmentin e tregut CRIDA-3 nga ora 11:30 (CET) në ditën përkatëse të ditës së livrimit (D) dhe jo në përputhje me afatet e përcaktuara në tabelën A.2 të shtojcës A. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | **E.3.3.1** | Sipas procedurës qeverisëse të Bashkimit të Tregjeve AL-KS, nëse kapaciteti ndërkufitar në lidhje me ankandin përkatës brenda së njëjtës ditë, në përputhje me kohët e synuara të aplikueshme të vendosura në tabelën në paragrafin E.3.1.2, nuk janë dorëzuar tek ALPEX-i, ALPEX-i mund të deklarojë ndarjen e plotë të Bashkimit të Tregjeve AL-KS për CRIDA-n përkatëse në ditën e livrimit (D). |
| *bëhet* | | Sipas procedurës qeverisëse të Bashkimit të Tregjeve AL-KS, nëse kapaciteti ndërkufitar në lidhje me ankandin përkatës brenda së njëjtës ditë, në përputhje me kohët e synuara të aplikueshme të vendosura në tabelën në paragrafin E.3.1.2, nuk janë dorëzuar tek ALPEX-i, Komiteti i Incidencës mund të deklarojë ndarjen e plotë të Bashkimit të Tregjeve AL-KS për CRIDA-n përkatëse në ditën e livrimit (D). |
| *është* | **E.3.3.2** | Në rast deklarimi të një ndarje të plotë të Bashkimit të Tregjeve në lidhje me CRIDA-1, CRIDA-2 ose CRIDA-3, ALPEX-i, do të: |
| *bëhet* | | Në rast deklarimi të një ndarje të plotë të Bashkimit të Tregjeve në lidhje me CRIDA-2 ose CRIDA-3, ALPEX-i do të: |
| *është* | **E.3.3.3** | ALPEX-i do të mundësojë rezultatet e ankandit brenda së njëjtës ditë të zhvilluara si ankand lokal sipas paragrafit E.3.3.2 (b) anëtarëve të Bursës sapo ato të bëhen të disponueshme nga ora 22:30 (CET) në ditën para ditës përkatëse të livrimit (D) dhe jo në përputhje me afatet e përcaktuara në tabelën A.2 të shtojcës A. |
| *bëhet* | | ALPEX-i do të mundësojë rezultatet e ankandit brenda së njëjtës ditë të zhvilluara si Ankand Lokal sipas paragrafit E.3.3.2 (b), anëtarëve të Bursës sapo ato të bëhen të disponueshme: |
| *është* | **E.3.3.3 (a)** | 22:30 (CET) në ditën para ditës përkatëse të livrimit (D) dhe jo në përputhje me afatet e përcaktuara në tabelën A.2 të shtojcës A. |
| *bëhet* | | Për segmentin e tregut CRIDA-2 nga ora 23:40 (CET) në ditën para ditës përkatëse të livrimit (D) dhe jo në përputhje me afatet e përcaktuara në tabelën A.2 të shtojcës A. |

| | | |
|---|---|---|
| *është* | | |
| *bëhet* | **E.3.3.3 (b)** | Për segmentin e tregut CRIDA-3 nga ora 11:30 (CET) në ditën përkatëse të ditës së livrimit (D) dhe jo në përputhje me afatet e përcaktuara në tabelën A.2 të shtojcës A. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | **E.3.4.1** | Sipas procedurës qeverisëse të Bashkimit të Tregjeve AL-KS, nëse Bursa është prekur nga një ndarje e plotë e Bashkimit të Tregjeve në lidhje me ditën e livrimit (D), dhe prej orës 09:30 (CET) në ditën përkatëse të livrimit (D) dhe ALPEX-i është i bindur që çështjet teknike që shkaktuan ndarjen e plotë të Bashkimit të Tregjeve nuk mund të zgjidhen, ALPEX-i mund të deklarojë ndarjen e plotë të Bashkimit të Tregjeve AL-KS për ditën përkatëse të livrimit (D). |
| *bëhet* | | Sipas procedurës qeverisëse të Bashkimit të Tregjeve AL-KS, nëse Bursa është prekur nga një ndarje e plotë e Bashkimit të Tregjeve në lidhje me ditën e livrimit (D), dhe prej orës 09:30 (CET) në ditën përkatëse të livrimit (D) dhe Komiteti i Incidencës është i bindur që çështjet teknike që shkaktuan ndarjen e plotë të Bashkimit të Tregjeve nuk mund të zgjidhen, Komiteti i Incidencës mund të deklarojë ndarjen e plotë të Bashkimit të Tregjeve AL-KS për ditën përkatëse të livrimit (D). |
| *është* | **E.3.5.1** | Kur një ankand i brenda së njëjtës ditë zhvillohet si një ankand lokal në përputhje me paragrafin E.3.2.2, do të zbatohet procedura në seksionin C.2, dhe kapaciteti ndërkufitar përkatës nuk merret parasysh nga ofruesi i shërbimit të Bashkimit të Tregjeve. |

| | | |
|---|---|---|
| *bëhet* | | Kur një ankand i brenda së njëjtës ditë zhvillohet si një ankand lokal në përputhje me paragrafin E.3.2.2 dhe E.3.3.2, do të zbatohet procedura në seksionin C.2, dhe kapaciteti ndërkufitar përkatës nuk merret parasysh nga ofruesi i shërbimit të Bashkimit të Tregjeve. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | **E.3.5.2** | Nëse rezultati e ankandit brenda së njëjtës ditë, që zhvillohet si ankand lokale, nuk është në dispozicion deri në orën 13:45 në ditën përpara ditës përkatëse së livrimit (D), atëherë ALPEX-i do të anulojë ankandin dhe do të njoftojë anëtarët e Bursës. |
| *bëhet* | | Nëse rezultati e ankandit brenda së njëjtës ditë, që zhvillohet si ankand lokale, nuk është në dispozicion: |
| *është* | **E.3.5.2 (a)** | deri në orën 13:45 në ditën përpara ditës përkatëse së livrimit (D), atëherë ALPEX-i do të anulojë ankandin dhe do të njoftojë anëtarët e Bursës. |
| *bëhet* | | Për segmentin e tregut CRIDA-1 deri në orën 17:30 në ditën përpara ditës përkatëse së livrimit (D), atëherë ALPEX-i do të anulojë ankandin dhe do të njoftojë anëtarët e Bursës. |
| *është* | | |
| *bëhet* | **E.3.5.2 (b)** | Për segmentin e tregut CRIDA-2 deri në orën 23:40 në ditën përpara ditës përkatëse së livrimit (D), atëherë ALPEX-i do të anulojë ankandin dhe do të njoftojë anëtarët e Bursës. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | | |
| *bëhet* | **E.3.5.2 (c)** | Për segmentin e tregut CRIDA-3 deri në orën 11:30 në ditën përkatëse të ditës së livrimit (D), atëherë ALPEX-i do të anulojë ankandin dhe do të njoftojë anëtarët e Bursës. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | | |
| *bëhet* | **E.3.6** | Anulimi i kryerjes së ankandit të segmentit CRIDA-1. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | | |
| *bëhet* | **E.3.6.1** | Nëse kapacitetet ndërkufitare për segmentin e tregut CRIDA-1 lidhur me ditën e livrimit (D) nuk dorëzohen tek ALPEX-i në përputhje me kohën e synuar të përcaktuar në tabelat në paragrafin E.3.1.2, Komiteti i Incidencës mund të deklarojë anulimin e kryerjes së ankandit të segmentit CRIDA-1 për ditën përkatëse të livrimit (D). |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | | |
| *bëhet* | **E.3.6.2** | Nën procedurat që rregullojnë Bashkimin e Tregut AL-KS, nëse ofruesi i shërbimit të Bashkimit të Tregut nuk është në gjendje të përcaktojë rezultatet e një procesi të Bashkimit të Tregut AL-KS për një ankand të ditës në avancë lidhur me ditën e livrimit (D) deri në orën 13:30 (CET) në ditën D-1, Komiteti i Incidencës mund të deklarojë anulimin e kryerjes së ankandit të segmentit CRIDA-1 për ditën përkatëse të livrimit (D). |
| | ***Shtohet*** | |

**SHTOJCA A**
**TABELA A.1: SPECIFIKIMET E PRODUKTEVE TË SEGMENTIT TË TREGUT TË DITËS NË AVANCË**

| | | |
|---|---|---|
| **Kontratat për energji elektrike** | | |
| *është* | | |
| *Bëhet* | **Çmimi minimal i urdhërporosisë në Tregun e Ditës në Avancë** | Është një çmim i shprehur në euro /MWh në vlerë negative dhe përcaktohet me vendim nga Autoriteti Rregullator. |
| | ***Shtohet*** | |

| | | |
|---|---|---|
| *është* | | |
| *bëhet* | **Çmimi maksimal i urdhërporosisë në Tregun e Ditës në Avancë** | Është një çmim i shprehur në euro /MWh në vlerë pozitive dhe përcaktohet me vendim nga Autoriteti Rregullator. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | **Kufiri minimal i lejuar i çmimit për Tregun e Ditës në Avancë** | Është një çmim i shprehur në vlerë negative dhe përcaktohet me vendim nga Autoriteti Rregullator. |
| *bëhet* | | Është një kufi çmimi i shprehur në euro /MWh dhe përcaktohet me vendim nga Autoriteti Rregullator në rastet kur do të aktivizohet një ankand i dytë |
| *është* | **Kufiri maksimal i lejuar i çmimit për Tregun e Ditës në Avancë** | Është një çmim i shprehur në vlerë pozitive dhe përcaktohet me vendim nga Autoriteti Rregullator. |
| *bëhet* | | Është një kufi çmimi i shprehur në euro /MWh dhe në vlerë pozitive dhe përcaktohet me vendim nga Autoriteti Rregullator në rastet kur do të aktivizohet një ankand i dytë. |
| *është* | **Kufiri minimal dhe maksimal i lejuar i çmimit për Tregun e Ditës në Avancë (për Ankandin e Dytë)** | Është një çmim i shprehur në vlerë negative dhe pozitive (sipas rastit) dhe përcaktohet me vendim nga Autoriteti Rregullator. |
| *bëhet* | | |
| | ***Shfuqizohet*** | |
| **Urdhërporositë e thjeshta** | | |
| *është* | **Porosia duhet të përmbajë** | një çift çmim-sasi më çmimin minimal të ditës në avancë; dhe<br>një çift çmim-sasi më çmimin maksimal të ditës në avancë;<br>pa shkelur kushtet e kufiri minimal dhe maksimal i lejuar i çmimit për tregun e ditës në avancë, referuar ankandit të parë ose të dytë. |
| *bëhet* | **Urdhërporosia duhet të përmbajë** | një çift çmim-sasi më çmimin minimal i urdhërporosive të tregut të ditës në avancë; dhe<br>një çift çmim-sasi më çmimin maksimal i urdhërporosive të Tregut të Ditës në Avancë. |
| **Urdhërporositë marrëse e çmimit me përparësi** | | |
| *shtohet* | Numri minimal dhe maksimal i MTU-ve dhe çifteve çmim-sasi | 1. Numri minimal i MTU-ve në bllok për një portofol është 1 (një) dhe maksimal është 24 (njëzet e katër). 2. Një çift çmim-sasi |
| *shtohet* | **Numri minimal dhe maksimal i çifteve çmim-sasi** | Ndërmjet 2 dhe 50, për urdhërporosi për çdo njësi kohore e tregut. |
| *është* | **Porosia duhet të përmbajë** | një segment në çmimi minimal i ditës në avancë për rastin e shitjes dhe çmimi maksimal i Tregut Ditës në Avancë për rastin e blerjes. |
| *bëhet* | **Urdhërporosia duhet të përmbajë** | një segment në çmimin minimal i urdhërporosisë të tregut të ditës në avancë për rastin e shitjes dhe një segment në çmimin maksimal i urdhërporosisë të tregut ditës në avancë për rastin e blerjes. |
| **Urdhërporositë në Bllok** | | |
| *është* | **Çmim i urdhërporosisë në Bllok** | Çmim të vetëm midis çmimit minimal dhe çmimit maksimal të tregut të ankandeve. |
| *bëhet* | | Çmim të vetëm midis çmimit minimal dhe çmimit maksimal të urdhërporosive të tregut ditës në avancë. |

| | | |
|---|---|---|
| *është* | | |
| *bëhet* | **Numri minimal i njësive kohore të tregut të njëpasnjëshme** | Ndërmjet 2 deri 24 njësi kohore tregu. |
| *është* | | |
| *bëhet* | **Volumi minimal i ofertave në një njësi kohore tregu** | dy (2) njësi mbas presjes dhjetore ose 0.01 MWh. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | | |
| *bëhet* | **Volumi maksimal i ofertave në një njësi kohore tregu** | 200 MWh |
| *arsyeja* | Informacion i munguar dhe i nevojshëm për t'u shtuar . | |
| *është* | | |
| *bëhet* | **Norma minimale e pranimit** | 0% |
| | ***Shtohet*** | |
| **Urdhërporositë të lidhura në Bllok** | | |
| *është* | **Urdhërporositë** | Përbëhen nga të paktën dy urdhërporosi individuale në Bllok |
| *bëhet* | **Kufizimet lidhur me urdhërporositë të lidhura në Bllok** | 1. Numri maksimal i urdhërporosive të lidhura në Bllok për portofol është 5 (pesë). 2. Numri maksimal i urdhërporosive vartëse të lidhura me një urdhërporosi udhëheqëse është 4 (katër). 3. Numri maksimal i urdhërporosive udhëheqëse të lidhura me një urdhërporosi vartëse është 1 (një). |
| **SHTOJCA A**<br>**TABELA A.2: SPECIFIKIMET E PRODUKTEVE TË ANKANDEVE BRENDA SË NJËJTËS DITË** | | |
| *është* | **Koha e hapjes së portës** | LIDA 1: Në orën 13:00 CET një ditë përpara ditës së livrimit (D).<br>LIDA 2: Në orën 15:30 CET një ditë përpara ditës së livrimit (D).<br>LIDA 3: Në orën 22:30 CET një ditë përpara ditës së livrimit (D).<br>CRIDA 1: Në orën 13:00 CET një ditë përpara ditës së livrimit (D).<br>CRIDA 2: Në orën 15:30 CET një ditë përpara ditës së livrimit (D).<br>CRIDA 3: Në orën 22:30 CET një ditë përpara ditës së livrimit (D). |
| *bëhet* | | CRIDA 1: Në orën 13:00 CET një ditë përpara ditës së livrimit (D).<br>CRIDA 2: Në orën 15:30 CET një ditë përpara ditës së livrimit (D).<br>CRIDA 3: Në orën 22:30 CET një ditë përpara ditës së livrimit (D). |
| *është* | **Koha e mbylljes së portës** | LIDA 1: Në orën 15:00 CET një ditë përpara ditës së livrimit (D).<br>LIDA 2: Në orën 22:00 CET një ditë përpara ditës së livrimit (D).<br>LIDA 3: Në orën 10:00 CET në ditën e livrimit<br>CRIDA 1: Në orën 15:00 CET një ditë përpara ditës së livrimit (D).<br>CRIDA 2: Në orën 22:00 CET një ditë përpara ditës së livrimit (D).<br>CRIDA 3: Në orën 10:00 CET në ditën e livrimit |
| *bëhet* | | CRIDA 1: Në orën 15:00 CET një ditë përpara ditës së livrimit (D).<br>CRIDA 2: Në orën 22:00 CET një ditë përpara ditës së livrimit (D).<br>CRIDA 3: Në orën 10:00 CET në ditën e livrimit. |

| | | |
|---|---|---|
| *është* | **Njësia kohore e tregut** | LIDA 1, 24 periudha x 1 orë<br>LIDA 2, 24 periudha x 1 orë<br>LIDA 3, 12 periudha x 1 orë<br>CRIDA 1, 24 periudha x 1 orë<br>CRIDA 2, 24 periudha x 1 orë<br>CRIDA 3, 12 periudha x 1 orë<br>Në ditën e ndryshimit të orës nga ora dimërore në atë verore, ka 23 njësi kohore tregu në CRIDA-1 dhe CRIDA-2 dhe dy (2) orët ndërmjet 02:00 – 03:00 do të anashkalohen.<br>Në ditën e ndryshimit të orës, nga ora verore në atë dimërore, ka 25 njësia kohore tregu në CRIDA-1 dhe CRIDA-2 dhe 2 orët ndërmjet 02:00 – 03:00 do të trajtohen si dy orare të ndryshme. |

| | | |
|---|---|---|
| *bëhet* | | CRIDA 1, 24 periudha x 1 orë<br>CRIDA 2, 24 periudha x 1 orë<br>CRIDA 3, 12 periudha x 1 orë<br>Në ditën e ndryshimit të orës nga ora dimërore në atë verore, ka 23 njësi kohore tregu në CRIDA-1 dhe CRIDA-2 dhe dy (2) orët ndërmjet 02:00 – 03:00 do të anashkalohen.<br>Në ditën e ndryshimit të orës, nga ora verore në atë dimërore, ka 25 njësi kohore tregu në CRIDA-1 dhe CRIDA-2 dhe 2 orët ndërmjet 02:00 – 03:00 do të trajtohen si dy orare të ndryshme. |
| *është* | **Rezultatet paraprake (të disponueshme brenda sistemit të tregtimit)** | Rezultatet Paraprake<br>CRIDA1: Sa më shpejt të jetë e mundur nga ora 15:30 CET në D-1.<br>CRIDA2: Sa më shpejt të jetë e mundur nga ora 22:30 CET në D-1.<br>CRIDA3: Sa më shpejt të jetë e mundur nga ora 10:30 CET në D.<br>Rezultatet Përfundimtare<br>LIDA1: Sa më shpejt të jetë e mundur nga ora 15:30 CET në D-1.<br>LIDA2: Sa më shpejt të jetë e mundur nga ora 22:30 CET në D-1.<br>LIDA3: Sa më shpejt të jetë e mundur nga ora 10:30 CET në D.<br>CRIDA1: Sa më shpejt të jetë e mundur nga ora 15:45 CET në D-1.<br>CRIDA2: Sa më shpejt të jetë e mundur nga ora 22:45 CET në D-1.<br>CRIDA3: Sa më shpejt të jetë e mundur nga ora 10:30 CET në D.<br>Rezultatet përfundimtare do të publikohen sa më shpejt që të jetë e mundur sipas afateve të përmendura më sipër më përjashtim kur ka vonesa për shkak të problemeve teknike ose ndarjes së Bashkimit të Tregjeve. |
| *bëhet* | | Rezultatet paraprake<br>CRIDA1: Sa më shpejt të jetë e mundur nga ora 15:30 CET në D-1.<br>CRIDA2: Sa më shpejt të jetë e mundur nga ora 22:30 CET në D-1.<br>CRIDA3: Sa më shpejt të jetë e mundur nga ora 10:30 CET në D.<br>Rezultatet Përfundimtare<br>CRIDA1: Sa më shpejt të jetë e mundur nga ora 15:45 CET në D-1.<br>CRIDA2: Sa më shpejt të jetë e mundur nga ora 22:45 CET në D-1.<br>CRIDA3: Sa më shpejt të jetë e mundur nga ora 10:30 CET në D.<br>Rezultatet përfundimtare do të publikohen sa më shpejt që të jetë e mundur sipas afateve të përmendura më sipër më përjashtim kur ka vonesa për shkak të problemeve teknike ose ndarjes së Bashkimit të Tregjeve. |
| *është* | **LIDA** | Shprehet në €/MWh dhe është një çmim i shprehur në vlerë pozitive apo negative që përcaktohet me vendim nga Autoriteti Rregullator. |

| | | |
|---|---|---|
| *bëhet* | ***Shfuqizohet*** | |
| *është* | **CRIDA** | Shprehet në €/MWh dhe është një çmim i shprehur në vlerë pozitive apo negative që përcaktohet me vendim nga Autoriteti Rregullator. |
| *Bëhet* | ***Shfuqizohet*** | |
| *është* | | |
| *bëhet* | **Çmimi minimal klerues i Tregut të Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë** | Është një çmim i shprehur në euro/MWh në vlerë negative dhe përcaktohet me vendim nga Autoriteti Rregullator. |
| *arsyeja* | ***Shtohet*** | |
| *është* | | |
| *bëhet* | **Çmimi maksimal klerues i Tregut të Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë** | Është një çmim i shprehur në euro/MWh në vlerë pozitive dhe përcaktohet me vendim nga Autoriteti Rregullator. |
| *arsyeja* | ***Shtohet*** | |
| *është* | | |
| *bëhet* | **Çmimi minimal i urdhërporosisë në Tregun e Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë** | Është një çmim i shprehur në euro/MWh në vlerë negative dhe përcaktohet me vendim nga Autoriteti Rregullator. |
| *arsyeja* | ***Shtohet*** | |

| | | |
|---|---|---|
| *është* | | |
| *bëhet* | **Çmimi maksimal i urdhërporosisë në Tregun e Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë** | Është një çmim i shprehur në euro/MWh në vlerë pozitive dhe përcaktohet me vendim nga Autoriteti Rregullator. |
| *arsyeja* | ***Shtohet*** | |
| **SHTOJCA A**<br>**TABELA A.3: SPECIFIKIMET E PRODUKTEVE TË TREGUT TË VAZHDUESHËM BRENDA SË NJËJTËS DITË** | | |
| *është* | **Çmimi minimal i ankandit të vazhdueshëm i brenda së njëjtës ditë; çmimi maksimal i ankandit të vazhdueshëm brenda së njëjtës ditë** | Shprehet në €/MWh dhe është një çmim i shprehur në vlerë pozitive apo negative që përcaktohet me vendim nga Autoriteti Rregullator. |
| *bëhet* | **Çmimi minimal i tregut të vazhdueshëm i brenda së njëjtës ditë; çmimi maksimal i tregut të vazhdueshëm brenda së njëjtës ditë** | Shprehet në €/MWh dhe është një çmim i shprehur në vlerë pozitive apo negative që përcaktohet me vendim nga Autoriteti Rregullator. |

| **PËRKUFIZIMET E RREGULLAVE TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE** | | |
|---|---|---|
| *është* | **Agjent i transaksioneve** | nënkupton entitetin ose entitetet me detyrën e transferimit të pozicioneve neto ndërmjet kundërpalëve qendrore |
| *bëhet* | **Agjent i transferimit** | nënkupton entitetin e përcaktuar nga Autoriteti Rregullator me detyrën e transferimit të pozicioneve neto ndërmjet kundërpalëve qendrore në Bashkimin Tregjeve. |
| *është* | | |
| *bëhet* | **Algoritmi i përputhjes së tregtimit të vazhdueshëm** | Nënkupton algoritmin e përdorur në Bashkimin e Vetëm të Tregut Brenda së Njëjtës ditë për përputhjen e urdhërporosive dhe alokimin e kapaciteve ndërkufitare në mënyrë të vazhdueshëm |
| *arsyeja* | ***Shtohet*** | |
| *është* | **Ankandet plotësuese rajonale brenda së njëjtës ditë (CRIDA)** | Nënkupton ankandet brenda së njëjtës ditë që zhvillohen në një zonë e cila përbëhet nga disa zona ofertimi, plotësuese të tregtimit të vazhdueshëm brenda së njëjtës së ditë. |
| *bëhet* | | |
| | ***Shfuqizohet*** | |
| *është* | **Ankandet lokale brenda së njëjtës ditë (LIDA)** | Nënkupton një ankand brenda së njëjtës ditë që përfshin zonat të ndara ofertimi në Shqipëri ose Kosovë. |
| *bëhet* | | |
| *arsyeja* | ***Shfuqizohet*** | |
| *është* | **Bursa** | Nënkupton tregun e organizuar që operohet nga ALPEX-i duke ofruar tregtimin e energjisë elektrike, klerimin dhe shlyerjen në afatet kohore për tregjet e ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë për livrimin e energjisë elektrike në Shqipëri dhe Kosovë siç është vendosur në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike-Kushtet e përgjithshme dhe procedurat. |
| *bëhet* | | Nënkupton veprimtarinë në tregun e organizuar që operohet nga ALPEX-i duke ofruar tregtimin e energjisë elektrike, klerimin dhe shlyerjen në afatet kohore për tregjet e ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë për livrimin e energjisë elektrike në Shqipëri dhe Kosovë siç është vendosur në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike-Kushtet e përgjithshme dhe procedurat. |

| | | |
|---|---|---|
| *është* | **Çifti çmim-sasi** | Nënkupton një çift çmim-sasi i përfshirë në një urdhërporosi dhe:<br>a)në lidhje me ankandin e ditës në avancë, përshkruhet në paragrafin B.1.5.5 të procedurës së tregtimit;<br>b)në lidhje me ankandin brenda së njëjtës ditë, përshkruhet në paragrafin C.1.5.5 të procedurës së tregtimit; dhe<br>c)në lidhje me tregtimin e vazhdueshëm brenda së njëjtës ditë, përshkruhet në paragrafin D.1.2.4 të procedurës së tregtimit. |
| *Bëhet* | | Nënkupton një çift çmim-sasi i përfshirë në një urdhërporosi dhe:<br>a)në lidhje me ankandin e ditës në avancë, përshkruhet në paragrafin B.1.5.5 të procedurës së tregtimit;<br>b)në lidhje me ankandin brenda së njëjtës ditë, përshkruhet në paragrafin C.1.5.5 të procedurës së tregtimit; dhe<br>c)në lidhje me tregtimin e vazhdueshëm brenda së njëjtës ditë, përshkruhet në paragrafin D.1.2.5 të procedurës së tregtimit. |

| | | |
|---|---|---|
| *është* | | |
| *bëhet* | **Çmimi maksimal i urdhërporosive në tregun e ankandeve brenda së njëjtës ditë** | Nënkupton nivelin maksimal të çmimit të lejuar për urdhërporositë e dorëzuara në ankandin brenda së njëjtës ditë. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | **Çmimi i maksimal i tregut të ditës në avancë** | Çmimi i maksimal i tregut të ditës në avancë: nënkupton nivelin maksimal i çmimit të lejuar për urdhërporositë të futura në ankandin e ditës në avancë. |
| *bëhet* | **Çmimi maksimal i urdhërporosive në tregun e ditës në avancë** | Nënkupton nivelin maksimal të çmimit të lejuar për urdhërporositë të dorëzuara në ankandin e ditës në avancë. |
| *është* | | |
| *bëhet* | **Çmimi minimal i urdhërporosive në tregun e ankandeve brenda së njëjtës ditë** | Nënkupton nivelin minimal të çmimit të lejuar për urdhërporositë të dorëzuara në ankandin brenda së njëjtës ditë. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | **Çmimi i minimal i tregut të ditës në avancë** | Nënkupton nivelin minimal i çmimit të lejuar për urdhërporositë të futura në ankandin e ditës në avancë. |
| *bëhet* | **Çmimi minimal i urdhërporosive në tregun e ditës në avancë** | Nënkupton nivelin minimal të çmimit të lejuar për urdhërporositë të dorëzuara në ankandin e ditës në avancë. |
| *është* | **Çmimi klerues i tregut** | Nënkupton çmimin e vendosur nga përputhja e urdhërporosisë shitjeje të pranuar me çmimin më të lartë me urdhërporosinë blerjeje të pranuar me çmimin më të ulët në tregun e energjisë elektrike. |
| *bëhet* | ***Nuk ndryshon*** | |
| *është* | **Çmimi maksimal i ankandit të tregut brenda së njëjtës ditë** | Çmimi klerues maksimal në lidhje me një ankandi brenda së njëjtës ditë. |
| *bëhet* | **Çmimi maksimal klerues i ankandit të tregut brenda së njëjtës ditë** | Çmimi klerues më i lartë i pranuar në lidhje në një ankand të tregut brenda së njëjtës ditë. |
| *është* | | |
| *bëhet* | **Çmimi maksimal klerues i ankandit të tregut të ditës në avancë** | Çmimi klerues më i lartë i pranuar në lidhje në një ankandi të tregut të ditës në avancë. |

| | | |
|---|---|---|
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | | |

| | | |
|---|---|---|
| *bëhet* | **Çmimi maksimal klerues i tregut të vazhdueshëm brenda së njëjtës ditë** | Çmimi klerues më i lartë i pranuar në lidhje me tregun e vazhdueshëm brenda së njëjtës ditë. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | **Çmimi maksimal i tregut të vazhdueshëm brenda së njëjtës ditë** | Çmimi maksimal i tregut të vazhdueshëm brenda së njëjtës ditë: niveli maksimal i çmimit të lejuar për urdhërporositë e dorëzuara në tregun e tregtimit të vazhdueshëm brenda së njëjtës ditë. |
| *bëhet* | **Çmimi maksimal i urdhërporosive i tregut të vazhdueshëm brenda së njëjtës ditë** | Niveli maksimal i çmimit të lejuar për urdhërporositë të dorëzuara në tregun e tregtimit të vazhdueshëm brenda së njëjtës ditë. |
| *është* | **Çmimi minimal i tregut të vazhdueshëm brenda së njëjtës ditë** | Çmimi minimal i tregut të vazhdueshëm brenda së njëjtës ditë: niveli minimal i çmimit të lejuar për urdhërporositë e futura në tregun e tregtimit të vazhdueshëm brenda së njëjtës ditë. |
| *bëhet* | **Çmimi minimal i urdhërporosive i tregut të vazhdueshëm brenda së njëjtës ditë** | Niveli minimal i çmimit të lejuar për urdhërporositë të dorëzuara në tregun e tregtimit të vazhdueshëm brenda së njëjtës ditë. |
| *është* | **Çmimi minimal i ankandit të tregut brenda së njëjtës ditë** | Çmimi minimal i ankandit të tregut brenda së njëjtës ditë: çmimi minimal i klerimit në respekt të ankandit brenda së njëjtës ditë. |
| *bëhet* | **Çmimi minimal klerues i ankandit të tregut brenda së njëjtës ditë** | Çmimi klerues më i vogël i pranuar në respekt të ankandit brenda së njëjtës ditë. |
| *është* | | |
| *bëhet* | **Çmimi minimal klerues i ankandit të tregut të ditës në avancë** | Çmimi klerues më i vogël i pranuar në lidhje me një ankand tregut të ditës në avancë. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | | |
| *Bëhet* | **Çmimi minimal klerues i tregut të vazhdueshëm brenda së njëjtës ditë** | Çmimi klerues më i vogël i pranuar në lidhje me tregun e vazhdueshëm brenda së njëjtës ditë. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | **Faturë** | Ka kuptimin e dhënë në seksionin G.4.2. |

| | | |
|---|---|---|
| *bëhet* | | Ka kuptimin e dhënë në seksionin G.4.3 të procedurës së klerimit dhe shlyerjes. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | **Informacion mbi transaksionet në interkonektor** | Nënkupton informacionin e mëposhtëm që vjen nga një ankand në lidhje me çdo interkonektor:<br>1.Tregjet e ALPEX-it (i ditës në avancë ose brenda së njëjtës ditë);<br>2.Interkonektori përkatës ose agjenti i transaksioneve;<br>3.Sasi e planifikuar dhe drejtimi i energjisë elektrike të transferuar<br>4.Njësinë kohore të tregut përkatëse; dhe<br>5.Të tjera informacione sipas procedurës dhe kushteve të kërkuara të klerimit. |

| | | |
|---|---|---|
| *bëhet* | | Nënkupton informacionin e mëposhtëm që vjen nga një ankand në lidhje me çdo interkonektor:<br>1.Tregjet e ALPEX-it (i ditës në avancë ose brenda së njëjtës ditë);<br>2.Interkonektori përkatës ose agjenti i transferimit;<br>3.Sasi e planifikuar dhe drejtimi i energjisë elektrike të transferuar;<br>4.Njësinë kohore të tregut përkatëse; dhe<br>5.Të tjera informacione sipas procedurës dhe kushteve të kërkuara të klerimit. |
| *është* | **Kalendari i procesit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes** | Nënkupton afatet të vendosura nga ALPEX-i gjatë kohës të cilat midis të tjerash specifikojnë afatet kohore dhe periudhën kohore për ndërmarrjen e veprimeve në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. |
| *bëhet* | | Nënkupton afatet e vendosura nga ALPEX-i lidhur me periudhën kohore për ndërmarrjen e veprimeve në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. |
| *është* | **Koha e hapjes së portës** | Nënkupton kohën nga e cila anëtari i Bursës mund të dorëzoj urdhërporosi në ETSS. |
| *bëhet* | | Nënkupton kohën sipas CET-it nga e cila anëtari i Bursës mund të dorëzoj urdhërporosi në ETSS. |
| *është* | **Koha e mbylljes së portës** | -Në tregjet e ditës në avancë dhe ankandin brenda së njëjtës ditë ka kuptimin e kohës së mbylljes së portës së ankandit.<br>-Në tregtimin e vazhdueshëm brenda së njëjtës ditë nënkupton kohën përfundimtare të tregtimin për njësi kohore tregu siç specifikohet në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike-Kushtet e përgjithshme dhe procedurat. |
| *bëhet* | | -Në tregjet e ditës në avancë dhe ankandin brenda së njëjtës ditë ka kuptimin e kohës së mbylljes së portës së ankandit sipas CET-it.<br>-Në tregtimin e vazhdueshëm brenda së njëjtës ditë nënkupton kohën përfundimtare sipas CET-it të tregtimit për njësi kohore tregu siç specifikohet në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike-Kushtet e përgjithshme dhe procedurat. |
| *është* | | |
| *bëhet* | **Komiteti i Incidencës** | Nënkupton një komitet vendimmarrës që thirret nga ALPEX-i në lidhje me parashikimet në procedurat e Marrëveshjes Operacionale të Bashkimit të Tregut të Ditës në Avancë dhe/ose Tregut të Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | | |

| | | |
|---|---|---|
| *bëhet* | **Kongjestion i tregut** | Nënkupton një situatë në të cilën teprica ekonomike për Bashkimin e vetëm të Tregut të Ankandeve të Ditës në Avancë dhe/ose Tregut Brenda së Njëjtës Ditë kufizohet nga kapaciteti ndërkufitar ose kufizimet në alokim |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | **Kufiri maksimal i lejuar i çmimit të ankandit brenda së njëjtës ditë** | Nënkupton çmimi klerues maksimal i pranuar në lidhje më një ankand brenda së njëjtës ditë. |
| *bëhet* | | |
| | ***Shfuqizohet*** | |
| *është* | **Kufiri maksimal i lejuar i çmimit për Tregun e Ditës në Avancë** | Nënkupton çmimi klerues maksimal i pranuar në lidhje më një ankand brenda së njëjtës ditë. |
| *bëhet* | | Nënkupton çmimi maksimal klerues i lejuar në një ankand të ditës në avancë për të cilin ALPEX-i i referohet si mundësi për kryerjen e një ankandi të dytë. |
| *është* | **Kufiri maksimal i lejuar i çmimit të ankandit të dytë** | Nënkupton çmimi klerues maksimal i pranuar në lidhje me një ankand të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë. |
| *bëhet* | ***Shfuqizohet*** | |
| *është* | **Kufiri maksimal i lejuar i çmimit të Tregut të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë** | Nënkupton çmimi maksimal i përputhur i pranuar për Tregun e Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë. |
| *bëhet* | | |

| | | |
|---|---|---|
| | ***Shfuqizohet*** | |
| *është* | **Kufiri minimal i lejuar i çmimit për Tregun e Ditës në Avancë** | Nënkupton çmimi klerues minimal i pranuar në një ankand të ditës në avancë. |
| *bëhet* | | Nënkupton çmimi minimal klerues i lejuar në një ankand të ditës në avancë për të cilin ALPEX-i i referohet si mundësi për kryerjen e një ankandi të dytë. |
| *është* | **Kufiri minimal i lejuar i çmimit të ankandit të dytë** | Nënkupton çmimi klerues minimal i pranuar në lidhje me një ankand të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë. |
| *bëhet* | | |
| | ***Shfuqizohet*** | |
| *është* | **Kufiri minimal i lejuar i çmimit të Tregut Ankandit Brenda së Njëjtës Ditë** | Nënkupton çmimi klerues minimal të pranuar në lidhje me ankandin brenda së njëjtës ditë. |
| *bëhet* | | |
| | ***Shfuqizohet*** | |

| | | |
|---|---|---|
| *është* | **Kufiri minimal i lejuar i çmimit Tregut të Vazhdueshëm Brenda së Njëjtës Ditë** | Nënkupton çmimi i përputhur minimal i pranuar për tregun e vazhdueshëm brenda së njëjtës ditë. |
| *bëhet* | | |
| | ***Shfuqizohet*** | |
| *është* | **Kufizimi i ankandit** | Për ankandet e ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë, nënkupton një situatë ku kurba e grupuar e urdhërporosi blerjeje dhe kurba e grupuar e urdhërporosi shitjeje në ankand nuk do të priten brenda kufirit të lejuar të çmimit maksimal dhe minimal. |
| *bëhet* | | Për ankandet e ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë, nënkupton një situatë ku kurba e grupuar e urdhërporosi blerjeje dhe kurba e grupuar e urdhërporosi shitjeje në ankand nuk do të priten brenda çmimit maksimal dhe minimal të urdhërporosive. |
| *është* | **Libri e urdhërporosive** | Nënkupton përmbledhjen ku urdhërporositë futen në ETSS nga anëtarët e Bursës për tregtimin në tregun me shumicë të energjisë elektrike ku produktet janë renditur. |
| *bëhet* | | Ka kuptimin e dhënë në seksionin F.2.5 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike-Kushtet e përgjithshme. |
| *është* | **LIDA – 1** | Nënkupton ankandin e parë lokal të tregut brenda së njëjtës ditë duke i konsideruar zonat e ofertimit AL dhe KS dhe/ose zona të tjera ofertimi të ndara, e kryer për një ditë livrimi duke mbuluar njësinë kohore të tregut në ditën e përcaktuar të livrimit siç përshkruhet në tabelën e paragrafit A.2.4.6 të procedurës së tregtimit. |
| *bëhet* | | |
| | ***Shfuqizohet*** | |
| *është* | **LIDA-2** | Nënkupton ankandin e dytë lokal të tregut brenda së njëjtës ditë duke i konsideruar zonat e ofertimit AL dhe KS dhe/ose zona të tjera ofertimi të ndara, e kryer për një ditë livrimi duke mbuluar njësinë kohore të tregut në ditën e përcaktuar të livrimit siç përshkruhet në tabelën e paragrafit A.2.4.6 të procedurës së tregtimit. |
| *bëhet* | | |
| | ***Shfuqizohet*** | |
| *është* | **LIDA-3** | Nënkupton ankandin e tretë lokal të tregut brenda së njëjtës ditë duke i konsideruar zonat e ofertimit AL dhe KS dhe/ose zona të tjera ofertimi të ndara, e kryer për një ditë livrimi duke mbuluar njësinë kohore të tregut në ditën e përcaktuar të livrimit siç përshkruhet në tabelën e paragrafit A.2.4.6 të procedurës së tregtimit. |
| *bëhet* | | |
| | ***Shfuqizohet*** | |
| *është* | | |

| | | |
|---|---|---|
| *bëhet* | **Marrëveshjes Operacionale të Bashkimit të Tregjeve të Ditës në Avancë dhe/ose Tregjeve të Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë** | Nënkupton marrëveshjen ndërmjet NEMO-ve dhe OST-ve sipas së cilës parashikohet kundër i përmbledhur i bashkëpunimit midis palëve për organizmin e Bashkimit të Tregjeve të Ditës në Avancë dhe/ose tregjeve të ankandeve brenda së njëjtës ditë. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | **Rezultatet paraprake të Tregut të Bashkuar** | Rezultatet e Bashkimit të Tregjeve të cilat dërgohen nga Ofruesi i Shërbimit të Bashkimit të Tregjeve te NEMO-t me qëllim të vlerësimi. |
| *bëhet* | **Rezultatet paraprake nga Bashkimi i Tregjeve** | Rezultatet e Bashkimit të Tregjeve të cilat dërgohen nga Ofruesi i Shërbimit të Bashkimit të Tregjeve tek NEMO-t me qëllim të vlerësimit dhe që publikohen tek anëtarët e Bursës dhe TSO. |
| *është* | | |
| *bëhet* | **Rezultatet përfundimtare globale** | Rezultatet e Bashkimit të Tregjeve që janë konfirmuar nga NEMO and OST-të (OST-të në respekt të me kapacitetin ndërkufitar dhe kufizimeve të alokimit).<br>Skedari i rezultateve përfundimtare globale gjenerohet nga sistemi TI i ofruesit të shërbimit të Bashkimit të Tregjeve dhe konfirmon rezultatet e Bashkimit të Tregjeve. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | **Risku brenda së njëjtës ditë** | Ka kuptimin e dhënë në seksionin G.5.2. |
| *bëhet* | | Ka kuptimin e dhënë në seksionin G.5.2 në procedurën e klerimit dhe shlyerjes. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | **SDAC** | Bashkimi i ditës në avancë në një të vetëm. |
| *bëhet* | **SDAC (Bashkimi i Vetëm i Tregjeve të Ditës në Avancë)** | Nënkupton procesin e vazhdueshëm ku urdhërporositë e grupuara përputhen dhe kapaciteti ndërkufitar alokohet njëkohësisht për zona të ndryshme ofertimi në Tregun e Ditës në Avancë. |
| *është* | | |
| *bëhet* | **SIDC (Bashkimi i Vetëm i Tregjeve të Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë)** | Nënkupton procesin e vazhdueshëm ku urdhërporositë e grupuara përputhen dhe kapaciteti ndërkufitar alokohet njëkohësisht për Zona të ndryshme ofertimi në Tregun e Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | **Shlyerja e transaksioneve** | Nënkupton procesin e lëvizjes së mjeteve monetare ndërmjet llogarive bankare të palëve që marrin pjesë në shlyerjen e transaksioneve, ka kuptimin e dhënë në seksionin G.3.4. |
| *bëhet* | | Nënkupton procesin e lëvizjes së mjeteve monetare ndërmjet llogarive bankare të palëve që marrin pjesë në shlyerjen e transaksioneve, ka kuptimin e dhënë në seksionin G.3.4 në procedurën e klerimit dhe shlyerjes |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | **Tarifa fikse vjetore** | Nënkupton një tarifë fikse për t'u paguar tek ALPEX-i nga një entitet për vazhdimin e marrëdhënieve si anëtar i Bursës dhe/ose anëtar i klerimit siç parashikohet në lista e tarifave të ALPEX-it. |

| | | |
|---|---|---|
| *bëhet* | | Nënkupton një tarifë fikse për t'u paguar tek ALPEX-i nga një anëtarë burse për vazhdimin e marrëdhënieve si anëtar i bursës dhe/ose anëtar i klerimit siç parashikohet në lista e tarifave të ALPEX-it. |
| *është* | | |

| | | |
|---|---|---|
| *bëhet* | **Teprica ekonomike për Bashkimin e vetëm të Tregut të Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë** | Nënkupton shumën nga:<br>i.teprica e furnizuesve për Bashkimin e vetëm të Tregut të Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë për periudhën kohore përkatëse;<br>i.teprica e konsumatorëve për Bashkimin e vetëm të Tregut të Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë;<br>i.të ardhurat nga kongjestioni; dhe<br>v.kostot dhe përfitimet e tjera të cilat rrisin eficiencën ekonomike për periudhën kohore përkatëse, teprica e furnizuesve dhe konsumatorëve është diferenca midis urdhërporosive të pranuara dhe çmimit të klerimit për njësi energjie shumëzuar me volumin e energjisë të urdhërporosive. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | | |
| *bëhet* | **Të ardhurat nga kongjestioni** | Nënkupton të ardhurat të marra si rezultat i alokimit të kapaciteteve. |
| | ***Shtohet*** | |
| *është* | **Urdhërporosi marrëse e çmimit me përparësi (shitjeje/blerjeje)** | Urdhërporositë marrëse e çmimit me përparësi janë urdhërporosi me hapa orare (blerjeje/shitjeje) të dorëzuar për një çmim të barabartë me (maksimum/minimum) e kufirit të lejuar të çmimit në ankandet e ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë. |
| *bëhet* | | Urdhërporositë marrëse e çmimit me përparësi janë urdhërporosi me hapa (blerjeje/shitjeje) të dorëzuar për një çmim të barabartë me (maksimum/minimum) e të çmimit të urdhërporosive në ankandet e ditës në avancë dhe/ose brenda së njëjtës ditë. |

**VENDIM**
**Nr. 266, datë 10.12.2024**

**MBI MIRATIMIN E DATËS SË FILLIMIT TË TREGTIMIT PËR TREGUN E ANKANDEVE BRENDA SË NJËJTËS DITË NË BURSËN SHQIPTARE TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 18 pika 1, germat "a" dhe "dh"; 19, germa "a", 57 dhe 98, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar si dhe të nenit 26, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 96, datë 17.6.2016; VKM-së nr. 519, datë 13.7.2016, "Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike", të ndryshuar, si dhe të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 347, datë 27.12.2022, të ndryshuar; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2393/3 prot., datë 6.12.2024, i përgatitur nga Drejtoritë Teknike "Mbi miratimin e datës së fillimit të tregtimit për tregun e ankandeve brenda së njëjtës ditë në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike",

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 347, datë 27.12.2022, Bordi i ERE-s vendosi të miratojë Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, ndërsa me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 23.3.2023, janë miratuar disa shtesa në rregullat e tregut të energjisë elektrike, konkretisht anekset nr. 1 deri në 7.

- ALPEX-i, me shkresën nr. 421 prot., datë 20.11.2024, protokolluar në ERE me nr. 2393/2 prot., datë 25.11.2024, ka paraqitur propozimin e saj mbi ditën e fillimit të tregtimit për Tregun e Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike (Ankandi CRIDA-1).

- ALPEX-i, në bashkëpunim me OST-në dhe KOSTT-në, ka përfunduar me sukses testet teknike të nevojshme për të garantuar funksionimin e Platformave të Tregtimit dhe integrimin e tyre: Testet FiT (*Functionality Integration Test*) për CRIDA-t, të kryera nga data 25.7.2024 deri më 9.8.2024, si dhe Testet SiT (*Simulation Integration Test*), të zhvilluara nga data 13.8.2024 deri më 21.8.2024. Përfundimi me sukses i këtyre testeve konfirmon gatishmërinë teknike të Platformave të Tregtimit, Klerimit dhe Skedulimit.

- ALPEX-i ka anëtarësuar 23 Anëtarë Burse për Zonën e Ofertimit të Shqipërisë dhe 12 Anëtarë Burse për Zonën e Ofertimit të Kosovës. Prej këtyre: 11 Anëtarë nga Zona e Ofertimit të Shqipërisë dhe 7 Anëtarë nga Zona e Ofertimit të

Kosovës janë regjistruar për të marrë pjesë në Tregun e Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë.

- ALPEX-i ka trajnuar dhe certifikuar Agjentët Tregtarë dhe Agjentët Klerues, duke siguruar një funksionim normal dhe të qëndrueshëm të tregut.

- Platforma e Tregtimit (ETSS), Klerimit dhe Menaxhimit të Riskut (EMCS) është përgatitur dhe funksionon në përputhje të plotë me kërkesat e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s. Kjo platformë mbështet integrimin dhe nisjen e Tregut të Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë për Zonën e Ofertimit të Shqipërisë.

- Rezulton se Drejtoritë Teknike dhe shoqëria "ALPEX" sh.a. kanë vlerësuar se kërkesat e nevojshme për fillimin e tregtimit në Tregun e Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë janë përmbushur dhe janë në përputhje me paragrafin K.1.3.1 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme, ku citohet: "E para Njësi Kohore e Tregut për qëllim të këtyre Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike do të fillojë në Kohën e Përcaktuar.".

- Shoqëria "ALPEX" sh.a. ka propozuar që dita e fillimit të Tregtimit në Tregun e Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë të jetë Njësia Kohore e Tregut që i përket orës 00:00, të datës 12.12.2024, që i korrespondon Ankandit CRIDA-1.

- Për sa më sipër, shoqëria "ALPEX" sh.a. ka përmbushur të gjitha kërkesat për fillimin e operimit të Tregut të Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë, bazuar në gatishmërinë e platformave teknike, përfundimin me sukses të testeve të integrimit, trajnimin dhe certifikimin e agjentëve tregtarë, si dhe organizimin e *workshop*-eve për aftësimin e pjesëmarrësve të tregut.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e Njësisë Kohore të Tregut që i përket orës 00:00, të datës 12.12.2024, si dita e fillimit të tregtimit në Tregun e Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike.

2. Shoqëria "ALPEX" sh.a. duhet të njoftojë ERE-n, anëtarët e Bursës Shqiptare të Energjisë, si dhe palët e interesuara mbi funksionimin e ankandit CRIDA-2, jo më vonë se 48 orë përpara fillimit të operimit të tij.

3. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike – "ALPEX" sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe palët e tjera të interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Petrit Ahmeti**

**VENDIM**
**Nr. 267, datë 10.12.2024**

**MBI AFATIN E NOMINIMIT NË TREGUN E BALANCIMIT**

Në mbështetje të neneve 16, 19, 62, 98, 99 dhe 100, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 26, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.12.2024, pasi shqyrtoi relacionin nr. 1549/1 prot., datë 6.12.2024, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike "Mbi kërkesën e 'OST' sh.a. dhe 'ALPEX' sh.a., për ndryshimin e afatit të nominimit në tregun e balancimit",

konstatoi se:

- Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, me vendimin nr. 106, datë 2.7.2020, vendosi miratimin e "Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike".

- Nëpërmjet shkresës së përbashkët nga "OST" sh.a. dhe "ALPEX" sh.a., me nr. 3529 prot., datë 21.6.2024 (për "OST" sh.a.) dhe nr. 229 prot., datë 24.6.2024 (për "ALPEX" sh.a.), protokolluar në ERE me nr. 1549 prot., datë 25.6.2024, është kërkuar ndryshimi i afatit të

nominimit në tregun e balancimit, e cila synon të ndryshojë afatet për përditësimin e nominimeve, duke e përshtatur atë me praktikat e reja të tregut dhe duke rritur fleksibilitetin operacional.

- Në propozimin e paraqitura nga shoqëritë "OST" sh.a. dhe "ALPEX" sh.a., duke marrë në konsideratë përvojën e akumuluar dhe bashkëpunimin me aktorët e tregut, është rekomanduar për përmirësimin e "Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit", si dhe është propozuar ndryshimi: "Nominimet mund të përditësohen brenda ditës, së paku 15 minuta para fillimit të periudhës së lëvrimit".

- Ky ndryshim ka për qëllim të përshtatet me zhvillimet teknologjike dhe operacionale, duke siguruar një reagim të shpejtë ndaj ndryshimeve të paparashikuara dhe një bashkëpunim më të ngushtë midis platformave të "ALPEX" sh.a. dhe "OST" sh.a.

- "OST" sh.a., që nga 1 prilli 2021, kur filloi operimi i tregut të balancimit të energjisë elektrike bazuar në "Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike", të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106/2020, ka zbatuar një interval kohor me rezolucion prej 1 ore për proceset, përfshirë nominimet dhe llogaritjet e disbalancave. Në përputhje me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 148, datë 25.7.2024, duke filluar nga data 1 mars 2025, "OST" sh.a. do të zbatojë rezolucionin 15-minutësh për këto procese, duke përfshirë nominimet dhe llogaritjet e disbalancave.

- Është thelbësore që operimi i OST-së të harmonizohet me platformën e Bursës Shqiptare të Energjisë (ALPEX), duke siguruar përputhshmëri me rezolucionin orar të përdorur nga ALPEX-i sipas vendimit nr. 347, datë 27.12.2022. Ky harmonizim është jetik për përmirësimin e proceseve brenda së njëjtës ditë dhe për qëndrueshmërinë e sistemit elektroenergjetik, përmes koordinimit të ngushtë midis OST-së, ALPEX-it, palëve përgjegjëse për balancimin dhe partnerëve ndërkufitarë.

- Propozimi është publikuar për konsultim në faqen zyrtare të ERE-s dhe deri në këtë vendimmarrje nuk ka marrë komente nga palët e interesuara.

- Për sa më sipër, referuar zhvillimeve të pritshme në Tregun Shqiptar të Energjisë, më konkretisht procesit të Bashkimit të Tregjeve Brenda së Njëjtës Ditë, vlerësohet i arsyeshëm ndryshimi i afatit të nominimeve, pasi është një faktor pengues në zhvillimin e mëtejshëm të këtij procesi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e dispozitës 5.5.1.5, të "Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike", të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, date 2.7.2020, si më poshtë vijon:

**Është:** "Pasi kontrollohet vlefshmëria e nominimeve të dërguara në D-1 nga PPB-ja tek OST-ja dhe çdo korrigjimi të mundshëm, nominimet e rezervave të marra do t'i nënshtrohen kontrollit të plotë për koherencën ndërmjet kontratave të tjera të shërbimeve ndihmëse të lidhura ndërmjet OST-së dhe PPB-së, dhe korrigjohen, sipas rastit. Shpeshtësia e këtyre nominimeve është 15 minuta. **Nominimet mund të përditësohen brenda ditës, së paku 45 minuta para fillimit të 15 minutave të para të përfshira në përditësim**.".

**Bëhet:** "Pasi kontrollohet vlefshmëria e nominimeve të dërguara në D-1 nga PPB-ja tek OST-ja dhe çdo korrigjimi të mundshëm, nominimet e rezervave të marra do t'i nënshtrohen kontrollit të plotë për koherencën ndërmjet kontratave të tjera të shërbimeve ndihmëse të lidhura ndërmjet OST-së dhe PPB-së, dhe korrigjohen, sipas rastit. Shpeshtësia e këtyre nominimeve është 15 minuta. **Nominimet mund të përditësohen brenda ditës, së paku 15 minuta para fillimit të periudhës së lëvrimit**.".

2. Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Mbikëqyrjes së të Licencuarve të njoftojë shoqëritë "OST" sh.a., "ALPEX" sh.a. dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë,

brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Petrit Ahmeti**

**VENDIM**
**Nr. 268, datë 10.12.2024**

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "VOLTON" SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa "d", 5, pika 1, germa "d", si dhe 13, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2293/9 prot., datë 3.12.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Volton' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "Volton" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE nr. 2293 prot., datë 28.10.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 235, datë 5.11.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 6.11.2024 dhe 7.11.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 15.11.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- ERE, me shkresën nr. 2293/3 prot., datë 19.11.2024, ka njoftuar shoqërinë për vendimin e sipërcituar dhe i ka kërkuar të plotësojë informacionin/dokumentacionin e konstatuar të paplotësuar ose të plotësuar pjesërisht prej saj.

- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 2293/6 prot., datë 26.11.2024 dhe nr. 2293/8 prot., datë 3.12.2024, shoqëria ka plotësuar informacionin/dokumentacionin e munguar për këtë aplikim.

- Nga analizimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9 të rregullores.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Volton" sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "Volton" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Petrit Ahmeti**

**VENDIM**
**Nr. 269, datë 10.12.2024**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "*SUNNY SIDE ENERGY*" SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa "e", 5, pika 1, germa "e", dhe 10, pikat 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2443/1 prot., datë 4.12.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve "Mbi kërkesën e shoqërisë '*Sunny Side Energy*' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "*Sunny Side Energy*" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2443 prot., datë 25.11.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat: "a" "b" dhe "c"; për pikën 1.2, germat: "a", "b" dhe "d"; për pikën 1.3, germën "a"; si dhe pikën 2.5.

- Nga ky aplikim nevojitet të plotësohet dhe sa vijon:

Neni 9. **Formati dhe dokumentacioni për aplikim**

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2. Dokumentacioni juridik dhe administrativ:

- germa "c": Shoqëria duhet të depozitojë strukturën organizative në format origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin;

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- germa "b": Shoqëria nuk ka depozituar dokumentacion në lidhje me mbështetjen financiare për të garantuar të paktën 1 (një) muaj të ushtrimit të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike;

- germa "c": Shoqëria duhet të plotësojë planin e biznesit me mënyrën e financimit të veprimtarisë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "*Sunny Side Energy*" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "*Sunny Side Energy*" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Petrit Ahmeti**

**VENDIM**
**Nr. 270, datë 10.12.2024**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "*SUNNY SIDE ENERGY*" SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa "a", 5, pika 1, germa "a", dhe 10, pikat 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a" të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2442/1 prot., datë 4.12.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve "Mbi kërkesën e shoqërisë '*Sunny Side Energy*' sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "*Sunny Side Energy*" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2442 prot., datë 25.11.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 100 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 1451, fshati Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat: "a", "b" dhe "c"; për pikën 1.2, germat: "a", "b" dhe "d"; për pikën 1.3, germat "a" dhe "c"; si dhe për pikën 2.1, germat: "a", "b", "d", "e" dhe "f".

- Rezulton se shoqëria "*Sunny Side Energy*" sh.p.k.:

- Ka depozituar vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 673, datë 30.10.2024, "Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë fotovoltaik dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesionit, në zonën kadastrale 1451, fshati Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, qarku Fier, nga shoqëria '*Sunny Side Energy*' sh.p.k.";

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) kontratën nr. 1192 rep., nr. 482 kol., datë 11.11.2024, "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 100 mw dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën kadastrale nr. 1451, fshati Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria "*Sunny Side Energy*", nënshkruar ndërmjet MIE-s dhe shoqërisë "DESLA" sh.p.k.;

- Ka depozituar shkresën e shoqërisë "Operatori i Sistemit të Transmetimit" (OST) sh.a., nr. 2152/3 prot., datë 26.4.2023, me anë të së cilës është miratuar në parim lidhja e parkut fotovolaik "*Sunny Side Solar*", me rrjetin e transmetimit. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE miratimin përfundimtar për pikën e lidhjes.

- Është pajisur me vendim për VNM-në paraprake, lëshuar më 21.3.2024, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin "Ndërtimi i impiantit fotovoltaik '*Sunny Side Solar Park*', me fuqi 100 mw". Kjo VNM është aktualisht e vlefshme (deri më 21.3.2026), por shoqëria duhet të bëjë me dije në rast se ka filluar punimet për ndërtimin e centralit.

- Nga ky aplikim nevojitet të plotësohet dhe sa vijon:

Neni 9. Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2. Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- germa "c": Shoqëria duhet të depozitojë strukturën organizative të saj në format origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin;

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- germa "b": Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin përkatës mbi aftësinë financiare për të realizuar investimin e plotë të veprës sipas vlerës së përcaktuar në kontratën me MIE-n dhe sipas mënyrës së financimit të parashikuar në planin e saj të biznesit.

- Po ashtu, shoqëria duhet të bëjë saktësimet përkatëse, në lidhje me jetëgjatësinë e centralit fotovoltaik dhe të depozitojë një dokument teknik në lidhje me jetëgjatësinë e tij.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "*Sunny Side Energy*" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet prodhues 100 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 1451, fshati Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "*Sunny Side Energy*" sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Petrit Ahmeti**

**VENDIM**
**Nr. 271, datë 10.12.2024**

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "EN.KU" SHPK PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË KONTROLLON INTERESAT E SAJ**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 5, 7, 9, pika dhe 5, dhe nenit 10, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit, si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2397/3 prot., datë 5.12.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, "Mbi kërkesën e shoqërisë 'En.Ku' sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj",

konstatoi se:

- Shoqëria "En.Ku" sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 86, datë 17.7.2008, modifikuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 50, datë 3.5.2013.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2397 prot., datë 13.11.2024, shoqëria ka paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin për marrjen e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj.

- Pas shqyrtimit paraprak të kërkesës dhe dokumentacionit bashkëlidhur, ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 2397/1 prot., datë 25.11.2024, duke i evidentuar informacionin /dokumentacionin e munguar të këtij aplikimi.

- Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2397/2 prot., datë 27.11.2024,

shoqëria ka plotësuar dokumentacionin e munguar.

- Pas analizimit të kërkesës dhe dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria, rezulton se ajo ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar në nenin 7, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021.

- Shoqëria "En.Ku" sh.p.k. nuk ka detyrime të pashlyera ndaj ERE-s për sa i përket pagesave të rregullimit.

- Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë "En.Ku" sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/ miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë "En.Ku" sh.p.k.

2. Ortaku i vetëm që kontrollon interesat e shoqërisë "En.Ku" sh.p.k. bëhet shoqëria "Besniku" sh.p.k.

3. Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë "En.Ku" sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin / miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

4. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "En.Ku" sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Petrit Ahmeti**

**VENDIM**
**Nr. 272, datë 10.12.2024**

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 179, DATË 8.11.2017, "MBI CERTIFIKIMIN E SHOQËRISË 'OPERATORI I KOMBINUAR I GAZIT NATYROR' 'ALBGAZ' SH.A." , I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; tëneneve 53, pika 2; dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 634/5 prot., datë 5.12.2024, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike, "Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, 'Mbi certifikimin e shoqërisë 'Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror' 'Albgaz' sh.a.", i ndryshuar;

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 59, datë 2.4.2024, ka vendosur të ndryshojë pikën 5.2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, të ndryshuar, duke i lënë kushtin shoqërisë "Albgaz" sh.a. të depozitojë në ERE, brenda datës 31.12.2024, realizimin e ndryshimeve në nenet 11 dhe 46, pika 10, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, dhe transferimin e kompetencave te Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

- ERE njoftoi shoqërinë dhe palët e interesit për vendimin nr. 59/2024 me shkresën nr. 634/2

prot., më datë 11.4.2024, për shtyrjen e afatit për realizimin e ndryshimeve ligjore deri më datë 31.12.2024.

- Shoqëria "Albgaz" sh.a., me shkresën nr. 634/4 prot., datë 20.11.2024, i është drejtuar ERE-s me kërkesën për shtyrjen e afatit për plotësimin e kushtit të certifikimit si "Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror". Shoqëria ka bërë me dije se vijon punën për zhvillimin e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror, një proces ku Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka rol kyç si institucioni përgjegjës për politikat dhe mbikëqyrjen e projekteve të zhvillimit. Gjithashtu, shoqëria "Albgaz" sh.a. ka njoftuar se më 12 nëntor 2024, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe kompania shtetërore e naftës "SOCAR" kanë nënshkruar një memorandum bashkëpunimi për gazifikimin e qytetit të Korçës, i cili hap rrugën për fillimin e projektit të detajuar inxhinierik pas përfundimit të studimit të fizibilitetit.

- Shoqëria ka bërë me dije se, për shkaqe jashtë vullnetit të saj, transferimi i kompetencave dhe depozitimi në ERE i dokumentacionit për ndryshimet në nenet 11 dhe 46, pika 10, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, dhe kalimi i kompetencave te Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) janë jashtë përgjegjësisë së saj. Shoqëria mbetet në pritje të një përgjigjeje përfundimtare nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për përmbushjen e këtij kushti.

- Duke u bazuar në sa më sipër dhe informacionin e bërë të ditur nga shoqëria, kushti mbetet ende i paplotësuar. Në këto rrethana, vlerësohet e arsyeshme të merret në konsideratë kërkesa e shoqërisë për shtyrjen e afatit për përmbushjen e këtij kushti deri më datë 31.12.2025, sipas sqarimeve të paraqitura prej saj.

- Në nenin 53, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", parashikohet se: "Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, nëse ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural, organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit.".

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 5.2, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, të ndryshuar, bëhet si vijon:

"5.2 Brenda datës 31.12.2025 shoqëria "Albgaz" sh.a. duhet të depozitojë në ERE realizimin e ndryshimeve në nenin 11 dhe nenin 46, pika 10, të ligjit "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, dhe transferimin e kompetencave te Ministria e Financave.".

2. Ky vendim i shtrin efektet menjëherë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Petrit Ahmeti**

## VENDIM
## Nr. 273, datë 13.12.2024

## MBI MIRATIMIN E ÇMIMIT TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE QË DO T'U PAGUHET PRODHUESVE EKZISTUES ME PËRPARËSI PËR VITIN 2025

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, të neneve 10 dhe 31, të ligjit nr. 24/2023, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.12.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2532 prot., datë 12.12.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Zhvillimit të Politikave dhe Mbikëqyrjes së Burimeve të Rinovueshme "Mbi miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike

që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2025",

konstatoi se:

- Në mbështetje të nenit 10, të ligjit nr. 24/2023, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", ERE është autoriteti përgjegjës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuesve ekzistues me përparësi nga burimet hidrike me kapacitet të instaluar deri në 15 mw. Në pikën 4 të këtij neni përcaktohet se: "Për prodhues ekzistues me përparësi, çmimi i blerjes së energjisë elektrike nga burimet hidrike me kapacitet të instaluar deri në 15 mw caktohet nga ERE, në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit". Metodologjia përcakton kriteret e llogaritjes së çmimit, duke u bazuar në çmimin e tregut të organizuar të energjisë elektrike ose deri në krijimin e tij, në çmime të krahasueshme të tregjeve të organizuara të vendeve fqinje, plus një bonus të caktuar për promovimin e këtyre burimeve, i cili merr në konsideratë një kthim të arsyeshëm të vlerës së investimeve. Në çdo rast, ky çmim nuk do të jetë më i ulët se çmimi i miratuar nga ERE në vitin 2016.

- Gjithashtu, në pikën 2, të nenit 31, të këtij ligji përcaktohet se aktet nënligjore të dala në bazë dhe në zbatim të ligjit nr. 7/2017, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", të ndryshuar, vazhdojnë të mbeten në fuqi dhe të zbatohen deri në momentin e miratimit të akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji (ligjit nr. 24/2023).

- Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 687, datë 22.11.2017, të ndryshuar, është miratuar metodologjia e përcaktimit të "Çmimit vjetor të blerjes se energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi" ku ky çmim përllogaritet sipas formulës si vijon:

Çmimi vjetori i blerjes (lekë/kwh) = Çmimi mesatar vjetor i Tregut të Ditës në Avancë (HUPX/DAM) i energjisë elektrike në profilin bandë (*baseload*) i vitit përkatës të bursës hungareze (HUPX) të energjisë elektrike në euro cent/kwh X bonusin për promovimin e burimeve të rinovueshme në masën 1.2 X normën mesatare të këmbimit në euro/lekë për vitin e fundit.

- Nga të dhënat paraprake nga faqja e internetit të Bursës Hungareze të Energjisë (https://hupx.hu/en/market-data/dam/regular-reports), është marrë çmimi i deritanishëm mesatar për periudhën 11-mujore të Tregut të Ditës në Avancë (HUPX/DAM) të energjisë elektrike në profilin bandë (*baseload*) për vitin 2024, i cili rezulton në vlerën 96.76 euro/mwh.

- Sipas metodologjisë, me normë mesatare të shkëmbimit të vitit të fundit, kuptohet kursi mesatar vjetor i këmbimit euro/lekë, i publikuar nga Banka e Shqipërisë për vitin 2024. Nga të dhënat e deritanishme të publikuara nga Banka e Shqipërisë mbi kursin e këmbimit, kursi mesatar i këmbimit për periudhën 11-mujore të vitit 2024 rezulton të jetë 101.13 lekë/euro.

- Nga të dhënat paraprake rezulton se çmimi vjetor i blerjes se energjisë elektrike referuar Tregut të Ditës në Avancë të Bursës Hungareze të Energjisë HUPX do të jetë 11.74 lekë/kwh. Në zbatim të VKM-aë nr. 687, datë 22.11.2017, "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi", të ndryshuar, ky çmim rezulton të jetë mbi nivelin maksimal të çmimit të llogaritur të blerjes së energjisë elektrike të përcaktuar në germën "d", prej 10 lekë/kwh.

- Gjithashtu, në zbatim të ligjit nr. 24/2023, i cili parashikon se kriteret e llogaritjes së çmimit, do të bazohen në çmimin e tregut të organizuar të energjisë elektrike ose deri në krijimin e tij, në çmime të krahasueshme të tregjeve të organizuara të vendeve fqinje, edhe pse në kushtet e mungesës së një metodologjie e cila i referohet llogaritjes së këtij çmimi, duke u bazuar në tregun shqiptar të organizuar të energjisë elektrike, ku çmimi mesatar klerues i bursës shqiptare të energjisë ALPEX, për periudhën 11-mujore të vitit 2024, rezulton të jetë në vlerën prej 108.3 euro/mwh, rezulton se çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike referuar Tregut të Ditës në Avancë të Bursës Shqiptare të Energjisë ALPEX, do të rezultonte në vlerën 13.14 lekë/kwh, përsëri mbi nivelin maksimal prej 10 lekë/kwh, të përcaktuar në metodologjinë në fuqi.

- Për rrjedhojë, çmimi i blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2024 do të jetë ai prej 10 lekë/kwh.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi, prej 10 lekë/kwh, për vitin 2025.

2. Drejtoria e Zhvillimit të Politikave dhe Mbikëqyrjes së Burimeve të Rinovueshme të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Petrit Ahmeti**

## VENDIM
## Nr. 274, datë 13.12.2024

## MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN NËNTOR 2024, PËR KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 kV

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar; dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.12.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 249/1 prot., datë 11.12.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve "Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 206, datë 7.10.2024 dhe mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin nëntor 2024, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV",

konstatoi se:

- "FSHU" sh.a me shkresën me shkresën nr. 7384 prot., datë 3.12.2024, protokolluar në ERE me nr. 2491 prot., datë 4.12.2024, ka depozituar kërkesën për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin nëntor 2024, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Bazuar në aplikimin e sipërcituar, për muajin nëntor 2024 shoqëria "FSHU" sh.a. e ka siguruar sasinë e energjisë elektrike për mbulimin e kërkesës për energji të kësaj kategorie klientësh nëpërmjet blerjeve mujore në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX).

- Për përllogaritjen e çmimit mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike për këtë periudhë (ÇBEt), "FSHU" sh.a. është bazuar në blerjet ditore/mujore të saj në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike për muajin nëntor 2024, profilet ditore të prokuruara në Bursë, çmimin ditor/orar, si dhe vlerën e faturës ditore.

- Referuar të dhënave të mësipërme, rezulton se çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike (ÇBEt), i përllogaritur nga shoqëria për muajin nëntor 2024, është 17.54 lekë/kwh. Për efekt kontrolli të të dhënave të paraqitura, u konsiderua e arsyeshme rillogaritja e tyre, nga e cila rezultoi se mesatarja e ponderuar e çmimit të blerjes së energjisë elektrike është 17.54 lekë/kwh, ashtu siç është pasqyruar edhe në përllogaritjet e përcjella nga vetë shoqëria.

- Referuar aplikimit të shoqërisë "FSHU" sh.a., rezulton se përllogaritjet janë bazuar në kursin ditor të këmbimit (euro/lekë), me vlera të mbështetura në kurset zyrtare të këmbimit të publikuara nga Banka e Shqipërisë për periudhën 31.10.2024–29.11.2024.

- Mbështetur në nenin 8, të "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar, komponentët që janë marrë në konsideratë për përcaktimin e

çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin nëntor 2024 janë: kostot administrative, tarifa e shërbimit të rrjetit të transmetimit, tarifa e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes, si dhe kursi i këmbimit i përdorur për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar.

- Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike e cila për periudhën 1 maj 2022–31 dhjetor 2024, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 13.4.2022, është 0.85 lekë/kwh.

- Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kV, e cila mbështetur në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 365, datë 15.12.2023, "Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022", vijon të jetë 1.55 lekë/kwh.

- Kostot administrative, të cilat në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 366, datë 15.12.2023, "Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.4.2022", vijojnë të jenë 1.06 lekë/kwh.

- Në zbatim të "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", referuar aplikimit të "FSHU" sh.a. si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin nëntor 2024, përllogaritet si më poshtë:

*Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin nëntor 2024*

| | | Njësia | Çmimi |
|---|---|---|---|
| CBEt | Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike | Lekë/kWh | 17.54 |
| Pr | Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%) | Lekë/kWh | 0.53 |
| CA | Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit | Lekë/kWh | 1.06 |
| TRr | Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit | Lekë/kWh | 0.85 |
| TSHt | Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes | Lekë/kWh | 1.55 |
| **Çmimi i energjisë = CBEt + Pr * CBEt + TRr + TSHt + CA** | | **Lekë/kWh** | **21.53** |

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:

- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të jetë 21.53 lekë/kwh për muajin nëntor 2024.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin nëntor 2024 prej 21.53 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Petrit Ahmeti**

## VENDIM
## Nr. 275, datë 13.12.2024

## MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 206, DATË 7.10.2024

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" të ndryshuar; të nenit 105, germa "c", të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të

Republikës së Shqipërisë"; të Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar; dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.12.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 249/1 prot., datë 11.12.2024, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike "Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 206, datë 7.10.2024 dhe mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin nëntor 2024 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 206, datë 7.10.2024, vendosi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin shtator 2024 prej 16.86 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

- Në vijim të këtij vendimi, ju kërkua shoqërisë "FSHU" sh.a. të paraqesë faturat dhe dokumentacionin për energjinë elektrike të prokuruar në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX) për muajin shtator 2024, me qëllim vlerësimin dhe transparencën në përllogaritjen e kostos mesatare të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike (ÇBEt).

- Në përgjigje, më datë 14.10.2024, "FSHU" sh.a. përcolli dokumentacionin e kërkuar, duke përfshirë: faturat e blerjes së energjisë elektrike për muajin shtator 2024; tabelat përmbledhëse ditore; tabelat e përllogaritjes për aplikimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët 35 kV.

- Pas shqyrtimit të materialeve të përcjella nga "FSHU" sh.a., me shkresën nr. 2024/4 prot., datë 11.11.2024, ERE i kërkoi shoqërisë informacion dhe sqarime mbi dy çështje kryesore:

1. Diferencat e konstatuara ndërmjet çmimeve orare të blerjes së energjisë në tregun ALPEX për muajin shtator 2024 dhe çmimeve orare të paraqitura në aplikimin për miratimin e çmimit FMF 35 kV, të cilat reflektohen edhe në përllogaritjen e çmimit mesatar të ponderuar ditor.

2. Profilin e pandryshuar të sasive të nominuara për nivelin e tensionit 35 kV gjatë çdo ore të ditës në ALPEX, në krahasim me profilet e ndryshme të përdorura për tensionin 20/10/6 kV gjatë të njëjtës periudhë.

- Me shkresën nr. 7110/1 prot., datë 25.11.2024 (protokolluar në ERE me nr. 2024/7 prot., datë 25.11.2024), "FSHU" sh.a. ofroi sqarimet e kërkuara mbi këto çështje: "1. Për sa konstatuar nga ana juaj dhe analizuar nga ana jonë, rezulton se diferenca në përllogaritje ka ardhur si rezultat i rrumbullakosjes së sasisë orare të nominuar, përkatësisht: Nga parashikimi për blerjen e energjisë për klientët e kategorisë FMF 35 kV, sasia orare që do të nominohej në platformën e tregtimit të ALPEX nga "FSHU" sh.a. ka qenë 0.16919 mwh. Duke qenë se bazuar në "Procedurat e tregtimit" në sistemin e ALPEX-it mund të nominohet deri në 2 (dy) shifra pas presjes dhjetore, kjo sasi është rrumbullakosur në 0.17 mwh.

Në kërkesën për miratimin e çmimit dhe tabelën e përllogaritjeve pranë ERE, formula e ka llogaritur çmimin me sasinë 0.16919... mwh (pra 5 shifra pas presjes), dhe jo 0.17 mwh. Si rezultat çmimi orar, i llogaritur si: vlera e faturës mbi bazë orare rezultuar nga blerja në ALPEX/sasinë orare (0.16919 mwh dhe jo 0.17 mwh), ka rezultuar me një diferencë të vogël, e cila reflektohet edhe në koston mesatare të ponderuar të blerjes së energjisë për këtë muaj. Çmimi mesatar i ponderuar ka rezultuar 13.01 lekë/kwh dhe çmimi i shitjes së energjisë aktive 16.86 lekë/kwh.

"FSHU" sh.a. ka kryer sërish përllogaritjet duke marrë parasysh sasitë orare të nominuara në ALPEX prej 0.17 mwh, çmimet orare, dhe vlerat orare të faturave, dhe rezulton se çmimi mesatar i ponderuar për muajin shtator 2024 është 12.95 lekë/kwh. Duke i shtuar edhe kostot e tjera për sa parashikohet në "Metodologjinë e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit" miratuar me vendimin nr. 201 datë 4.12.2017, të Bordit të ERE-s, të ndryshuar, çmimi i energjisë aktive rezulton prej 16.80 lekë/kwh.

Diferenca me çmimin e përcaktuar në kërkesën për miratimin nga ana e "FSHU" sh.a., si dhe miratuar nga ERE me vendimin nr. 206, datë 7.10.2014 është 0.06 lekë/kwh. Sqarojmë se "FSHU" sh.a. do të marrë të gjitha masat për kompensimin e kësaj diference për klientët FMF të lidhur në 35 kV. 2. Për sa i përket konstatimit tuaj që sasitë e nominuara të energjisë elektrike për nivelin e

tensionit 35 kV mbeten të pandryshuara, sqarojmë se kërkesat për blerjen në "Tregun e Ditës në Avancë" (ALPEX) bazohen në vlera të parashikuara që rrjedhin nga të dhëna historike të disponueshme.".

- Gjithashtu, "FSHU" sh.a., me anë të shkresës së sipërcituar, na informoi se duke filluar nga data 1 nëntor 2024, sasitë e energjisë për këtë kategori klientësh po nominohen me profile të ndryshme ngarkese për çdo orë të ditës.

- Për sa më sipër, vlerësohet se për shkak të rrumbullakosjes së sasisë orare të nominuar, konsumatorët e tensionit 35 kV gjatë shtatorit 2024 janë furnizuar me energji me një çmim 0.06 lekë/kwh më të lartë se kostoja reale, duke cenuar përputhshmërinë me kostot aktuale.

- Bazuar në parashikimet e "Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", në mbështetje të nenit 105, germa "c", citojmë se: Aktet administrative kanë fuqi prapavepruese në rastin kur organi kompetent mund t'i jap fuqi prapavepruese aktit kur kjo lejohet nga ligji dhe është në favor të palëve të interesuara dhe nuk dëmton të drejtat e një pale të tretë.

- Në këtë rast, ndryshimi i çmimit të përcaktuar me vendimin nr. 206/2024 të ERE-s, i bazuar në të dhënat e sakta dhe të përditësuara mbi kostot reale të blerjes së energjisë elektrike nga "FSHU" sh.a., përmbush parimet ligjore, që çmimi të reflektojë kostot.

- Ky ndryshim është në favor të konsumatorëve, duke garantuar një transparencë më të lartë dhe një përputhshmëri më të saktë me kostot aktuale, ndërsa nuk cenon të drejtat e ndonjë pale të tretë. Për më tepër, rillogaritja e çmimit përmbush parimet e metodologjisë, pasi këto veprime synojnë një përmirësim të përllogaritjeve bazuar në të dhëna të sakta, duke respektuar rregullat e metodologjisë pa ndryshuar apo devijuar nga parimet e saj themelore.

- Bazuar në nenin 105, germa "c", të Kodit të Procedurave Administrative, i cili lejon efektin prapaveprues të një akti administrativ kur është në favor të palëve të interesuara dhe nuk cenon të drejtat e palëve të treta, rillogaritja dhe përcaktimi i çmimit të korrigjuar konsiderohet i justifikuar dhe në përputhje me parimet ligjore dhe aktet nënligjore të ERE-s.

- Për këtë arsye, vlerësohet ndryshimi i pikës 1 të dispozitivit të vendimit nr. 206, datë 7.10.2024, nga: "Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin shtator 2024 prej 16.86 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.", në: "Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin shtator 2024 prej 16.80 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.".

- Gjithashtu, shoqëria "FSHU" sh.a. duhet të korrigjojë dhe kompensojë diferencat e rezultateve të muajit shtator 2024 në faturat e muajit dhjetor 2024.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 1, e vendimit nr. 206, datë 7.10.2024, e Bordit të ERE-s ndryshon dhe bëhet: "Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin shtator 2024 prej 16.80 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.".

2. Pika 2, e vendimit nr. 206, datë 7.10.2024, e Bordit të ERE-s ndryshon dhe bëhet: "Shoqëria të korrigjojë dhe kompensojë diferencat rezultuese të muajit shtator 2024, në faturat e muajit dhjetor 2024.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
**Petrit Ahmeti**

| | |
|---|---|
| | Formati 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 224 lekë

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2025/01/10 13:41:29 +02'00'
8e3bfbba3614466f970bc3dc1630f25a2025011013
412146031

*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë*
*të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)*